

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

FAN S. NOLI – FIGURË EMBLEMATIKE
PËR SHQIPEN DHE SHQIPTARËT

(tribunë shkencore – 20.11.2015)

- 13 -



Shkup, 2015

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE –
SHKUP

Vëllimi 13 – 2015

Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Zeqirija Ibrahim

Këshilli redaktues:
Dr. Qemal Murati
Dr. Sevdail Demiri
Dr. Hidajete Azizi

Sekretar i redaksisë:
Agon Salih

Redaktor teknik:
Naser Fera

Copyright© ITSHKSH, 2015
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN 978–608– 4653–33–2

www.itsh.edu.mk

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

FAN S. NOLI – FIGURË EMBLEMATIKE
PËR SHQIPEN DHE SHQIPTARËT

(tribunë shkencore – 20.11.2015)

- 13 -

SCUPI

Shkup, 2015



FAN S. NOLI (1882–1965)

TRYEZA E LËNDËS:

HYRJE	7
FAN NOLI – FIGURË EMBLEMATIKE PËR SHQIPEN DHE SHQIPTARËT	9
QEMAL MURATI: FAN NOLI – KY LËVRUES I MADH I FJALËS SHQIPE.....	11
XHEVAT LLOSHI: PËRKTHIMI I NJË TEKSTI NGA FAN NOLI.	21
AVNI SPAHIU: VATRA E SHQIPTARËVE TË AMERIKËS DHE NOLI	32
ALI JASHARI: PËR FAN NOLIN DHE PASURINË IDIOMATIKE TË VEPRËS SË TIJ	40
SHPËTIM ÇUÇKA: NOLI – SIMBOL I PËRKTHIMIT SHQIPTAR	50
AVZI MUSTAFA: NOLI NË MES SHQIPTARËVE TË UKRAINES	56
ZEQIRJA NEZIRI: NOLI DHE EPIKA GOJORE SHQIPTARE	65
MIRLINDA KRIFCA BEQIRI: NOLI MES MITIT DHE REALITETIT	72
OLGER BRAME: PËRDORIMI I SIMBOLEVE NË VEPRËN E NOLIT NË KËNDVËSHTRIMIN SEMIOTIK.....	82
MYRVETE DRESHAJ – BALIU & BEGZAD BALIU: STUDIUMI I JETËS DHE VEPRËS SË FAN NOLIT NË KOSOVË	88
ZEQIRIJA IBRAHIMI: PRIFTI KRYEMINISTËR FAN S. NOLI.	102
SKENDER ASANI: LUFTA PËR IDENTITET KOMBËTAR TË SHQIPTARËVE ORTODOKSË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	106

HYRJE

Me rastin e 50-vjetorit të vdekjes së figurës poliedrike të kulturës shqiptare, të Shtetit Shqiptar e të Kishës Ortodokse Shqiptare, Fan S. Noli, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve më 20.11.2015 e organizoi një tribunë shkencore, e cila nuk kishte për qëllim vetëm përkujtimin e kësaj figure, por edhe ofrimin e studimeve më të reja për të.

Në këtë tribunë morën pjesë studiues të ndryshëm nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, të cilët ofruan kontributet e tyre për jetën dhe veprën e Nolit. Përveç studiuesve, në këtë tribunë sy mysafir i veçantë mori pjesë edhe At Nikolla Marku nga kisha e Elbasanit, i cili ishte në cilësinë e priftit ortodoks, që sipas ITSHKSH-së, vazhdon ta ruajë frymën noline të ortodoksisë shqiptare.

Duke përmbyllur një vit me plot vepra dhe aktivitete shkencore, ITSHKSH, përveç nderimit që ia bën kësaj figure, kumtesat e prezantuara në tribunë, i ka përmbledhur në këtë vëllim të SCUPI-t dhe kështu ka ofruar një vepër që i qaset enkas dhe me fokus shkencor personalitetit të Fan S. Nolit.

FAN NOLI – FIGURË EMBLEMATIKE PËR SHQIPEN DHE SHQIPTARËT

Të nderuar pjesëmarrës

Për të nderuar Fan Nolin 50 vjet pas vdekjes së tij (1882–1965), Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup ka organizuar këtë veprimtari shkencore, ku studiues të njohur do të spikasin nga këndvështrimet e tyre të ndryshme anë të panjohura apo më pak të njohura të Nolit tonë të madh.

Personalitet i letërsisë dhe i gjithë kulturës shqiptare, poet i shquar, historian e biograf, publicist, klerik, orator, kritik e dramaturg si dhe përkthyes i rrallë, Fan Noli me veprat dhe veprimin e tij i dha një ngjyrë të re jo vetëm letërsisë shqiptare, por dhe kohës në të cilën jetoi midis dy shekujve atij 19 e 20.

Fan Noli – një shumësi personalitetesh brenda një njeriu të vetëm, patriot i radhëve të para që bëri ç'ishte e mundur në fushën e diplomacisë për ruajtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve, si demokrat i shquar ai udhëhoqi Revolucionin Demokratik të Qershorit; e si klerik ai formoi Kishën autoqefale ortodokse shqiptare.

Veprat e tij kanë hyrë në fondin me të cilin kontribuon populli ynë edhe në kulturën botërore. Këto janë arsyt përse Nolin duhet ta vlerësojmë jo vetëm si figurë të shquar kombëtare, por dhe si figurë me peshë në fondin e kulturës botërore. Theofan Stylian Noli, si një personalitet i shumanshëm, njeri shumë i shkolluar e me kontribute domethënëse, nuk i takon vetëm pasurisë kombëtare shqiptare, por edhe asaj botërore.

Me këtë rast, duke ju falënderuar për pjesëmarrjen tuaj, posaçërisht referuesit, Konferencës i urojmë punë të suksesshme!

Fjala e hapjes e drejtorit të ITSHKSH, Skender Asani

QEMAL MURATI, ITSHKSH – SHKUP

FAN NOLI – KY LËVRUES I MADH I FJALËS SHQIPE

“Shqipëruet gjenial, me mjeshtri e shije si pakkush, në një masë më të madhe se çdokush tjetër, ky lëvrues i madh i fjalës shqipe, i çoi lart mundësitë shprehëse të gjuhës sonë duke kontribuar që të ngrihet kjo në rangun e gjuhëve më të zhvilluara, e aftë për të shprehur çdo mendim, sado të lartë, çdo ndiesi, sado të hollë.” – Mahir Domi

Fan Noli, si rrallëkush tjetër, është një institucion më vete, të cilit bota shqiptare i mbetet borxh për shumëçka. I mbetet borxh edhe gjuha shqipe, për fannolikatat e tij të papërsëritshme, po aq sa edhe ky i mbetet borxh gjuhës shqipe, që kjo gjuhë i dha atij forcën dhe krenarinë e të qenit shqiptar. Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë jo duke thënë fjalë të mëdha e të përzgjedhura për të në përvjetorë të rastit, por duke punuar për gjuhën shqipe e duke përdorur korrekt shqipen standarde. Për këtë gjuhë punoi aq shumë edhe ky tribun, për të cilën ne punojmë aq shumë për ta degraduar e rrënuar pamëshirshëm e barbarisht.

Është vështirë të thuhet sot se cili ishte roli më i rëndësishëm i Nolit: si letrar, si publicist, si historian, si kishtar, si politikan, si përkthyes, si muzikolog, si poliglot etj. Por, një gjë nuk është vështirë të dihet, që Noli ishte me më shumë njohje gjuhe dhe përdori shqipen më të rrjedhshme që mund të kesh sot.

Fannolikatat e papërsëritshme

Sa herë që e bie puna ta zëmë në gojë emrin e madh të Fan Nolit në ndonjë përvjetor të rëndësishëm, – sikurse është dhe ky i 50–

vjetorit të vdekjes, – kur lexojmë ndonjë vepër të tij apo kur ci-tojmë ndonjë mendim a thënie me vlerë, nga ato *fannolikat* (që të kujtojnë *filipikat* e Demostenit, fjalimet e famshme politike të tij kundër mbretit Filipit II të Maqedonisë), na shkon mendja gjithnjë te figura shumëdimensionale e tij: e poetit, historianit, politikanit, shtetarit, muzikantit, klerikut, përkthyesit, poliglotit nga më të spikaturit që ka pasur kombi ynë ndonjëherë. Por, asgjë më pak se këto nuk është figura e Nolit edhe si njohësi dhe përdoruesi më i mirë i shqipes dhe si kontributor i mendimit teorik dhe prodhimit edhe në fushën e gjuhës. Dhe pikërisht pse ishte njohësi, krijuesi dhe përdoruesi më i mirë i gjuhës shqipe dhe i shumë gjuhëve të tjera, ai është edhe poeti, oratori, publicisti e përkthyesi brilant i papërsëritshëm edhe nga anglishtja në shqip, si mund të thuhet, i krahasueshëm vetëm me figurën e mikut të tij të ngushtë dhe princit të gjuhës shqipe, Faik Konica.

Noli njihte gati të gjitha gjuhët kryesore të botës dhe është përkthyesi më i madh, më cilësor dhe i paarritshëm. Fan Noli nuk ka përkthyer vetem libra fetarë, po korifejt e botës, ai ka bërë Shekspirin të flasë shqip në përkthimet e tij (Gjenci Vllasi).

Për të qenë në lartësitë e tilla, Fan Noli nuk i pengonte aspak “gjuha e varfër shqipe”, siç u pengonte kjo gjuhë disa autorëve të tjerë të kohës së tij, apo siç u pengon edhe sot disa krahinarëve shqipja standarde. Përkundrazi, gjuha shqipe i jepte atij forcën si Anteut që i jepte toka. Me fjalën e tij pasionante, me oratorinë e tij brilante, me veprën e tij shumëdimensionale, e ngriti këtë gjuhë si në të shkruar e si në të folur në shkallën më të lartë. Dhe i dha kështu një krah të fortë standardizimit të gjuhës shqipe me prurje të reja e të mëvetësishme. Përbuzësit e shqipes, që e pandehnin për të varfër e për të padenjë për të folur me këtë gjuhë, Noli do t’i fshikullonte siç dinte vetëm ai:

“Ca autorë shqiptarë thonë se gjuha jonë është aq e varfër sa nuk mund t’i japësh një palë mend as një evgjiti. Po unë them që ata

autorë që thonë këtë, s'janë të zotët t'i japin mend evgjëtit as me ndonjë tjetër gjuhë. Kurrë mos pandehni se s'keni autorë të mëdhenj nga shkakut që gjuha nuk na ndih. Autori i madh është i madh edhe memec. Piktori i madh është piktor edhe pa duar. Gruaja e bukur duket një mijë herë më e bukur, po të jetë e veshur me leckë. Dhe idetë e bukura janë një mijë herë më të bukura të mbështjella me fjalët e varfra të popullit, se sa me fjalët e stolisura të filozofëve”.

Përbuzës të tillë të shqipes kemi edhe sot, madje me radhë të shtuara, të cilët këllasin të huajën përpara vendores dhe krahinoren përpara kombëtares. Veçse sot nuk kemi një Fan Nol që t'i fshikullonte e vetëdijesonte të tillët për ndërudhën që kanë marrë. Në konceptin e Nolit, mund të parafrazonim se faji nuk është te gjuha, as te gjuha standarde, që u pengon shumë disa krahinarëve e gjysmëpolitikanëve, sepse gjuha ç'të duash ka. Por faji është te përdoruesit e paditur e që përpiqen t'i bien më qafë gjuhës.

Për fjalët e huaja dhe neologjizmat e pakripura

Fan Noli gjuhën nuk e kishte thjesht vetëm dhunti e profesion, por e kishte edhe mision. Ai kishte njohuri të thella filologjike për strukturat të gjuhës, dhe jepte këshilla të drejta për purizmin e puristët. Për puristët e thekur Noli këshillon: “*Puristi që e qëron gjuhën e tij nga fjalët e huaja bën të kundërtën e asaj që dëshiron. E prish gjuhën e nuk e ndreq*”. Ai edhe vetë shumë fjalë turqishte i përdorte me vështrim përbuzës (si p.sh. *memur* për *nëpunës*), por disa të tjera i përdorte sepse ishin ngulitur tashmë në gjuhën shqipe. Në një fjalim të tij në Këshillin Kombëtar, si kryeministër i vendit, për të ilustruar sa më mirë një përkthim të tragjedisë së Hamletit, Noli thotë se do të përdor ca fjalë turqishte që të kuptohen më mirë. E një zëri që thërriste nga salla: “Shqip, shqip se nuk marrim vesh turqisht!”, Noli i jepte përgjigjen: “*Fjalët turqishte që kanë hyrë në gjuhë e që i kupton populli anembanë Shqipërisë, janë*

shqipe më e mirë se neologjizmat e pakripura dhe të pakuptueshme” (Noli 1977: 59).

Noli është mjeshër edhe në formimin e fjalëve të reja. Kështu, krahas fjalës së njohur *qeveri*, ai do të krijojë dhe opozitin *çqeveri*: *Shpejt a vonë populli do t'i kuptojë* fyçkat edhe faktet, *qeveritë dhe çqeveritë* (Noli 1977: 144). Ja një fjalëformim i ri i Nolit, *çqeveri* – për qeveritë e korruptuara, mashtruese. Sa shumë do t'i shkonte shqipes që kjo fjalë të përdorej edhe për qeveritë dhe qeverisjen e sotme.

Gjuha e jashtëzakonshme e Nolit krahasohet me gjuhën e mjeshërve më të mëdhenj që krijuan gjuhë: me Naimin, Fishtën, Mjedën, Konicën. Nuk ka sot shkrimtar e letrar që nuk i referohet gjuhës eprore të Nolit. Dhe ja një referim i tillë i shkrimtarit dhe publicistit Lazër Stani:

“Shqipja, si një ndër gjuhët më të vjetra, u krijua si gjuhë jo nëpërmjet shkrimit letrar (shkrimi i saj është fatkeqësisht i vonë) po nëpërmjet këtyre fëmijëve “të lindur me gojë” që gjatë mijëra vjetëve shprehën në shqip ndjenjat e tyre, ankthet, vizionet, ëndrrat, shpresat. Dhe arritën të krijojnë një gjuhë të jashtëzakonshme. *Gjuha e Konicës, Naimit, Fishtës, Mjedës, Nolit*, por edhe shkrimtarëve dhe përkthyesve të tjerë shqiptarë të shekullit të njëzetë nuk erdhi si një rastësi dhe as falë gjenisë së tyre gjuhësore. Kjo gjuhë tashmë ishte krijuar prej shekujsh, por ata mundën, falë instinktit të tyre të lindur për fjalën, të shprehen në shqip, duke e çliruar këtë “*gjuhë të Perëndisë*” me aq sa mundën nga ndotjet dhe barbaritë gjuhësore”.

Fan Noli ka kontribut të ndjeshëm në formimin e shqipes standarde. Me veprën e tij letrare e shkencore, historike e muzikore, me përkthimet e tij, me fjalën e përdorur prej tij, me sintaksën e tij, ai ka vënë edhe themelet e gjuhës letrare a standarde. Shqipja që flasin ne sot është produkt edhe i Fan Nolit në përvijimin e stileve,

në krijimin e fjalëve të reja, në përdorimin me qokë e me mjeshtëri të frazave, frazeologjisë, tekstologjisë, drejtshkrimit.

Për formimin e shqipes së sotme letrare, studiuesi më i mirë gjuhës së Nolit, Fatmir Agalliu, shprehet: *”Naimi, Samiu dhe Kristoforidhi janë themelvënësit e gjuhës letrare të përbashkët të kombit tonë dhe Noli është ndër kurorëzuesit kryesorë, në mos më i shquari, të procesit të ngjizjes dhe të ngulitjes së saj këto vitet e fundit... Ndihmesa e Nolit në përzgjedhjen e varianteve dhe në ngulitjen e normës është e ndjeshme. Kjo lidhet patjetër edhe me prestigjin e veprave të tij dhe me përhapjen e tyre, sidomos të përkthimeve të Historisë së Skënderbeut dhe të poezive”* (Agalliu 1995: 36, 37).

Sikurse pohon gjuhëtari i shquar Agalliu, *“Është gjë e ditur se në krijimin dhe ngulitjen e formës letrare të një gjuhe roli kryesor i takon letërsisë artistike, shkrimtarëve”*. E në këtë rol Noli bëhet *para- rendës i drejtshkrimit të sotëm*. Prandaj janë pa bukë kontestimet e tilla që i bëhen standardit sot nga disa inatçorë të çoroditur që kërkojnë krahinën në gjuhën e përbashkët dhe përmbyshjen e standardit, kinse për të rregulluar padrejtësitë që i qenkan bërë gegërishtes. Për të tillët publicisti dhe regjisor Xhelil Aliu do të shprehet:

“Duke bërë titur me të madhe për padrejtësitë e njërit dialekt ndaj tjetrit, apo duke bërë botime me dialektet e dikurshme të gegërishtes, të cilën nuk e kuptojnë lehtë as vetë gegët, mund të kënaqen vetëm ambiciet e disa inatçorëve të çoroditur, por, kurrësi nuk i vjen ndonjë e mirë gjuhës. Një frymë e tillë ka nisur të japë ndikimet e veta në të folurën e përditshme, sidomos tek një pjesë jo e pakët e kosovarëve, të cilët po priren nga dialektalizmat e thella, duke i u larguar standardit të gjuhës letrare. Se si mund “t’u hapet rrugë dialekteve, por pa ndëshkuar standardin”, këtë mund ta dinë tamam vetëm autorët e këtyre ideve. Siç thoshte i ndjeri Arbër Xhaferi, “Dialektet i takojnë feudalizmit— standardi letrar, shoqërisë dhe shtetit modern”. Dhe më poshtë vazhdon: “Standarti gjuhësor, mbase i vetmi ind që lidh shqiptarët e të gjitha anëve, tashmë

shndërrohet në instrument që do t'i përçajë shqiptarët, jo vetëm në gegë e toskë, por edhe sipas kufijve politikë”. (Të flasim shqip, por të merremi vesh!, Gazeta “Telegraf”, 28.5.2014).

Fan Nolin, si një erudit i pashoq i shqipes dhe i shumë gjuhëve të huaja, e ka shqetësuar në mënyrë të veçantë ruajtja e natyrës së shqipes kur shkruajmë. “Përse nuk vëmë re pak natyrën e shqipes?” – shprehej Noli. Po edhe ne sot, a nuk duhet t’ia bëjmë vetes këtë pyetje, kur shqipen e shkruar kemi kërrusur me gjithfarë ndërtimesh të çoroditura me frymë të huaj jo vetëm në fjalor, por edhe në morfologji, në sintaksë e në frazeologji?

Fan Noli dhe oratoria e tij politike

Fan Noli ishte brilant edhe në mendimin politik dhe në oratori, në ndërtimin e miqësive që na ka lidhur me kohë me Amerikën. Më 4 qershor 1959, në Kishën e Shën Gjergjit në Boston, në 100– vje–torin e Statujës së Lirisë, foli edhe F. Noli me *fannolik*at e tij:

“Amerika është nëna jonë kombëtare. Ajo na ka dhënë mënyrën amerikane të jetesës, demokracinë dhe mundësinë e barazisë. Ajo na ka dhënë katër liritë, d.m.th., lirinë në përgjithësi, lirinë e të mos–paturit frikë, lirinë e fjalës dhe lirinë e besimit. Tani që ne jemi mësuar në to, i marrim ato falas. Thjeshtë harrojmë se s’kishim asnjë prej këtyre në atdheun e vjetër dhe se shumë pak vende i gëzojnë ato tani. Kjo është dita e përtëritjes së kujtesës sonë. Në atdheun e vjetër, gjatë regjimit turk, popullit tonë nuk i lejohet t’i lutej Zotit në gjuhën e vet. Qeveria Turke e konsideronte përdorimin e gjuhës shqipe në shërbesa si subversive dhe peshkopët tanë demode mendonin se Ungjilli i Jezu Krishtit duhej të predikohej në një gjuhë klasike që s’e kuptonte njeri. Por ne besojmë se përdorimi i një gjuhe që kuptohet nga populli pajtohet me traditat më të vjetra të Kishës. Kjo traditë vjen që nga koha e Zotit tonë shpëtimtar, i cili u thoshte Apostujve të tij: “Shkoni ju dhe mësoni gjithë kombet”. Në përputhje me këtë urdhëresë ne i kemi sjellë popullit mesazhin

e Zotit, duke shërbyer, predikuar dhe përhapur literaturë në gjuhën që kuptojnë, d.m.th., në shqip. Deri tani kemi botuar 14 libra liturgjike kryesore, 10 prej tyre në gjuhën shqipe dhe 4 në anglisht. Dhe tani brezi i ri gjithashtu mund të ndjekë shërbesat në një gjuhë që e kupton, d.m.th., në anglisht.

Këto arritje u bënë të mundura në sajë të lirisë së besimit dhe të shumë mirësive që gëzojmë në këtë demokraci të madhe. Jemi mirënjohës që jetojmë në tokën e njeriut të lirë. Zoti e bekoftë Amerikën!”

Më bukur se kaq, më mirë se kaq, nuk dimë që mund të flitet e të shkruhet për Amerikën që i mbrojti kurdoherë shqiptarët. Për Amerikën që vërtet është Nëna jonë. Nuk dimë se mund të flitet më mirë për përdorimin dhe mbrojtjen e shqipes edhe në predikimet liturgjike.

Fan Nolit bota shqiptare i mbetet borxh gjithnjë. I mbetet borxh edhe gjuha shqipe për fannolikatat e tij të papërsëritshme, po aq sa edhe ai i mbetet borxh gjuhës shqipe që i dha atij forcën dhe kre-narinë e të qenit shqiptar.

Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë kur të punojmë për gjuhën e “përbashkme shqipe”

Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë jo duke thënë fjalë të mëdha e të përzgjedhura për të në përvjetorë të rastit, siç është edhe ky përvjetor. Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë në radhë të parë edhe duke përdorur korrekt gjuhën e sotme shqipe, në shkollë e në universitet, në administratën shtetërore e publike, në medie, për të cilën punoi aq shumë edhe ky tribun, që me fjalime të zjarra e me shkrime të fuqishme mbrojti të drejtat e popullit tonë, e mbrojti këtë gjuhë dhe luftoi për një çështje të madhe kombëtare. Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë kur të punojmë për gjuhën e “përbashkme shqipe” (siç thoshin rilindësit) dhe kur të mos pu-

nojmë për ristandardizimin e shqipes standarde. Me një fjalë, kur ta kujtojmë Fan Nolin, ne duhet ta kujtojmë edhe gjuhën shqipe, të mos e flasim shqipen si çobanët e Sharrit, siç thoshte një publicist dhe studiues i ideve (Naser Aliu). Ndryshe, ne nuk e kujtojmë Fan Nolin në dimensionet e tij. Por e kujtojmë në varfërinë tonë kulturore e shpirtërore, në të kundërtën e tij. Bëhemi kinse e kujtojmë, sa për demagogji e pozë.

Të rrallë janë ata që e kanë folur dhe e kanë shkruar gjuhën shqipe si Fan Noli. Ja si flet e shkruan ai me një program përpara popullit të Korçës për bujqësinë: “Shqipëria ka pasurinë që duket, e cila është përmbi tokë dhe pasurinë që s’duket, nën tokë. Uroj me gjithë zemër që pasuria nën tokë të jetë më e madhe se sa e kup-tojmë, po është marrëzi të kryqëzojmë duart e të presim të gjitha të mirat nga kjo pasuri problematike e të lëmë të pazhvilluar pasurinë *parintare* (ja një fjalë e re e Nolit *pasuri parintare* = pasuri e parë, themelore, kryesore, për bujqësinë), e cila sikundër na sigurojnë të gjithë ekspertët e huaj, është e *mjaftë* (ja një ndajfolje e përdorur si mbiemër) për të ushqyer dhjetë herë më tepër *ndenjës* (ja dhe një neologjizëm tjetër *ndenjës* për “banor”) se sa ka Shqipëria sot” (Noli 1977: 70). Për punë të pasurive, gjuha e Nolit është pasuri *parintare* (e parë, kryesore) që na jep pamjen e mjeshtrit të madh.

Martin Camaj, në esenë “Mbi funksionin e gjuhës së Nolit dhe Konicës”, heton se “si Noli ashtu dhe Konica në shkrimet e tyre patën parsysh gjithnjë që të kuptoheshin nga gjithë shqiptarët. Këtij qëllimi ia arritën me një përqindje të lartë. Rruga që ata ndoqën qe kjo: ata zgjodhën forma të rrafshita stilistike, u larguan me qëllim nga variantet e shumta të leksikut nëndialektor të formave morfologjike të rralla. Pa ditur ndoshta, iu përmbajtën disa principeve, ndjekja e të cilave çon drejt një njësimi gjuhësor” (Shamku 2013).

Fan Noli lëvroi e mbolli shumë për kulturën shqiptare, e mbi të gjitha mbolli farën e një shqipeje... fannolikatat. Shqipja në laboratorin e Fan Nolit i ka gjitha lulet dhe shprehësitë e saj. Prandaj

veprat e Nolit lexohen me ëndje e me kënaqësi dhe kuptohet lehtë nga të gjithë.

Për njohjen e gjuhës Jean Herbert thoshte: *“Të njohësh një gjuhë është shumë më tepër se një leksik dhe një sintaksë. Duhet njohur të gjitha nivelet e gjuhës, nga më i kulluari te më popullori, duhet njohur veçoritë krahinore, apo sociolektet, me fjalë të tjera të gjitha shmanigjet gjuhësore, duhet pasur edhe një kulturë njaftueshëm të thellë për të zbuluar citimet apo referencat që i bëhen një veprë, një imazhi, një kujtesë kolektive”*. Në këtë kuptim, Noli i njihnte të gjitha këto nivele të gjuhës idealisht. Ai krijoi një simfoni të madhe për gjuhën dhe krijoi një shqipe të madhe për nevojat komunikuese të një kombi të vogël. Në farkën krijuese të Nolit shqipja rrjedh shqip në të gjithë dejtë e saj.

Noli, për vlerat njohëse të gjuhës e të kombit, thoshte: *“Lëvizja për të ngritur gjuhën shqipe në shkallë kombëtare nisi në Toskëri”* (Agalliu 1999). Ai këtë e pohonte jo se i përkiste të folurës jugore, por sepse kjo ishte gjendja reale që e kishte arritur shqipja falë punës së çmuar të shkrimtarëve, e ku një kontribut të pallogaritshëm ka dhënë edhe ky kryeshkrimtar e kryeautor Fan S. Noli. Vërtet Fan Noli ka qenë më jetëshkurtëri në pushtet ndër ata që kanë qeverisur Shqipërinë, por Fan Noli është ndër ata shkrimtarët që si krijues gjuhe e bahçevan i shqipes, si stilist, mbetet jetëgjatë në letrat shqipe që nuk ia lëshon kurrkujt kryet e vendit.

Është vështirë të thuhet sot se cili ishte roli më i rëndësishëm i Nolit: si letrar, si publicist, si historian, si kishtar, si politikan, si përkthyes, si muzikolog, si poliglot etj. Por, një gjë nuk është vështirë të dihet, që Noli përdori shqipen më të rrjedhshme që mund të kesh sot.

Fan Nolit do t'i shkonin fjalët që ky vetë i thoshte për Faik Konicën: *“Faik Konica, njohës i mirë i pesëmbëdhjetë gjuhëve të huaja, që e fliste frëngjishten si një francez dhe që e fliste anglishten*

si një anglez, ishte pa dyshim dhe ustai më i madh i shkrimit të gjuhës shqipe”.

Fan Nolin ne nuk duhet vetëm ta përkujtojmë në raste përvjetorësh, por duhet edhe të mësojmë prej tij se si duhet të punojmë për gjuhën shqipe dhe si ta flasim shqipen shqip.

BIBLIOGRAFIA

- Agalliu 1995 = Agalliu, Fatmir, Fan Noli dhe gjuha letrare e kohës sonë, “Gjuha jonë” 1–4, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1995.
- Agalliu 1999 = Agalliu, Fatmir, *Gjuha e Nolit*, Tiranë 1999.
- Noli 1977 = Fan S. Noli, Topi i lidhur, Rilindja, Prishtinë, 1977.
- Shamku 2013 = Shamku Shkreli, LediSaga e fininisë”, energjia gjuhësore e At Zef Pllumit, Shqiptarja.com, 29.9.2013.

XHEVAT LLOSHI, TIRANË

PËRKTHIMI I NJË TEKSTI NGA FAN NOLI

Sa herë përmendet Fan Noli si përkthyes, menjëherë shtohen disa cilësime për mjeshtërinë e tij të lartë në këtë fushë. Kohët e fundit janë ndërmarrë edhe punime krahasuese për veprat e përkthyer prej tij, në veçanti nga anglishtja. Ndërkaq, përveç cilësimeve në rastin e parë dhe shqyrtimit të fjalëve e fjalive në rastin e dytë, nuk e gjejmë të shprehur se çfarë konkretisht e ka bërë Fan Nolin të fitojë vlerësimet e merituar, as edhe përse shpesh flitet jo për përkthime prej tij, por për shqipërime. Besoj se po të niseshim nga një këndvështrim tjetër, mund t'i afroheshim sado pak qartësinë të kësaj ane të arritjeve të tij, të cilat mbeten përshtypjelënëse edhe në ditët tona.

Noli kur niste një përkthim, nuk ulej përpara një teksti dhe thjesht gjente barasvlerëset shqipe të fjalëve dhe të fjalive në një gjuhë të huaj. Para së gjithash, ai kishte një vlerësim të shumanshëm vetjak për veprën përkatëse të autorit të huaj, prandaj nuk është e rastit që ka shkruar edhe *Introduktat* e njohura. Për më tepër, zgjedhjet e tij bëheshin duke peshuar se çfarë do t'i sillte vepra lexuesit shqiptar, si do të tingëllonte në mjediset me problematikën shqiptare të kohës dhe prandaj *Introduktat* nuk janë ngushtësisht vështirime kritike letrare, por edhe publicistikë e mirëfilltë, domethënë aktualizimi i tematikës së tyre në rrethanat e Shqipërisë. Pikërisht këtu fillonte “shqipërimin” nga ana e tij dhe jo vetëm te prirja për përkthim të lirë, apo për gjetjen e barasvlerësive më të goditura artistike të mjeteve leksikore e stilistike.

Kur është rasti në veçanti për veprat dramatike, sërish Noli nuk u qaset si përkthyes i zakonshëm. Ai vjen aty me përvojën e viteve të para të jetës, kur luante në skenë si aktor dhe e dinte përmendsh

çdo dramë. Replikat e tekstit ai i përjetonte si aktor, domethënë i mendonte se si do të tingëllonin në skenë, kur të ishin në gojën e aktorit drejtuar shikuesve. Në një farë mënyre, Noli bëhej njëherësh aktori i të gjithë personazheve të pjesës, e shihte veten si mishërues të secilit karakter, ndërsa ëndërronte të luante rolin kryesor. Po ta vështrojmë pak më ndryshe, kur përkthen vargjet e famshme të Hamletit “Të rrosh a të mos rrosh”, në të vërtetë është edhe vetë Fan Noli që e bën këtë pyetje nga ana e tij. Këtë karakteristikë e gjejmë të shprehur mjaft qartë në *Autobiografinë* e tij, kur vë në dukje se sa herë ndodhej përpara një udhëkryqi të vështirë, bënte pyetjen: Çfarë do të bënte Jezui në një rast të tillë? Çfarë do të bënte Skënderbeu në një rast të tillë?

Prej këndej kuptohet përse kur përkthente Noli, nuk kishte përpara fjalë e fjali, që duheshin kaluar nga gjuha e huaj në shqipen, madje nuk kishte përpara veçse një tekst, por kishte një pamje njerëzore të shndërruar në një tekst. Pyetja shtrohej se si kjo pamje njerëzore do të rifitohej në gjuhën shqipe. Duke e shprehur me terma të tjerë, do të thosha se Fan Noli nuk vështroi vetëm fenotekstin, objektin fjalësor si një strukturë thëniesh konkrete, por vëmendjen e ka te gjenoteksti, te prodhimi dinamik i tekstit, që të dalë kuptimi i tij në marrëdhënien me interpretuesin e tij, domethënë me lexuesin shqiptar, në një gjuhë kështu të ndryshme nga ajo e autorit. Në këtë pikë ka rëndësi të vihet në dukje, se kemi të bëjmë vërtet me gjuhë të ndryshme, domethënë nuk ka mundësi që të arrihet njëjtësia me gjuhën tjetër. Synimi kryesor atëhere mbetet që të arrihet sa më afër të jetë e mundshme njëjtësia me pamjen njerëzore që ka mishëruar autori i origjinalit në gjuhën e huaj përkatëse, pa harruar se edhe përvoja njerëzore nga mënyra se si lëndëtohet në gjuhë të ndryshme natyrisht që nuk është identike.

Së fundi, në rastin e veprave letrare mbetet e pashkëputur edhe ana estetike. Pavarësisht se cili është ideali estetik për objektet fjalësore te rryma të ndryshme letrare, te epoka të ndryshme dhe te autorë të ndryshëm, teksti i përkthyer duhet të tingëllojë edhe bukur. Me

këtë shpjegohet, përse përkthimi i “Rubaive” të Omer Kajamit nga Ali Korça sigurisht që është shumë më afër originalit nga disa pikëpamje, e përsëri nuk mund të rivalizojë nga asnjëra pikëpamje me përkthimin e Fan Nolit, i cili ka arritur të rimishërojë shqip një tekst me vlera artistike. Rubaitë e Nolit janë përshtypjelënese, ngjallin ndjenjë, rrjedhin gjuhësisht, tingëllojnë muzikalisht, nguliten menjëherë në mendje, kanë ritëm, shkurt: janë të bukura.

Mund të shkruhet shumë gjatë për këto çështje, por në këtë rast kam marrë vetëm një përkthim të Fan Nolit, i cili besoj se mjafton si dëshmi bindëse për të treguar, që Fan Noli përkthente një tekst që mishëron një pamje njerëzore të shndërruar në gjuhën e letërsisë, domethënë në gjuhën që synon të ngjallë skena, karaktere, veprime, ndjenja me efekt artistik.

Dramën e dytë të Shekspirit Noli e përktheu më 1926. Qeveria e tij ishte rrëzuar me dhunë nga Ahmet Zogolli dhe bashkë me të tjerë Noli ishte arratisur e ndodhej në Berlin. E shënon në “Introduktë” datën gusht 1926. Ishin vrarë Bajram Curri dhe Luigj Gurakuqi pak më parë. Pikërisht po në këtë vit ai shkruan dy elegjitë e fuqishme për ta. Nuk është e vështirë të kuptohet kështu, përse ai zgjedh të përkthejë “Makbethin”. Në “Introduktë” e nënvizon, që tragjedia e Shekspirit i kundërvihet Makiavelit dhe kishte si motiv qendror të dëshmonte, se ai që e nis qeverimin me gjakderdhje dhe terror është i shtrënguar fatalisht të vazhdojë ashtu si e nisi, s’kthehet dot mbrapsht, hyn thellë e më thellë sa vete. Për Nolin, Shekspiri na tregon një histori dhe na lë ta nxjerrim vetë përfundimin. Madje e quan se kjo është më e lehta ndër tragjeditë shekspiriane për ta kuptuar. Lexuesi shqiptar i kohës dhe spektatori i mëpastajmë njëkohësisht do ta kishin të lehtë për ta kuptuar, se regjimi i vendosur me dhunë në Shqipëri do të ecte po në atë rrugë, do të kishte po atë fat. Në këtë mënyrë Noli e sillte tragjedinë në rrethanat shqiptare dhe kjo e kushtëzonte përkthimin, domethënë qysh këtu niste “shqipërimi”. Më duket se hedh dritë për këtë pikë edhe mënyra se si regjisori i njohur japonez Akio Kuro-

sava ka bërë një film: ai ka marrë tekstin e “Makbethit”, por mjedisi historik dhe personazhet janë tërësisht japonezë. Megjithëse bota mesjetare japoneze ishte tjetër gjë me samurajët e luftërat e tyre, përsëri filmi dëshmon natyrën universale të temës që kishte përpunuar Shekspiri, duke treguar se kush i hyn rrugës së pushtetit nëpërmjet dhunës, do të përmbysset nga dhuna, domethënë pavarësisht se kjo aktualizohet në Japoni apo në Shqipëri.

Ndërkaq, Noli nuk vë përpara një tekst të shkruar për të kapërcyer çështjet gjuhësore. Ai hyn në një skenë, kërkon ta perceptojë atë skenë dhe do t’i suflojë secilit aktor e secilës aktore se çfarë të thotë, domethënë edhe njëjtësohet alternativisht me secilin e me secilën. Akti i parë, skena e parë (AI, 1) është në një vend të shkretë (A desert place). Noli ka përdorur “yrt”, që është një turqizëm, të cilin nuk e ka as *Fjalori i orientalizmave* i T. Dizdarit (2005) me kuptimin e vendit dhe të atdheut. Dëgjohen bubullima e shkrepitje vetëtimë, sepse sipas mitologjisë magjistricat janë në gjendje t’i ndiellin; ky është mjedisi i tyre, ato hyjnë në skenë dhe pyesin se kur do të takohen përsëri.

- *Kur pigëni të tria përsëri, / Në bubullimë, vetëtim’ a shi?*
- *Posa shamat’ e luftës të pushonjë / dhe dita mundësin të na tregonjë.*
- *Pra, posa dielli të perëndonjë.*
- *Po ku?*
- *Këtu në rrethin.*
- *Këtu e hasim dhe Makbethin.*
- *Ja ku po vijn, Zonja Lubi.*
- *Ja ku po kthehem.*
- *Ja tani.*
- *Zbarth e zeza, dhe e bardha nxin; / Er’ e ndyr’ e mjegull na përpin.*

Katrahurën e luftës Noli e ka quajtur “shamatë”, ndërsa do t’i dilte e ndërlikuar po ta jepte të përpiktë sipas anglishtes rreshtin tjetër:

“Kur beteja do të jetë e humbur [nga njëra palë] dhe e fituar [nga tjetra]”. Për përkthyesin ka rëndësi që spektatori ta kuptojë, se është fjala që përleshja do të mbyllet me dikë që fiton: *dita mundësin të na tregonjë*. Këtu tashti ndërhyjnë një faktor tjetër i tekstit. Në origjinal radhët kanë pjesërisht rima. Noli është përpjekur që edhe këtë veçori ta ruajë, duke i bërë vargjet të rimojnë, por natyrisht, me rima të varfra me mbaresat foljore (pushojë, perëndojë, tregojë) dhe me “i” të theksuar (përsëri, shi). Kjo e ka detyruar që për “Makbethin” të vendosë me rimë “rrethin”. Në origjinal fjala ishte për një shqopishtë, domethënë e ka zëvendësuar me një fjalë të përgjithshme, si rrethi aty rrotull. Madje në AIII,5 “A Heath” nuk do t’i dilte me “rreth” dhe e ka dhënë . . . *Një Yr!*

Më pas i shfaqet kërkesa për të gjetur shqip nofkat e lidhura me magistricat. E para përmend Greymalkin, domethënë macen e përhimë; e dyta thotë se po i thërret Paddock, këtu me kuptimin e thithëlopës; e treta do të shqiptojë vetëm në A4,1 fjalën Harpier, një lloj shqiponje grabitqare. Atëhere përkthyesi i ka lënë mënjane dy nofkat anglisht dhe e ka dhënë të parën si figurë të kuptueshme shqip: *Zonja Lubi*. Ndërsa për të dytën replika *Paddock calls* i ka mbetur “Ja ku po kthehem”, nofka ka rënë. Në shqip do të kishim përkthimin barasvlerës fjalë për fjalë:

- *Po vij, Mace e përhim!*
- *Thithëlopa po thërret.*
- *Qetash.*

Arsyeja për variantin e Nolit është se marrësi shqiptar nuk është aspak i familjarizuar me botën e magistricave angleze, rrjedhimisht ky përkthim i përpiktë nuk do t’i ngjallte gjë në mendje. Po edhe më interesante është replika e të triave bashkë. Fjalë për fjalë do të ishte:

*E qashtra është e qelbur dhe e qelbura është e qashtrë,
Flatro përmes njëgullës dhe ajrit të ndyrë.*

Noli atëhere ka gjetur një kundërvënie që të përçojë botën e mbrapshtë të magjistricave dhe pastaj i ka larguar nga skena. Lexuesi shqiptar ndërkaq ka hyrë në atë atmosferë.

Por më i vështirë ka qenë trajtimi, kur do të vinte Akti IV,¹ me formulat e magjirave. Sidoqoftë, ai ka pasur një rrethanë lehtësuese: për anglezin e kohëve të reja e gjithë ajo mendësi me shtriga e me namatisje dhe me ligjëraten përkatëse tashmë ishte shumë e largët, ashtu siç po bëhet për brezin e ri të ne vetëm tashti. Ndërsa kur përkthente Noli namatisjet dhe ligjëratat e tyre fsheharake ishin krejt të gjalla për folësit e shqipes. Rrjedhimisht, ai është përpjekur të kalojë në këtë botë, që mundësisht të rrokej e afërt për atë auditor.

(1) – *Mac’e murme mjaulliti.*

(2) – *Tri her’ eshi derr gërriti.*

(3) – *“Ardhi koha!” Harpja briti.*

Te (1) mbiemri ‘brinded’ mund të përkthehej edhe ‘e përhimë’, po të ruhej lidhja me AI,¹ mirëpo përkthyesi ka ruajtur tetërrokëshin e origjinalit dhe e ka lënë jashtë edhe pjesën e parë të fjalisë. Te (2) fjala ‘esh’ është sllavizëm krahinor për iriqin, madje as nuk ka ndonjë ‘esh derr’ në gjuhën shqipe, domethënë është kalkim. Te (3) në origjinal Harpja ka bërë titur dy herë në origjinal. Shmangia nga anglishtja është mjaft e dukshme, por shqip kanë dalë tre tetërrokësja të rimuar, sepse duhej krijuar atmosfera ritmike e ligjërimit misterioz të tri magjistricave rreth kazanit. Gjithçka përshtatet me dy vargjet, të cilat ato i përsërisin së bashku të tria:

Trubull, trubull, avullo;

Digju zjarr, kazan valo.

Rrjedhimisht, semantika e fjalëve dhe e fjalive të veçanta e humbet rëndësinë, mjafton teksti në tërësi të jetë afër origjinalit nga përshtypja që duhet të krijojë si namatisje, jo si kumtim i një domethënieje reale; si akt magjie dhe jo si komunikim i kuptueshëm.

Po të shihen njësitë leksikore një nga një, do të thuhej se përkthyesi nuk ka ditur si t'i jepte shqip, mirëpo ai është përpjekur jo të përkthejë, por të ndërtojë një tekst shqip që të ngjallë atë përfytyrim te spektatori, i cili sheh tri magjistricat rreth kazanit, e pranon që kjo është punë magjie dhe ndikohet më shumë nga aliteracionet dhe grumbullimet fonetike, që të bashkëtingëllojnë me gurgullimin e kazanit të nxehtë. Ne i njohim këto përftesa fonetike të Nolit aq të goditura në vjershat e tij, si p.sh. *Dif- dragoj i Dragobisë. Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, batërma. Ferra çjerr e guri grin. Dhe më ngjethë, dhe më derthë, Tmerre që s'ndjeva kurrë.*

Anglisht dy vargjet që përsëriten si refren janë:

*Double, double toil and trouble,
Fire burn and cauldron bubble.*

Të përkthyerat fjalë për fjalë do të ishin:

*Dyfish, dyfish shkëpurdhu e trubullo,
Digju zjarr e kazan gurgullo.*

Duke i vënë krahas vargjet e përkthimit të Nolit dhe vargjet e anglishtes të përkthyerat pikë për pikë bëhet e qartë metoda e punës së tij. Po sjell nga kjo skenë vetëm të yshturat e magjistares së dytë, pa bërë komente për gjithë mospërputhjet e dukshme në sipërfaqe:

*Kokë gjarpri laragan,
Fashë e gjarprit të moçalit
Ziej, piqu në kazan;
Në kazan ziej e piqu,
Sy kuçedre, bisht bretkosë,
Sy tritoni dhe gisht bretkose,
Gjuhë qeni, qime dose,
Lesh lakuriqi dhe gjuhë qeni,
Cfûrk nepërke, thumb prej grere,
Sfûrk nepërke dhe thumb kakëzogëze,*

*Panç' agrepi, gjemp prej ferre,
 Këmbë hardhuce dhe krah kukumjaçke,
 Për magji e gjëmë ferri
 Për një magji trubullimi të fuqishëm,
 Zieni si çorbë derri.
 Si çorbë ferri ziej e gurgullo.*

Mund të merret kështu çdo faqe e çdo replikë, duke u bërë komentin e plotë skenës, marrëdhëniet e karaktereve, çastit emocional e rrethanave të komunikimit, të cilat kushtëzojnë në tërësi tekstin gjuhësor, që gjatë përkthimit nevojitet t'i përcjellë të gjitha këto sa më mirë në gjuhën shqipe, madje duke ruajtur organizimin e replikave dhe të ritmit e rimave të vargjeve. Nuk ka nevojë atëherë për ta shqyrtuar gjithë tragjedinë nga ky këndvështrim, prandaj po kaloj te fjalët e fundit të Malkolmit, që e mbyllin veprën dhe që janë më afër ligjërimit të zakonshëm, më prozaikë:

*Pa humbur kohë do t'jua çpërblen,
 Jo veç e veç po tok, besnikërinë
 Dhe dashurin' e fortë që më çfaqte.
 Të dashur kushërinj e Thanër trima,
 Që sot po jini kontër, me një titull
 Që së pari jipet në Skotlandë.
 Me vrap i ftojme miqt' e syrgjynosur,
 Që iknë nga pusit' e tiranisë,
 Të kthehen prapë në shtëpit' tyre;
 Pastaj dënojmë veglat e pashpirtme
 Me larot e këti gjakderdhësi
 Dhe të kuçedrës mbretëreshë', e cila
 Siç thuhet, paska vrarë vetë veten;
 I bëjmë pra më hir të Perëndisë:
 Me mas' e koh' e vënt, pas drejtësisë:
 Ju falem nderit dhe ju ftonj në Skonë
 Për festën e kurorëzimit tonë.*

Është fjala e ngazëllimit të fitores dhe e falënderimit, e shpërblimit për luftëtarët që e mundësuan atë fitore; anasjelltas, e dënimit për fajtorët e tiranisë. Po të shihet me pedantëri, përkthyesi ka shtuar fjalët: *veç e veç, po tok; e fortë; çfaqë; të dashur; me vrap; pas drejtësisë*. Ka dhënë të tjera përkthime me fjalët: *të kthehen prapë; pasi; veglat; gjakderdhës; kuçedër*. Ndërsa ka lënë jashtë fjalët e origjinalit: *large; before; several; in such an honour named; what's more to do; planted; abroad; watchful; producing forth; dead; violent hands; what needful else that calls upon us; all at once and to each one; to see us*. Kjo do të thotë se një përkthyes tjetër pa dyshim mund të jepte një variant të ndryshëm. Po sjell vetëm karakterizimin e mbretëreshës si “kuçedër”, që mund të thuhej “pjellë e djallit” e kështu më tej. Mirëpo edhe varianti tjetër do të ishte i shtrënguar të mbante parasysh të paktën dy kërkesa themelore. E para, të jepte shqip po aq lëndë fjalësore sa e kërkon numri i vargjeve dhe numri i rrokjeve për çdo varg. Dihet se duke i ndenjur sa më besnik origjinalit, në shumicën e rasteve teksti i përkthyer del me më shumë lëndë gjuhësore dhe kjo pranohet pa rënë në sy në prozë, porse nuk ka vend në shtratin e ngushtë të vargjeve. Së dyti, edhe secili varg ka shtrëngesat për të ruajtur ritmin, për të organizuar theksat dhe ndonjëherë për të arritur rimën. Përpikëria fjalësore e ka pothuaj të pamundur t’i plotësojë njëherësh të gjitha këto kërkesa.

Në këto rrethana është ndjekur ndonjëherë edhe praktika për ta përkthyer poezinë si tekst në prozë me besnikëri ndaj origjinalit. Produkti është një tekst didaktik, për të rrokur domethënien, por jo një tekst me vlera artistike. Kurse Nolit i duhej një monolog në vargje i mbretit të ri fitimtar, i cili krejt ndryshe nga tirani i mëparshëm i do dhe i nderon bashkëluftëtarët, i dënon ushtruesit e tiranisë, kërkon drejtësinë dhe fton për gëzinin e vet që e pret. Dhe të gjitha këto duhet t’i mishërojë me fjalën e vet të gjallë aktori që do ta shqiptojë monologun në skenë për të mbajtur të pashkëputur vëmendjen e shikuesve.

Së fundi, mbetet edhe një faktor historik i pamënjanueshëm. Së pari, gjuha evoluon gjatë shekujve, kurse teksti original mbetet i ngurtësuar në epokën kur është krijuar. Ka përftesa të ndryshme për ta dhënë shijen e gjuhës tashmë të vjetruar, por ato ndeshen me pengesën e fortë të kërkesës që teksti sidoqoftë të jetë i kapshëm për lexuesin bashkëkohor. Së dyti, edhe vetë përkthyesi është i ngërthyer në etapën e gjuhës të kohës së vet dhe njëkohësisht në rrethin e njohurive vetjake të thesareve gjuhësore. Për këto dëshmojnë si veçoritë, të cilat ndihen si shmangie nga norma e sotme e ngulitur, ashtu edhe ndikimet nga gjuha e origjinalit, sepse gjuha e lëvruar ecën përpara edhe nga pikëpamja e ballafaqimit me gjuhët e huaja. Mjafton emërtimi i vendit Skotlandë, siç e ka dhënë Noli sipas anglishtes, kundrejt *Skocisë* që përdorim sot rregullisht. Një vërtetim e kemi edhe nga shembujt e “Introduktës”, e cila nuk është përkthim. Edhe aty e kemi emrin e Skotlandës, madje për “skocez” e ka *skotez*. Po njësoj ka: *Ingli* dhe *ingliz*, që për ne tashmë janë të vjetruara. Madje edhe vetë termi *Introduktë* është prej trajtës së anglishtes dhe nuk ka gjetur përhapje në shqipen. Ashtu si dhe në vepra të tjera, Noli përdor anglicizmin “liberator” për ‘çlirimtar’ (*Ky Vigan Liberator* te ‘Syrgjyn—vdekur’). *Terroristik* shqipja e ka përvetësuar pa zgjerimin me parapshtesë, domethënë thjesht ‘terrorist—e’. Fjalë e trajta të tjera të huazuara aty, që nuk kanë gjetur vend, janë: vijtore, invazje, punitje, sermon, kontroversial, monomania, vizualizata, noktambul, konkluzje. Kurse shembulli më bindës i rrethit të njohurive vetjake është çerdhja e foljes *zптоj*, një huazim nga turqishtja, sepse Noli nuk e njihnte foljen *pushtoj* me çerdhen e saj.

Edhe nga ky vështrim krejt i pjesshëm dalin qartë vështirësitë e panumërta për të arritur një përkthim të cilësisë së lartë, i cili nuk përbën thjesht gjetjen në fjalor të barasvlerëseve të fjalëve, por ngërthen një varg kërkesash të ndërlikuara, të cilat përmbushen në radhë të parë duke e vështruar tekstin si një tërësi të organizuar, për të dhënë atë pamje njerëzore që ka krijuar autori me qëllimin jo

vetëm për të përçuar një brendësi me veprime, ide e mendime, por edhe për të arritur efekte artistike te lexuesi ose shikuesi. Fan Noli u ka kushtuar kujdesin më të madh pikërisht këtyre anëve dhe ky është çelësi i mjeshtërisë së tij. Natyrisht, për këtë nuk mjaftojnë njohuritë dhe dëshira, por nevojiten edhe talenti e përvoja, të cilat Nolit nuk i kanë munguar.

VATRA E SHQIPTARËVE TË AMERIKËS DHE NOLI

Në nisje të dekadës së dytë të shekullit XX, disa shoqata kombëtare të bashkësisë shqiptare zhvillonin veprimtarinë e tyre në Shtetet e Bashkuara. Shoqata *Besa-Besën*, themeluar nga Noli më 1907, propozoi bashkimin e të gjitha shoqatave në një organizatë të vetme panshqiptare. Atëbotë, kishte 12 shoqata shqiptare dhe pjesa më e madhe e tyre pranuan ftesën e Fan Nolit dhe të Faik Konicës për konsolidimin e tyre në një shoqëri të vetme. Andaj, më 28 prill 1912, shqiptarët krijuan *Vatrën*, shoqatën e tyre të njohur që shërbeu me dekada si "vatër" e veprimtarisë së gjerë patriotike, politike dhe kulturore në Shtetet e Bashkuara. Historia e gjatë dhe kontributet e pakontestueshme të Vatrës në aspektin kombëtar janë përshkruar në hollësi në një libër të botuar nga Fan Noli, me titull "Kalendari", të botuar në vitin 1918.

Që nga themelimi i saj, Vatra ka dëshmuar frytet e punës së Fan Nolit dhe të bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë duke shërbyer për vite si një zë i fuqishëm në propagimin e identitetit dhe duke ndihmuar konsolidimin kombëtar. Kjo organizatë gjithëshqiptare kishte më një kohë 63 degë në mbarë Shtetet e Bashkuara dhe ndiqte një veprimtari të gjerë duke kontribuar gjerësisht për kauzën kombëtare. Rreth vitit 1920, Vatra shërbeu si qeveri në ekzil për një kohë, kryesuar nga Fan Noli, Faik Konica, etj. Vatra ishte qendër gjithëpërfshirëse e aktivitetit të shumëfishtë diplomatik, politik, gazetaresk dhe akademik të Fan Nolit. Duke ia njohur meritat e mëdha kësaj organizatë në të gjitha fushat, Fan Noli konsideronte se themelimi i saj ishte "një ngjarje e madhe e lëvizjes kombëtare shqiptare".

Kontributi i parë i Vatrës ishte gjatë pjesës intensive të lëvizjes kombëtare, në vitin 1919, me ç'rast u tubuan 40 mijë dollarë amerikanë, një shumë e konsiderueshme në atë kohë, për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Konferencën e Paqes në Paris. Imigrantët shqiptarë iu përgjigjën me zemërgjerësi ftesës së Vatrës për të mbështetur financiarisht Shqipërinë. Noli iu bashkua ftesës përmes poezisë së mirënjohur "Jepni për nënën", që ishte një ftesë prekëse drejtuar shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara, me vargjet "Mbahu nëno, mos ki frikë/ se ke djem të në Amerikë".

Me paratë e tubuara gjatë "fushatës së qershorit", vatanët dërguan në Konferencën e Parisit një delegacion të përbërë nga Mehmet Konica dhe Dr. Mihal Turtulli. Shqiptarët e mbledhur tek Vatra kishin për detyrë t'i tregonin botës se shqiptarët e besimit ortodoks nuk ishin grekë. Në emër të Federatës Pan-Shqiptare Vatra, Dr. Mihal Turtulli i dërgoi një telegram Presidentit Uilson, duke i ofruar fakte kundër pohimeve greke mbi numrin e grekëve në jugun e Shqipërisë.

Në ballafaqim me aspiratat greke, Vatra luajti një rol të pazëvendësueshëm në përshkrimin e identitetit të kombit shqiptar dhe atë shqiptarë në viset shqiptare që do të ndaheshin. Në një letër dërguar Presidentit Uilson, anëtarët e krishterë të Vatrës shkruanin:

Gjendja e banorëve të krishterë nuk ndryshon aspak nga gjendja në të cilën gjenden pjesa tjetër e bashkatdhetarëve tanë. Të krishterë dhe myslimanë, bijë të të njëjtit atdhe, që flasin të njëjtën gjuhë, që kanë të njëjtat ndjenja dhe interesa dhe që kanë punuar gjithmonë së bashku për të njëjtën kauzë: integritetin territorial dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Pjesëtarët e Vatrës meritojnë njohje që i bëri të mundur delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris për të dhënë dëshmi për herë të parë para Komisionit të Marrëdhënieve të Jashtme në Senatin e SHBA-ve. Deklarata para Senatis u mbajt nga njëri prej

anëtarëve më aktivë të Federatës Pan-Shqiptare Vatra, Konstandin Çekrezi, i cili foli shkurtimisht për historinë e Shqipërisë dhe pastaj kërkoi nga senatorët që të përqendronin vëmendjen e tyre në veçanti tek Shqipëria e jugut. Ai akuzoi Unionin Pan-Epirot për falsifikimin e nënshkrimeve në memorandumin e kësaj organizate dërguar Konferencës, si dhe pjesëmarrësve në Konferencë duke përdorur kauzën shqiptare si objekt kompensimi për kauzën e vet. Për më tepër, Kristo Dako akuzoi Greqinë për masakrat mbi shqiptarët dhe kërkoi që të dërgohej një komision hetimor në Shqipëri, me qëllim të vendosjes për fatin e Shqipërisë.

Meritat e Vatrës qëndrojnë edhe në faktin se ajo ishte meritore për vendimin e SHBA-ve për të hedhur poshtë Traktatin e Londrës dhe për të bindur Presidentin amerikan Uilson mbi të drejtën e kauzës së tyre. Idetë e Vatrës mbi të drejtat e shqiptarëve dhe të Shqipërisë u shprehën qartë nga kryetari i saj, Fan Noli, i cili kërkoi formimin e një komisioni amerikan, si i vetmi që do të mund të ndihmonte shqiptarët në krijimin dhe funksionalizimin e shtetit shqiptar. Noli ishte i bindur se shumë shqiptarë, që ishin shtrënguar të migronin në Amerikë, kishin dëshirë të ktheheshin në atdhe dhe, "me prezantimin e koncepteve amerikane të lirisë, ekonomisë dhe prosperimit politik", të cytnin Shqipërinë drejt rrugës së rilindjes ekonomike dhe kulturore. Institucionet arsimore amerikane, sipas Nolit, do të thoshin "shpëtim për Shqipërinë, duke pasur parasysh se kultura anglo-saksone ishte ajo që i përshtatej më së miri shpirtit puritan të racës shqiptare". Pra, këto ishin objektivat e Vatrës me synim të zhvillimit të ardhëm politik dhe ekonomik të Shqipërisë. Shqiptarët e Amerikës, nën udhëheqjen e Vatrës, ushtruan me sukses një ndikim të madh mbi përfaqësuesit amerikanë në Konferencë. Roli i përfaqësuesit amerikan, Erickson, ishte i jashtëzakonshëm me kërkesën e tij për një mandat amerikan.

Vatra luajti një rol të rëndësishëm gjatë tërë kësaj periudhe historike. Ajo jo vetëm që shërbeu zi zëdhënëse e shtetit të ri dhe të ndjeshëm shqiptar, përmes organit të saj Dielli, por shërbeu edhe si

një qeveri gjatë kohës së pas luftërave ballkanike dhe, po ashtu, ndihmoi financiarisht delegacionet shqiptare në misione të ndryshme diplomatike në qendrat kryesore europiane. Fondet e *Vatrës* mbulonin jo vetëm shpenzimet e delegacioneve shqiptare nga Shtetet e Bashkuara, por edhe të kolonive të tjera shqiptare në tërë Europën. "Kur komuniteti shqiptar në Rumani dërgoi një delegacion në Paris, ata ngelën aty me pahir pasi që kishin para vetëm për udhëtim, dhe derisa ata qëndruan aty, *Vatra* u përkujdes për shpenzimet e tyre", rikujton Noli.

Në ndërkohë, përpos veprimtarisë së tij gazetareske dhe patriotike, Fan Noli u dërgua në Londër nga Kisha Ortodokse Shqiptare në Amerikë për të ndihmuar delegacionin zyrtar shqiptar të udhëhequr nga Mehmet Konica, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve dhe përfshirjen e tokave shqiptare brenda Shqipërisë. Federata Pan-Shqiptare *Vatra*, në emër të saj, dërgoi Faik Konicën në Londër me detyra të njëjta. Më 1913, Noli mori pjesë në një kongres shqiptar të mbajtur në Trieste (atëbotë pjesë e Austro-Hungarisë), ku u debatua mbi çështjen e lirisë së Shqipërisë, zgjedhjen e një monarku për Shqipërinë dhe krijimin e kufijve të një Shqipërie etnike me mbështetjen e Austro-Hungarisë dhe të Italisë.

Si delegat i *Vatrës*, Noli mori pjesë në Kongresin e Popujve të Shtypur në Uashington, në vitin 1918, dy vjet para emërimit të tij në Gjenevë, një periudhë që shënoi veprimtarinë e tij më të bujshme në diplomaci: kontributin e tij më të madh për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Në vitin 1920, Noli, tani i kthyer në Shqipëri, u dërgua nga Qeveria shqiptare në Gjenevë, si udhëheqës i një delegacioni që kërkonte pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Misioni i tij u kurorëzua me sukses, pasi që Shqipëria u pranua njëzëri në Lidhjen e Kombeve. Hyrja e Shqipërisë në këtë organizatë ndërkombëtare, me një anë abrogonte Traktatin e Londrës për copëtimin e Shqipërisë nga vendet ekspansioniste fqinje, dhe, nga ana tjetër, rikonfirmonte pavarësinë e Shqipërisë.

Gjatë viteve të bujshme dhe të rëndësishme të historisë së re të Shqipërisë, në vitin 1921, Qeveria shqiptare kërkoi nga Federata Pan-Shqiptare Vatra që të dërgonte një të deleguar në Parlamentin shqiptar, në shenjë të mirënjohjes së veprimtarisë të singertë dhe patriotike të shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara. Vatra dërgoi Nolin, tashmë të njohur dhe me përvojë në disa momente kyçe të interesave të Shqipërisë.

Veprimtaria e shoqatës së shqiptarëve në Amerikë vazhdoi edhe më tej. Më 4 korrik 1918, *Vatra* dërgoi Fan Nolin si përfaqësues të vetin tek Presidenti i SHBA-ve, Vudrou Uilson, për të kërkuar nga ai mbrojtjen e Shqipërisë në Konferencën e Parisit dhe për t'i bërë atij të mundur të përfaqësonte Shqipërinë në Kuvendin e Kombeve të Shtypura, që mbahej në Mount Vernon të Virxhinisë, me ç'rast Presidenti Uilson shpalli programin e tij të famshëm të quajtur Katërmbëdhjetë Pikat. Presidenti Uilson i tha Nolit se ai kishte një zë në Konferencën e Paqes dhe i premtoi atij se ai do të përdorte atë zë në dobi të Shqipërisë, ashtu siç edhe bëri në të vërtetë. Vatra dërgoi përfaqësuesin e vet edhe në Kongresin e Lushnjës, kurse një anëtar i Vatrës, Mehmet Konica, u bë pjesë e regjencës së porsformuar. Vetë Fan Noli kishte udhëtuar në Shqipëri me një pasaportë të lëshuar nga Vatra dhe të nënshkruar nga Kostë Çekrezi, njëri nga veprimtarët e shquar në Vatrës, i dërguar i saj në Uashington dhe i njohur gjithashtu si përfaqësues zyrtar i pranuar në një kohë kur Shqipëria nuk kishte qeveri. *Vatra* sponsorizoi Fan Nolin në udhëtimin e tij në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë (1921) ku dëshmoi cilësitë e tij si diplomat shqiptar. Aty kishte mbetur pa para, pasi që Qeveria shqiptare nuk kishte paguar për shpenzimet e tij të udhëtimit, ndonëse ai ishte njeriu që i kontribuoi hyrjes së Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Sërish, ishte Vatra ajo që ndihmoi kthimin e Nolit në Shtetet e Bashkuara.

Kjo është një përmbledhje e kontributit të Vatrës në fushën e diplomacisë shqiptare.

Më pastaj, Vatra u angazhua në një punë intensive të botimit të veprave shqipe. Vatra financoi botimin e veprave të Nolit, përkthimeve të tij dhe një sërë librash të tjerë që shkruan autorët shqiptarë në Shtetet e Bashkuara. Nuk duhet harruar edhe kontributin e Vatrës në lëmin e arsimit. Shumë studentë shqiptarë që studionin në universitetet amerikane merrnin bursa nga Vatra, në mesin e të cilëve ishte edhe vetë Fan Noli. Vatra pagoi për studimet e Nolit në Universitetin e Harvardit. Harvardi, ashtu si dhe sot, ishte një nga institucionet më prestigjioze të arsimit të lartë në Shtetet e Bashkuara. Në të studiuan personalitete të shquara të jetës intelektuale dhe politike të Shteteve të Bashkuara, Noli diplomoi në klasën e vitit 1912 dhe kishte si shok klase babain e Presidentit të ardhshëm të Shteteve të Bashkuara, Xhon Kenedit. Pagesa për studim për një vit kushtonte 150 dollarë, një shumë e konsiderueshme për atë kohë. "Unë nuk pagova asnjë cent derisa diplomova, pasi që merrja bursë nga Vatra; dhe me ndihmën e Perëndisë, notat i kisha që të gjitha A dhe rrallëherë bija në B. Isha djalë i mirë...", - thoshte Noli.

Në një fjalë që mbajti në një ceremoni në Boston, më 2 shtator 1962, me rastin e "Kremtimit të Jubileut të Artë të Vatrës dhe 50-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë (1912–1962)," Fan Noli vinte në pah:

50-vjetori i Vatrës është një ngjarje epokale në analet e lëvizjes kombëtare shqiptare... Pa dyshim, Shqipëria i ka borbë sakrificës së një pjese të madhe prej jush që jeni këtu të pranishëm.

Kur u themelua Vatra më 1912, Shqipëria ishte ende pjesë e Perandorisë Turke, të cilën shumë nga ne e mendonim si të sëmurë, por që nuk largohej aq lehtë. Megjithatë, rënia e saj ndodhi vetëm shtatë muaj pas themelimit të Vatrës. Kur aleatët ballkanikë mundën Turqinë, Ismail Qemali Vlora, një diplomat i ditur dhe i rryer, vuri nënshkrimin mbi mur dhe e dinte se shqiptarët kishin para vetes dy mundësi: të ndaheshin nga turqit apo të zhdukeshin bashkë me ta. Kështu, të ndjekur nga një grup i vogël patriotësh,

më 28 nëntor 1912, ai vendosi të ndahej tërësisht nga Perandoria dhe të mos mbetej prapa bishtit të saj – një veprim i guximshëm që shpëtoi Shqipërinë, që po kanosej nga copëtimin mes aleatëve ballkanikë. Fatkeqësisht, dy vjet më vonë, Shqipëria u shndërrua sërish në fushëbetejë të të gjithë armiqve të saj, në mungesë të një fryme që do të bënte të mundur formimin e një qeverie të rregullt. Larg kësaj, shpallja e pavarësisë së Shqipërisë i dha Vatrës një inspirim, ndonëse a ardhnja e vendit dukej e zymtë dhe ndonëse e rrethuar nga armiq, Shqipëria u bë subjekt politik. Në mbarim të luftës, Austria, e cila më parë kishte ndihmuar themelimin e shtetit shqiptar, pothuajse ishte shkatërruar dhe Shqipëria nuk kishte më mbrojtës të fuqishëm. Si rezultat i pozicionit që mori Presidenti Uilson në Konferencën e Paqes në Versajë – në masë të madhe si rezultat i kërkesave të delegatëve të Vatrës, përfshirë Dr. C. Telford Erickson – in dhe veten time – Shqipëria shpëtoi edhe një herë.

Fan Noli rikujton:

Të kujtojmë me hirësi dhe respekt disa nga shembujt e Rilindjes shqiptare në këtë vend: Sotir Peci, i cili boti gazetën e parë në shqip Kombi, këtu në Boston; Petro Nini Luarasi, që ndihmoi forcimin e ndjenjës kombëtare në mesin e të mërguarve shqiptarë në Amerikë; dhe Faik Konicën, një studiues i thellë i përvojës botërore, një shkrimtar dinamik dhe intelektual i dimensioneve më të larta, një mësues i të gjithë neve... Për gjysmë shekulli të jetës së saj, Vatra ka bërë mrekulli në fushën e arsimit dhe të politikës. Marr guximin të them se pa përkrahjen e saj, ndoshta, nuk do të kishte Shqipëri sot. Personalisht, i jam shumë mirënjohës federatës që mundësoi botimin e shumë librave të mi...

...

As që do të mund të merrej me mend veprimtaria dhe kontributi i Vatrës në këtë drejtim pa kontributin e vetë Fan S. Nolit. "Forca prapa Vatrës dhe prapa të gjitha aktiviteteve të saj ishte Fan Noli.

Në esenë "Peshkop Noli, siç më kujtohet", një bashkëkohës i tij, Peter Prifti, thekson:

Ne ishim me fat që në atë kohë Fan Noli i madh ishte ende gjallë dhe unë kisha mundësinë ta takoja, të bisedoja me të, ta dëgjoja kur mbante meshën në Katedralen e Shën Gjergjit dhe kur mbante fjalime në darkat dhe festat e shqiptarëve. Duke punuar në Vatër, kisha mundësinë të njihesha më mirë me botën shqiptare në Shtetet e Bashkuara, me mospajtimet politike dhe fetare që pengonin bashkatdhetarët dhe që më lëndonin edhe mua; por u njoha gjithashtu edhe me vlerat tona të çmueshme kombëtare dhe kulturore, që janë ruajtur me krenari nga bashkatdhetarët tanë dhe që i dallojnë ata si shqiptarë.

Jam impresionuar nga ndjenjat e zjarra patriotike të shumë burrave dhe grave të cilët, nën udhëheqjen e Nolit, Konicës dhe patriotëve të tjerë të shquar, vunë themelet e shqiptarisë në Shtetet e Bashkuara...

Ndërkaq, Fan Noli ngre këtë lëvdatë të Vatrës edhe më lart. Me rastin e 5-vjetorit të Vatrës dhe pavarësisë shqiptare, Noli është i drejtpërdrejtë: "Pa përkrahjen e Vatrës nuk do të kishte sot Shqipëri!".

Si përfundim, të mos harrojmë kontributin e Vatrës edhe për çështjen e Kosovës, mbështetjen e tyre të plotë për pavarësinë e Kosovës dhe ndihmën për të pakësuar vuajtjet e kosovarëve. Mbështetja për një Kosovë të pavarur dhe për shqiptarët në përgjithësi vazhdon edhe sot dhe pa dyshim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

PROF. DR. ALIJASHARI, KORÇË

PËR FAN NOLIN DHE PASURINË IDIOMATIKE TË VEPRËS SË TIJ

Dëshiroj që t'i përgëzoj që në fillim organizatorët e këtij tubimi shkencor kaq domethënës, me rastin e 50—vjetorit të vdekjes së Fan Nolit, emrin e ndritur të të cilit e mban me krenari Universiteti i Korçës dhe t'i falënderoj për ftesën miqësore që na bënë për të marrë pjesë. Unë dhe kolegu im i gjuhës shqipe, Olger Brame, e pritëm me kënaqësi këtë ftesë, duke shpresuar se ky është një rast për t'u lidhur me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, veprimtarinë e të cilit e njoh mirë dhe e vlerësoj si një shembull të rrallë në punën e të cilit ndërlihet fort bukur atdhetaria dhe shkenca për trashëgiminë.

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë i Universitetit të Korçës është shumë i interesuar që të bashkëpunojë me ju në të gjitha fushat e përbashkëta dhe le të jetë ky tubim si shenja e parë e kësaj lidhjeje mes vëllezërish dhe jo thjesht shkencore e kulturore. Ju them me gjithë shpirt se ne e ndiejmë veten shumë mirë këtu, çka e tregoi dhe rasti kur këtë vit, me rastin e 7 marsit, Rektori i Universitetit të Korçës, prof. Gjergji Mero dhe unë ishim mysafirë të kryetarit të Komunës dhe të miqve të tjerë. Po gjej rastin që në emër të rektorit dhe timin t'ju ftoj që 7 marsin e vitit tjetër të jeni miqtë tanë në Korçë.

Edhe unë, si gjithë kolegët e tjerë, në këtë tryezë shkencore për Fan Nolin nuk kam ardhur “duarbosh”, ndaj kam për zgjedhur që të them diçka për një anë të vyer të veprës së Nolit, siç është visari i tij frazeologjik, duke u nisur nga fakti që, megjithëse Noli nuk pati lidhje të gjata me gjuhën e folur, për shkak të mjedisit gjuhësor shqipfolës ku jetoi, ai e ka përdorur me mjeshtëri këtë pasuri të shqipes në veprën e tij.

Siç dihet, njerëzit e penës, duke jetuar në gji të popullit, përveç që marrin prej andej temat dhe problemet për shkrimet e tyre, artistin dhe elementët më të mirë të ligjërimit popullor, duke i përdorur në mënyrë të qëlluar. Kështu thithin edhe lëndën gjuhësore dhe shprehjet e tjera që ka krijuar populli në rrjedhë të shekujve dhe i shtien në ligjërimin e shkruar, sipas përmbajtjes kuptimore dhe vlerave të tyre shprehëse e stilistike. Veç kësaj, shkrimtarët dhe publicistët i përkryejnë më tej në formë e në përmbajtje disa nga këto mjete gjuhësore.

Penat më të fuqishme që shkruajnë në këto fusha të letrave bëjnë edhe punë krijuese gjuhësore në dy drejtime: krijojnë fjalë e ndërtime të reja dhe përpunojnë stilistikisht mjetet ekzistuese. Ndër to, edhe njësitë frazeologjike, që përdoren gjerësisht, përpunohen nga ana e ndërtimit dhe kuptimit, përsosen më tej në përshtatje me llojin e shkrimit dhe të problemit që trajtohet etj.

Duke lexuar në tërësi veprën e Fan Nolit, krijon një bindje të plotë se ai jo vetëm është një gjuhëtar i përkorë për shkak të problemeve që trajtoi në shkrimet e tij, por është dhe një njeshtër i madh i përdorimit të fjalës dhe lëndës idiomatike, të cilën ai e merr nga dy burime: nga ligjërimi popullor (këtu kemi parasysh njësitë frazeologjike dhe shprehje të tjera nga gjuha e popullit) dhe nga ligjërimi i shkruar (këtu përfshihen kalket dhe huazimet frazeologjike nga gjuhë të tjera).

Disa nga veçoritë kryesore dhe më të përgjithshme lidhur me përdorimin e lëndës idiomatike në veprën e Nolit janë këto:

1. Pasuria e lëndës idiomatike dhe denduria e përdorimit të saj

Është vënë në dukje se denduria e përdorimit të njërive frazeologjike në stile e ligjërime të ndryshme nuk është e njëjtë. Për shembull, në stilin publicistik, sidomos në lloje të tilla, si pamfletet politike, portretet, skicat, përshkrimet etj., denduria është më e madhe. Pra, mbushullia frazeologjike nuk është e njëjtë në zhanre të ndryshme.

Kjo vërehet edhe në veprën e Nolit. Ajo varet nga formimi gjuhësor i autorëve, nga temat që trajtojnë, nga llojet e shkrimeve etj. Por, kryesorja është se përmes përdorimit të frazeologjisë realizohet një kërkesë e domosdoshme ndaj veprave të shkruara: thjeshtësia dhe kuptueshmëria. Kjo përbën njëherazi dhe një detyrë të përhershme për publicistët dhe shkrimtarët, sepse burim ushqimi për ta është gjuha e folur e popullit, leksiku dhe frazeologjia e pasur popullore.

Po përmendim vetëm disa shembuj të shkëputur nga vepra e Nolit: *theu kokën* dikush “e pëson keq, nuk ia arriti qëllimit që kishte”; *s’ia var tobën* dikujt “nuk e përfill aspak, nuk e vlerëson a nuk i jep rëndësi”; *i arriti (i vajti) thika në kockë* dikujt “po vuan shumë, është në gjendje të keqe”; *me mish e me shpirt* “pa kursyer asgjë, me dëshirë të madhe”; *si një e një bëjnë dy* “pa tjetër, me çdo kusht”; *fërkon duart* “gëzohet për diçka të keqe që i ka ndodhur dikujt”; *me gojë hapur* “i habitur”; *në buzë të varrit* “në prag të vdekjes”; *gjeti tenxherja kapakun* “janë njësoj, nuk ndryshojnë nga njëri-tjetri”; *në vend t’i bjerë gomarit i bie samarit* “në vend që të dënojë fajtorin i kanoset dikujt tjetër, e shfryn dufin aty ku nuk duhet”, *iu mbyll shtëpia* dikujt “mbeti shkretë, nuk ka më njeri”, *ia bëri varrin* dikujt “e shkatërroi, e vdiq”; *si kofini pas të vjeli* “tepër vonë, kur nuk duhet më”; *viç i palëpirë* “njeri fare i papjekur, kalama”, *s’lë kusur* “bën çdo përpjekje”, *nuk e bëj kabull* dikë a diçka “nuk e pranoj, nuk e pëlqej” e shumë të tjera.

Tipari më i rëndësishëm i përdorimit të lëndës idiomatike popullore në veprën e Nolit është rikuptimësimi dhe ringjyrimi i saj, duke u vendosur në kontekste të gjera shoqërore e politike. Duke u përdorur në kontekste të tilla, njësitë frazeologjike dhe shprehjet e tjera pësojnë disa ndryshime të rëndësishme:

Së pari, zhvishen nga ngjyrimi i rëndë emocionues (nëse e kanë) dhe fitojnë vlera të reja stilistike–emocionuese, ose, anasjelltas, mund të rimarrin ngjyrim emocionues (kur këtë e kanë në përdorimin e zakonshëm), si: vetë mbreti gjenial *ia vë kapakun tenxheres*:

e emëron Koço Kotën kryetar të parlamentit; isha *viç i palëpirë*/ aguridhe, thartësirë; “Mir’ e gjeti”, tha sarafi/ “*se ashtu ia desh qy-lafi...*” etj., të cilat janë domethënëse.

Së dyti, mund të marrin kuptim të ri ose nuanca të reja kuptimore, të ndryshme nga ato që kanë në situata të zakonshme, si për shembull : Dhe Feridi *faqe ndërro*n/ Dje shante sot lëvdon/ Fryn bullçit e trumbeton/ Që katrani zbardhëllon”, ku njësia *ndërro*n *faqen* “ndryshon, ripërtërohet” merr kuptimin “e kthen, lëkundet, nuk mban një qëndrim”. Ndërsa në dy kontekstet e mëposhtme njësia frazeologjike *si kofini pas të vjelash* “shumë vonë, atëherë kur nuk duhet”, rikuptimësohet në togun *mbetnë si kofini pas të vjeli* “nuk kemi asnjë vlerë”: Një mexhllis të madh na çeli/ Pandeli Jano Vangjeli/ Me Sulltan-llokum na veli/ *Si kofini pas të vjeli*; E shkurtër është Jeta, ja, u mplakmë/ Dhe *mbetnë si kofini pas të vjeli* etj. (Noli, 1)¹.

Së treti, përdorimi i dy a më shumë idiomave brenda një konteksti për të rritur forcën e ligjëritimit, duke i aktualizuar edhe më shumë ato, si: njerimi ka këtë të mirë që *zë për fyti* miletin dhe *ia sjell mendtë në kokë* me pahir, në qoftë se *s’ia nxjerr shpirtin* (ku bashkërenditen tri njësi: *e zë për fyti* dikë “e shtrëngoi me forcë të bëjë diçka; e vuri në gjendje shumë të vështirë” – *ia sjell mendtë në kokë* dikujt “e bëj që të mendojë si duhet, nuk e lë të bëjë si të dojë”, *ia nxjerr shpirtin* dikujt “e mundon shumë, e bëj që të vuajë pa masë”); *kokën* pra Ahmetit *do t’ia hajë* Musolini shpejt a vonë *si një e një bëjnë dy*. Po Musolinin kush *do t’ia hajë kokën*? (ku autori përdor njëra pas tjetrës njësitë: *ia hëngri kokën* I dikujt “e shpuri në varr, e vdiq”², e cila del dy herë brenda këtij konteksti të shkurtër, dhe *si një e një bëjnë dy* “patjetër, medoemos, pa asnjë dyshim”); Shefqet beu *fërkon duart*, mileti e pret *me gojë hapur* (*fërkon duart*

¹ Të gjitha citimet janë marrë nga Veprat e Nolit vëll. 1, 2, 3, 5, Tiranë 1987.

² Kjo njësi frazeologjike është homonimike me *ia hëngri kokën* II dikujt “ia mbushi mendjen, e bindi”.

dikush “kënaqet, i bëhet qejfi për dikë që është keq” dhe e pret *me gojë hapur* “i habitur”); jam budrumi e jam zullumi, kush *ngre kokën e merr lumi* (*ngre kokën* dikush “kundërshton” dhe *e mori lumi* dikë “e pësoi keq”) etj.

Së katërti, jo pa qëllim, shpesh Fan Noli përdor brenda një konteksti edhe njësinë frazeologjike edhe fjalën sinonime. Siç dihet, vërtet njësia frazeologjike është kuptimisht sinonime me një fjalë, por gjithnjë njësitë frazeologjike japin diçka më shumë se fjala, për shembull, një nuancë të re kuptimore, një ngjyrim të mbishtësuar stilistik etj. dhe, kjo i bën ato që ligjërimi të dalë më i fuqishëm nga ana kuptimore dhe stilistike. Për shembull: *Cilët jan’ ata tiranë/ që të pren’ e që të vranë/ që të therë bij e bija/ dhe t’u nxi, t’u mbyll shtëpia* (ku shkojnë pranë e pranë njësia *iu mbyll shtëpia* dhe *iu nxi*);

Së pesti, në penën e Nolit mjaft njësi frazeologjike ndërtohen edhe me gjymtyrë të tjera, të ndryshme nga ato që përdoren zakonisht, si: *E arriva dhe ia thashë/ asnjë gur pa tundur s’lashë/ dhe mëgjun – jazi i rashë/ ç’u mundova kot*, ku njësia *s’lë gur pa lëvizur* dikush “bën gjithçka për të arritur një qëllim” del me gjymtyrën *pa tundur*, ndërsa *i bie në gjunjë* dikujt “i përulet, i lutet shumë” del në formën *mëgjunjazi*; *i biri i botës për burri i botës* “dikushi, një njeri kushdo qoftë”

2. *Publicistika e Fan Nolit karakterizohet nga përdorimi i mjaft kalkeve³ dhe shprehjeve të papërkthyer (huazime frazeologjike⁴), të marra nga gjuhë të ndryshme⁵.*

³ Term që shënon fjalë a shprehje të përkthyer sipas ndërtimit në gjuhën dhënëse. Kalket frazeologjike mund të përkufizohen si ndërtime dy-trigjymtyrëshe, me kuptim të figurshëm e të përgjithësuar, të ngurosur gjatë praktikës së përdorimit në ligjërim etj., si: *gomë shpëtimi*; *patate përvëluese*; *grusht i hekurt*; *gur prove*; *gjueti shtrigash*; *mollë e ndaluar*; *heshje që flet*; *hedh hije*; *ironia e fatit*; *bën ligjin*; *hyri në histori*; *jakat e bardha*; *lot krokodili*; *i vesh këmishën e forcës*; *kënga e mjellmës*; *luftë e ftohtë*; *maja e ajsbergut*; *i bën apologjinë* etj.

Siç dihet, kalket dhe shprehjet e papërkthyer hasen sidomos në shkrimet publicistike dhe ato tekniko-shkencore, por në veprën e Nolit këto i gjen gjithandej të përdorura me mjeshtëri, sepse Noli ishte njohës i shumë gjuhëve, edhe këtu po sjellim vetëm disa shembuj: **PERI I ARIANËS** (ang. *the thread of Ariadne*; rus. *Ариаднина нить*; frëngj. *le fil d'Ariane*; ital. *il filo do Arianna*); “mënyrë a mjet për të gjetur rrugëdalje nga një gjendje e vështirë; ndihmë që i jepet dikujt a çelës për të zgjidhur diçka të ndërlikuar; *filli i Arianës; lëmshti i Arianës*”. Shprehja vjen nga mitologjia greke. Ariana, e bija e mbretit të Kretës, u dashurua pas Tezeut, i cili erdhi në Kretë. Ariana i dha Tezeut një lëmsht, me ndihmën e të cilit ai mundi të dalë nga labirinthi, pasi kishte vlarë Minotaurin, duke çliruar kështu Athinën nga detyrimi i tmerrshëm që i kishte vënë Minosi për të dërguar shtatë djem e shtatë vajza që t'i hante Minotauri. Atje ku s'ishte e mundur ta shqitja legjendën nga historia, e lashë ashtu siç e gjeta te historianët e vjetër, me shpresën ta shko-klavit kur të kem përpara dokumentet, të cilat do të më japin *perin e Arianës*. (*Noli*, 4); Zbulimet e tij të çmuara nuk janë veçse një nisje germimesh brenda në një labirint. *Peri i Arianës*, ndoshta nuk do të gjendet kurrë. (*Noli*, 5); **HESHTJE (PREJ) VARRI** (rus.

⁴ Term që shënon shprehje të përdorura në gjuhën shqipe pa përkthim. Pra, huazimet e plota nuk i janë nënshtruar asimilimit të shqipes, ato shkruhen në gjuhën e huaj dhe shqiptohen po ashtu, për shembull: a) nga latinishtja (të cilat përbëjnë dhe pjesën më të madhe të huazimeve në shqipe), si: *ad hoc; advocatus diaboli; alter ego; alma mater; aperto libro; ars longa, vita brevis; casus belli; fuit Troja; homo homini lupus est; honoris causa; o tempora, o mores; tabula rasa; urbi et orbi* etj.; b) nga frëngjishtja, si: *a la carte; après nous le deluge; carte blanche; caveant consules; Paris vaut bien le messe; tel pere, tel fils* etj.; c) nga anglishtja, si: *big brother; ever say never; fair play; fifty-fifty; five o'clock; happy end; kill with kindness; wait and see* etj.; ç) nga gjermanishtja, si: *aussprechen was ist; befehl ist befehl; Blitz Krieg; Blut und Eisen (Eisen und Blut); Grosen un Ganzen; Mehr Licht; Naht und Nebel; Shturm und Drang* etj.; d) nga italishtja, si: *colpo di stato; cuopri fuoco; dolce far niente; dulce in fundo; eppur si move; guarda i passa; pezzo grosso; salto mortale* etj.

⁵ Nuk kemi parasysh këtu dhe shumë toge të tjera të qëndrueshme që janë në natyrën e stileve të gjuhës së shkruar, si *merr formë; merr fuqinë; merr forcë; vë në dukje; i bëj të ditur; vë në diskutim*; etj.

могильная тишина; frëngj. *silence de cimetiére*; angl. *silence of the grave*; ital. *silenzio di tomba*) “një çast i vështirë për njerëzit që kanë një shqetësim të madh e nuk thonë dot asgjë; diçka shumë e qetë që të fut ankthin”. Heshtja mbretëron kur flet ai. Gjithësia kthen shikimin. Heshtje varri. (*Noli, 1*); **LOTË (PREJ) KROKO-DILI (TË KROKODILTA)** (angl. *crocodil tears*; frëngj. *larmes de crocodile*; gjerm. *Krokodilsträne*; ital. *lacrime di coccodrillo*; rus. *крокодиловы слёзы* “pikëllim i pasinqertë; vuajtje e shtirur; qarje hipokrite; ankesa të paqena”. Sipas besimit, krokodili, duke ngrenë viktimën e tij, qan. Shkencëtarët suedezi, Ragnar Fange dhe Knut Schmidt-Nilson, vërtetuan se vërtet krokodilët derdhin lotë, por thjesht për shkaqe biologjike. Mundohet sa s’ka me fjalë paqësore, pastaj, duke *hedhur lotë të krokodilta*, shtrëngohet të hyjë në grindje. (*Noli, 2*); **GRUSHTI I FUNDIT** (frëngj. *le dernier de fer*). “goditje e rëndë dhe përfundimtare; veprimi i fundit me forcë a goditje që i jep fund diçkaje”. Por, siç e di tërë bota, ai i dha myslimanizmit *grushtin e fundit*. (*Noli, 2*). **UNË DI SE NUK DI ASGJË (UNË NJË GJË DI, QË S’DI ASGJË).** (lat. *se unum hoc shire, nihil se shire*; greq. *óida medén eidénai*; frëngj. *je sais que ne sais rien*). Fjalë të filozofit grek, Sokratit, i cili thoshte se natyra e sendeve, ndërtimi i botës etj., nuk mund të njihen dhe se njeriu nuk mund dhe nuk duhet të njohë vetveten. Kjo shprehje përdoret në vetën e parë nga dikush për të treguar mençurinë dhe thjeshtësinë e tij, përkundër njerëzve që sheshin mend edhe kur nuk dinë asgjë; asgjë nuk është e sigurt para se ta ketë provuar vetë. “Kur isha i ri kujtova se e gjeta/ Pallatin ku shkëlqente e vërteta / Tani q’u mplaka *di që s’dija gjë* / E që s’di hiç nga Bota dhe nga jeta. (*Noli, 1*); **TË RROSH A TË MOS RROSH, KJO ËSHTË ÇËSHTJA** (angl. *to be or not to be, that is question*; frëngj. *être ou ne pas être, c’est ça la question*). Shprehja vjen nga monologu i Hamletit në tragjedinë me të njëjtin titull të Shekspirit (akti III, skena I) dhe përdoret për të karakterizuar ndonjë gjendje a situatë shumë të vështirë dhe pa rrugëdalje. Prandaj ky na merr përkthimin e famshëm nolian të monologut të Hamletit “*të rrosh a*

të mos rrosh, kjo është çështja” dhe jep përkthimin pipian “me qenë a mos me qenë, kjo asht pikëpyetja”. (Xh. *Lloshi, Mbrojtje për Gjyhen Shqipe*); **GOMARI FËRKON GOMARIN** (lat. *asinus asinum* fricat; frëngj. *l'âne frotte l'âne*). “një i paditur lëvdon të paditurin; përdoret për dy njerëz që janë njëlloj të mangët dhe lavdërojnë njëri-tjetrin”. Ja dhe e treta e vërteta, prapë latinisht: “*Asinus asinum fricat*”. Që ta përkthejmë arnautçe: “*Gomari fërkon gomarin*”. (Noli, 3); **(shitet) PËR TRIDHJETË ASPRA** (ital. *ven- dersi per trenta denari d'argento*; angl. *thirty pieces of silver*; frëngj. *les trente deniers (de Judas)*; rus. *тридцат серебряников*). “tradh- ton e hidhet në anën e kundërshtarit për një shpërblim të vogël; tradhton diçka të shtrenjtë a të shenjtë për hiçgjë; shitet shumë lirë”. Shprehja lidhet me tekstin e Biblës, Dhjata e Re (Mateu, 26:14). Një nga dymbëdhjetë nxënësit e Jezusit, ai që quhej Judë Iskarioti, shkoi te kryepiftërinjtë dhe u tha: “Sa do të më jepni që unë t’jua jap Jezusin ndër duar?” Edhe ata i numëruan tridhjetë sikla argjendi. Qysh atëherë kërkonte kohë të përshtatshme për ta dhënë Jezusin në duart e tyre. Juda, kur mori vesh se Jezusi u dënua me vdekje, u pendua thellë për tradhtinë e tij. Tridhjetë asprat ua hodhi piftërinjve para këmbëve dhe pastaj vari veten. Aspra ishte mo- nedha turke më e vogël e argjendit, e barabartë me 1/6 e groshit. Përkthe, përkthe, terxhuman. Thuaji se shqiptarët *nuk shiten për tridhjetë aspra*. (Noli, V,2).

Po kështu Fan Noli përdor dhe mjaft huazime frazeologjike, sido- mos nga latinishtja, italishtja dhe frëngjishtja, si: **COUP DE GRAS** frëngj. “fj.p.fj. goditje nga mëshira; goditje vdekjeprurëse; goditje që sjell fundin e mundimeve; plumbi që i jepet kokës një të dënuari me vdekje për ta vrarë përfundimisht”. Po, siç e di tërë bota, ai i dha myslimanllëkut *coup de grace* dhe e gremisi (Noli, 2); **HANI- BAL ANTE PORTAS** lat. “fj.p.fj. Hanibali para dyerve; rreziku është shumë pranë, është te dera; përdoret për të treguar një rrezik të dukshëm e kërcënues”. Kështu thërrisnin me dëshpërim romakët e vjetër kur Hanibali, mbreti i Kartagenës, pas betejës së Kanës,

arriti deri te portat e mireve që rrethonin Romën. Këtë shprehje e përdori për herë të parë oratori romak, Ciceroni. Jo një armik, po shumë presin nën muret e dheut tonë dhe asnjë nuk thirri fjalën historike “Hanibal ante portas!” (Noli, 5); **ULTIMA RATIO** lat. “shkaku i fundit; argumenti përfundimtar; një mjet a diçka tjetër që përdoret për t’i dhënë fund një mbrojtjeje, një veprimtarie etj.; përdoret në kuptimin që forca tek mbretërit plotëson argumentet që ndonjëherë nuk vlejnë”. Kjo gjyle më oshëtin në veshë akoma: s’qenkam shqiptar e s’paskam dinjitet. Kjo është, që ta themi latinisht, *ultima ratio* Albanorum malaricorum! (Noli, 3); **VIDEANT CONSULES** lat. “të vigjëlojnë (të kenë mendjen) konsujt; caveant consules”. Formulë e senatit romak. Forma e plotë është *videant consules ne quid res publica detrimenti capiat* – *le të vigjëlojnë konsujt që republika të mos pësojë ndonjë dëm*. E sigurt është vetëm kjo, që papa Nili, njeri fort i zgjuar dhe dinak, zuri në rrjetën e tij një peshk budalla shumë të madh dhe keni mendjen se mos peshkojë dhe ndonjë gjë tjetër. (*Videant consules*)! , – tha ai. (Noli, 2), si dhe shumë të tjera, si *ca izole*, frëngj. “rast i veçant”, *modus vivendi*, lat. “mënyrë jetese (e të jetuarit), rrugë a mjet për të kapërcyer një moment të vështirë”, *mutatis mutandis*, lat. “duke bërë ndryshimet përkatëse, ndryshimet e duhura”, *pium desiderium*, lat. “dëshirë e bukur, fisnike”, *sine qua non*, lat. “e domosdoshme”, *ante Cristum*, lat. “para lindjes së Krishtit” etj.

Kalket dhe huazimet frazeologjike në ligjërimin e Nolit përdoren për të dhënë në mënyrë sa më të përpiktë ide e nocione të ndryshme, të cilat me mjete të tjera gjuhësore dhe mund të mos arriheshin, por ato krijojnë edhe një atmosferë të caktuar, të domosdoshme për rrethanat ligjërimore. Edhe për këtë po përmendim shkurt disa shembuj: *duke hedhur lotë të krokodilita; të vajtojnë për liritë e popullit makar me lotë prej krokodili; peri i Arianës nofta nuk do të gjendet kurrë; kur të kem përpara dokumenta të cilat të më japin perin e Arianës; këta Sizifë modernë të ferrit shqiptar, ka apo s’ka një drejtë të thërrasë si Riçardi i Shekspirit “Mbretërinë time për një*

Xhavit" (ku aktualizohet shprehja e njohur "gjysmën e mbretërisë sine për një kalë". **MBRETËRINË TIME PËR NJË KALË!** (frëngj. *mon royaume me pour un cheval*). Nga tragjedia "Rikardi III" e Shekspirit, Akti V, skena IV: Mbreti Rikard : "*Këtu në fushë paska gjashtë Riçmondë/ Kam vrarë pesë sot në vend të tij/ Një kalë, një kalë! Një mbretëri për një kalë!*". Këto janë fjalët dëshpëruese të mbretit të Anglisë më 22 gusht 1485, kur u mund nga Riçmundi në betejën e Bosworthit, gjatë së cilës u katandis të luftonte më këmbë. Shprehja përdoret kur kërkohet një diçka shumë e vogël për një gjë të madhe; për të nënvizuar idenë se edhe gjërat në dukje të vogla, janë vendimtare në një çast të caktuar; përmes gjërave të vogla mund të zgjidhen edhe probleme të mëdha.

Dhe pastaj më thuaj: ka apo s'ka të drejtë të thërrasë si Rikardi i Shekspirit "*Mbretërinë time për një kalë!*" (*Noli, 2*);

Shumë prej këtyre shprehjeve Noli i përdor si tituj apo nëntituj të artikujve dhe shkrimeve të tjera, si: *Edhe ti Brut; Zia në Shqipëri, Horrible dictum* etj.

Duke u nisur nga gjithë lënda idiomatike që kemi vjelë në veprën e Nolit, mund të arrijmë në përfundimin se ai ishte njohës i mirë i frazeologjisë popullore dhe asaj të huazuar, si dhe mjeshtrë i madh i përdorimit të saj në ligjërimin e shkruar.

Për Nolin është shkruar shumë dhe do të shkruhet edhe në të ardhmen, sepse vepra e tij është një gurrë e pashterrshme, së cilës i drejtohen studiuesit, përkthyesit etj., sikurse janë edhe autorët e kumtesave të këtij tubimi shkencor.

Bibliografi e shfrytëzuar

- Ali Jashari, *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*, Tiranë 2007
- Fan Noli, *Vepra, 1,2,3,5*, Tiranë 1987
- Jani Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë 1999
- Xhevat Lloshi, *Mbështetje për Gjuhën Shqipe*, Tiranë, 1994

SHPËTIM ÇUÇKA, TIRANË

NOLI – SIMBOL I PËRKTHIMIT SHQIPTAR

Noli është ndër ato figura jo të shumta të historisë sonë, të cilat kanë spikatur me vlerat e veprimtarisë së tyre në të gjitha fushat, ku janë përfshirë. Ka qenë – po të përsërisim në njëfarë mënyre fjalët e Ofelisë, kur cilëson Hamletin – publicisti, politikani e burri i shtetit, poeti, kleriku dhe kritiku i letërsisë, historiani, muzikanti dhe përkthyesi.

Po i lëmë këtu mënjane meritat e tij të padiskutueshme në fushat e tjera dhe po ndalemi te veprimtaria e tij në fushën e përkthimit. E para gjë që tërheq vëmendjen janë disa pyetje, që lindin në mënyrë logjike: Pse u mor Noli me përkthime? Ç’vepra përktheu ai? Si e kreu procesin konkret të përkthimit?

Përgjigjet për këto pyetje do të shërbejnë në mënyrë po aq logjike për t’i dhënë përgjigje edhe pyetjes: Si shpjegohet që Noli zë në historinë e përkthimit shqiptar një vend aq qendror, sa është e drejtë të thuhet që ai është kthyer në mënyrë gjithnjë e më të qartë e më të sigurt në simbolin e përkthimit shqiptar?

Në kohën kur Noli u mor me përkthime, domethënë në kohën kur ai jetoi praktikisht periudhën më aktive të jetës së tij shoqërore, ecuria e kulturës shqiptare ishte në një nivel që, pavarësisht punës së paçmuar të rilindësve, nuk u përgjigjej më as në vëllim e as në cilësi detyrave që historia shtronte përpara saj. Në thelbin e tyre këto detyra ishin: pavarësimi i vendit dhe ndërtimi i shtetit. Në qoftë se do të hetohen objektivisht shkaqet e dobësive tona në të dyja këto drejtime themelore, do të dalë se rrënjët e gjithçkaje ishin te mungesa e një shtrese udhëheqëse me të vërtetë popullore.

Merita e Nolit – meritë e madhe kjo – është se ai e kuptoi si rrallë–kush tjetër pikërisht këtë gjë. Dhe pikërisht ky kuptim i drejtë i nevojave historike të popullit tonë, domethënë edhe i detyrave që historia shtronte përpara veprimtarëve të politikës dhe të kulturës sonë, përcaktoi zgjedhjet e tij në fushën e publicistikës, të politikës, të fesë, të letërsisë, të përkthimit.

Në rastin konkret të përkthimit, të gjitha veprat e përkthyer nga Noli sillnin mesazhet e nevojës së çlirimit të popullit nga robëria dhe padituria, nevojës së çlirimit të tij nga shtresa kundërpopullore e parisë, së çlirimit të tij nga marrëdhëniet shumëshekullore patriarkale, feudale e filistino–borgjeze, sillnin mesazhet e nevojës së vendosjes së marrëdhënieve shoqërore të mbështetura në pushtetin e popullit. Le të citojmë disa analiza të vetë Nolit për veprat e përkthyer prej tij:

“Për fat të keq aristokracia norvegjane ishte e shtypur dhe populli s’kishte udhëheqës. Pjesa më e madhe e parësisë ishin lidhur me danezët; pjesa tjetër ishin të përçarë a të vdekur...” (nga “Introdukta” për dramën “Zonja Ingra e Ostrotit”).

“Henrik Ibseni...ridikulizoi dhe diskreditoi idealet dhe institucionet e botës moderne plutokratike, pseudodemokratike dhe pseudokristianike...Qyteti, ku vepron doktor Stokmani, nuk është veç një pikturë e vogël e shoqërisë njerëzore kapitaliste borgjeze, e cila lulëzon me tregërinë e helmit dhe të kallpazanërisë...për shoqërinë borgjeze s’ka shpëtim... Kjo shoqëri duhet përnibysur me gjithësej... Kryemotivi i doktorit...është brezi i pastajmë, shoqëria e re e pritme... s’duhet harruar që njerëzit modernë e kanë humbur individualitetin aq sa janë bërë me të vërtetë kukulla... Teatri i përbotshëm, i vjetër a modern, s’ka një dramë tjetër, e cila të tallet aq bukur e aq thellë sa kjo me idealet borgjeze faqe me nder demokratike. Liria e fjalës? Po kjo nuk ekziston, posa u ngitet interesi kapitalistëve. Sundimi i shumicës me anë të votës? Po kjo shumicë është e verbër dhe e marrë, s’di ç’voton, hiqet për hunde prej kapi–

talistëve dhe kryqëzon mirëbërësit e saj. Parlamentet? Po këto s'janë veç komedira, ku bisedohen vetëm gjëra që u japin dorë kapitalistëve dhe për të tjerat s'bëhet fjalë fare, se nuk jep leje shumica e disiplinuar. Feja e krishterë dhe shkolla moderne? Po edhe këto përdoren si vegla për të shtrembëruar dhe për të robëruar mendjen e popullit në favor të kapitalistëve. Opinioni publik? Po këtë e kthejnë kapitalistët si mulli të erës nga të duan me anën e gazetarëve të blerë. Jo, zotërinj! – konkludon me fjalë të tjera Ibseni. – Bota borgjeze s'ka veçse një ideal, të cilin e adhuron si perëndi, dhe ky është Plaçkitja me Çfarëdo Çmimi'...” (nga “Introdukta” për dramën “Armiku i popullit”).

“Në Shqipëri kjo vepër (‘Don Kishoti’) do të kuptohet më mirë se kudo gjtë. Se atje tipat e bejlurçinës dhe të laros i gjejmë në çdo çap. Pothuaj të gjithë aristokratët tanë, me ca përjashtime të paka, janë të dekluar...dhe kanë rënë në klasën e bejlurçinave, që kur u shkëput Shqipëria prej Turqisë. Që atëherë aristokratët tanë, që i shërbenin Turqisë si kondotierë dhe shefë bashibozukësh, kanë mbetur pa punë. Gjithashtu kanë mbetur pa punë dhe pa bukë fshatarët dhe malësorët e varfër, që shkonin në kohëte vjetra me bejlerët si bashibozukë dhe hajdutë për të plaçkitur Evropën, Azinë dhe Afrikën. Këto dy elementë përpigën tani të përjetësojnë në Shqipëri një gjendje feudale, mediavale, prapanike dhe reaksionare si atë të Turqisë së vjetër...se kështu ua do interesi i klasës, se ashtu gjejnë punë dhe bukë” (nga “Introdukta” për romanin “Don Kishoti”).

Dhe ja një shembull domethënës nga vetë veprat e përkthyer prej tij, që lejon të kuptohen kriteret përzgjedhëse të Nolit si përkthyes:

“Armiku më i rrezikshëm i së vërtetës dhe i lirisë është shumica kompakte, e mallkuara shumicë kompakte liberale.” (Doktor Stokmani, “Armiku i popullit”).

Në mënyrë fare të përmbledhur mendimet e sipërpërmendura të Nolit na tregojnë qartë se përse ai u mor me përkthime: përkthimet

për Nolin ishin një mision shoqëror dhe jo vetjak, ishin, për më tepër, një mision shoqëror përparimtar – sepse në shërbim të së vërtetës – dhe jo reaksionar. Me anë të tyre ai synoi të sillte në vëmendje të shqiptarëve ide e pikëpamje shoqërore, të cilat pjesa më e madhe e njerëzve tanë të kulturës për arsye të ndryshme nuk i formulonte e nuk i jepte.

Le të shikojmë tani edhe ç’vepra konkretisht përktheu Noli: “Hamletin”, “Makbethin”, “Jul Cezarin”, “Otellon”, “Zonjën Ingra të Ostrotit”, “Armikun e Popullit”, “Don Kishotin”, “Rubaitë”, “Prometeun e lidhur” etj. Vepra, ndër më të njohurat – jo ndër më fitimprurëset! – e letërsisë botërore, vepra të fuqishme nga idetë dhe të larta për nga ana artistike, vepra të kuptueshme dhe jo abstraksione të padeshifrueshme. Cili ishte qëllimi i tij? E qartë dhe e thjeshtë: pasurimi i kulturës shqiptare me krijimet më të qëndrueshme – domethënë, më të mira – të popujve të tjerë. Pra, sërish një mision shoqëror dhe jo vetjak, një mision shoqëror përparimtar dhe jo reaksionar.

Fakti që Noli i kushtoi kaq rëndësi kulturore veprimtarisë përkthimore, fakti që zgjodhi vepra me mesazhe të mëdha shoqërore dhe me vlera të spikatura, të shquara artistike, nënkupton që ai nuk mund të mos i kushtonte rëndësi të veçantë edhe vetë anës profesionale të përkthimit. Leximi i të gjitha përkthimeve të Nolit na bind se ai është përkthyesi i parë në kulturën tonë, i cili e zhvilloi përkthimin sipas parimeve dhe kriterëve të njëjtësisë profesionale.

Mjeshtëria përkthimore e Nolit është sendërtim i dy parimeve të mëdha.

Parimi i parë: përkthimi është shqipërim, domethënë kthim i një vepre nga një gjuhë e huaj në një shqipe letrare gjerësisht të kuptueshme. Këtij parimi iu përmbajtën edhe përkthyesit më të njohur të periudhës pas Nolit. Ai mbetet parim i patundur edhe sot për kryerjen e një përkthimi të pastër, sikurse mbetet kriter themelor

për vlerësimin e një përkthimi, që të mos flasim për veprat origjinale. Dhe është një parim, i cili nuk pranon eksperimentime mendjelehta gjuhësore, pasi këto janë në kundërshtim të hapur me vetë frymën e shqipërimin, domethënë me frymën e të shprehurit shqip, qartë, kuptueshëm. Për fat të keq sot ka shumë përkthime që nuk janë shqipërime, domethënë nuk janë kthime tekstesh të huaja në gjuhën letrare shqipe.

Parimi i dytë: përkthimi është kulturë. Noli ishte njeri me kulturë të mirëfilltë, domethënë njeri i pajisur jo thjesht me kulturë informacionesh, të dhënash, por edhe e sidomos me kulturën e të menduarit, të arsyetuarit, të logjikuarit. Këtij parimi i janë përnibajur përkthimet më të shëndosha të periudhës pas Nolit. Ai mbetet i patundshëm edhe sot si parim pune dhe si kriter vlerësimi për përkthimet. Ndërkaq shumë përkthime – madje edhe shumë shkrime origjinale – të ditëve tona vuajnë nga mungesa e kulturës së nevojshme.

Parë konkretisht përkthimet e Nolit nuk shquhen thjesht për gjetje të caktuara në fushën e fjalësisë a të strukturës sintaksore, për forcën emocionale të shprehjes a njësjtërinë e vargëzimit. Ato para së gjithash shquhen për qartësinë e tyre kuptimore, për faktin se edhe sot – pas pothuaj njëqind vjetësh, periudhë gjatë së cilës shqipja e shkruar, shqipja letrare, ka kryer përparime të jashtëzakonshme, epokale, që përbëjnë nder e krenari për shkencën tonë gjuhësore dhe për letërsinë tonë më të mirë artistike e shkencore – shqipja letrare e Nolit mbetet për lexuesin thelbësisht e kuptueshme, e qartë, estetikisht e këndshme.

Pikërisht për këto arsye madhore, pikërisht për faktin se parimet dhe – kryesorja! – frytet e veprimtarisë përkthimore të Nolit u përqaftuan e u morën si shembull nga njështrat më të mirë të përkthimit shqiptar, nga Dhimitër Paskoja e deri tek Afrim Koçi, tanimë në kulturën tonë është përforcuar pikëpamja që e sheh Fan Nolin si simbol të përkthimit shqiptar, domethënë si atë pikë zana–

fillore, në të vërtetë si atë përvojë madhore, që e ka kthyer përfundimisht përkthimin shqiptar – krijimet e tij më të mira, më të shëndosha, më të vyera – në pjesë përbërëse serioze, të domosdoshme dhe të pandashme të kulturës sonë.

Ne i detyrohemi aq shumë Nolit si publicist, si politikan e burrë shteti, si klerik, si historian, si poet e muzikolog. Ne i detyrohemi aq shumë atij si përkthyes. Ndaj dhe e kemi për detyrë ta nderojmë duke ecur më tej në rrugën, që ai hapi me aq mendje e me aq guxim qytetar.

AVZI MUSTAFA, SHKUP

NOLI NË MESIN E SHQIPTARËVE TË UKRAINËS

Noli një intelekt i çuditshëm që le gjurmë të pashlyeshme në historinë dhe kulturën tonë. Më duket se ai ngel një ndër njerëzit që meriton nderet si njeri i tokës dhe i hyjnisë. Kjo fytyrë markante cili me tërë qenien e vet veproj dhe qëndroj më pranë njerëzve dhe që shkruaji e përktheu në gjuhën e ashpër të veprave. Ashtu siç thot Ralf Emersoni se “të besosh në atë që mendon, të besosh se ajo që është e vërtetë për ju, thellë në zemrën tuaj, është e vërtetë për të gjithë njerëzit, ky është gjeniu.” e ai për kombin tonë është Noli. Noli ishte dhe mbetet një *personalitet që jetonte me shqetësimet e kohës një personalitet dinamik me horizont të gjerë, ide krijuese dhe nisma të guximshme për përparimin e popullit*⁶.

Kjo vjen prej formimit të tij nga një familje me tradita fetare, me një arsim fetar prej gjimnazit, përjetimit të besimit, të angazhimeve të tij në funksionin e këndonjësit në kishë (psalt), të mësuesit të fesë edhe muzikës kishtare bizantine kudo ku shkonte në Greqi, Egjipt etj.

Noli si një njeri i ditur, klerik i lartë, kryeministër, poet, shkrimtar, përkthyes, diplomat, themelues i së parës kishë ortodokse shqiptare në SHBA më 1908, me shugurimin e tij prift më 8 mars po të këtij viti.

Noli ka qenë gjatë gjithë jetës dhe krijimtarisë së tij i pirur nga kërkesa për të bërë të mirën dhe për të sjellë sadopak dritë tek lexuesi i tij, tek besimtari. Ai përmes shkrimeve e sidomos poezisë shpreh luftën e ashpër që zhvillohet brenda shpirtit të tij për të arritur të mirën hyjnore, vëllazërinë dhe barazinë. Edhe pse kërkesat e

⁶ (Gazeta “Ngjallja” nr. 1, janar 2012).

tij janë idealiste, mënyra se si përballet me situatat e jetës është shumë realiste.⁷

Bënë pa reshtur përpjekje për të nxitur zhvillim dhe përparim të popullit tonë duke kërkuar rrugë të ndryshme , por mbështetur në idenë dhe veprimtarinë e gjerë kulturore që kishin zhvilluar mendimtarët më shquar të Rilindjes Kombëtare.

Dihet se gjatë historisë e sidomos në fund të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX në gjitha trojet shqiptare , por edhe në diasporë apo në ngulimet shqiptare në vendet e huaja u formuan shoqëri të ndryshme, u ngritën klube, u themeluan organizata të ndryshme me qëllim që të së pari të propagonin dhe ndihmonin nxitjen e intelektualëve për ngritjen e vetëdijes kombëtare në të gjitha sferat e jetës. Të gjithë njerëzi të organizuar në klube e shoqata, solidaritetin e bënin në shumë mënyra, por mënyra më e mirë ishte fjala e sinqertë që delte nga zemra e pastër e çdo patrioti, që ato shoqata e klube ktheheshin në vatra edukimi dhe arsimimi.

Një njeri siç ishte Noli i cili gëzonte respekt, sepse ishte i thjeshtë e i dashur, gojëmbël e serioz. Një bisedë me të do të mësoje shumë gjera. Kulturën që posedonte nuk e mbajti për vete , por e përhapu kudo gjatë veprimtarisë së tij. Ai ishte një njeri i sakrificës, i solidaritetit dhe i miqësisë, gjë që e shpesh herë gjatë jetës së tij të shpreh shpirtin e bujarisë, edhe përkundër që asnjëherë nuk qe në gjendje të mirë materiale.

Më 1903 shkoi në Egjipt, ku filloi punë si mësues i greqishtes për dy vjet (mars 1903–mars 1905). Aty u takua me shumë patriotë sidomos me Spiro Dinën, Thimi Mitkon , Vreton e shumë intelektualë të tjerë që punonin dhe vepronin në këtë vend.

⁷ Fabiola Kadi, Tema fetare në poezinë franceze dhe shqiptare, Punim për gradën “Doktor i shkencave” në Letërsë, Tiranë, 2014, f.162

Në prill 1906, Noli e lëshon Egjiptin dhe nisët për në Amerikë. Biletën e trajektit për në këtë vend të largët ia kishte siguruar, Spiro Dine.

Noli me intelektin e tij paraqite një fjalor diturish, një thesar i paçmuar njohurish, njohës i disa gjuhëve. Me të hipur në avulloren dhe në palubën e trajektit që rrinin plotë njerëz, që shikonin si çaheshin dallgët e detit që i linin pas, ose duke medituat për gjithçka, për familjen vendlindjen e shumë mendime që u shkonin vërdallë ndërmend. Rruga e gjatë udhëtarët i afronte i shoqëronte secilin me shumë njerëz të racave dhe të gjuhëve të ndryshme. Kështu ndodhi edhe me Nolin, por me inteligjencën dhe me dituritë shumë shpejt shoqëroheshin me të. Vlera atij i shtohet edhe më shumë sepse gjithësecili që i drejtohet për diçka Nolit ai u përgjigjet në gjuhë tyre. Çdo kush që pati rastin të bisedojë me Noli fitonte përshtypjen e ka të bëjë me një njeri modest, të urtë, dijetar me një personalitet të zgjuar e të sinqertë.

Pas një muaji gjegjësisht më 10 maj të 1906 arrin në botën e re dhe më pas punësohet në një fabrikë druri ku punon tre muajsh e pastaj kalon në Boston. Në Bruklin më 9 shkurt 1908. Fan S. Noli u shugurua në prift me qëllim për te çliruar kishën ortodokse shqiptare nga ajo greke. Noli e bëri këtë me shume për motive atdhetare, duke parë se shteti grek trumbetonte me të madhe nëpër dyert e Evropës se gjoja ortodoksit e Shqipërisë na qenkan grek dhe ne baze te saj kjo toke duhet t'u jepej atyre.

Shugurimin e Nolit si prift u bë në praninë e tre priftërinjve të priftit të Rusisë, Ukrainës dhe të Rumanisë. Meshën e parë në gjuhën shqipe e tha më 22 mars 1908.

Kishte lexuar shumë libra të filozofëve antik, e pastaj edhe të letërsisë botërore, histori, muzikë etj. Por, ai do të theksojë se libri që i jepte më shumë kënaqësi dhe paqe ishte Ungjilli. Këtë ai do ta deklarojë në pesëdhjetëvjetorin e themelimit të Kishës Ortodokse Shqiptare:

“Jam marrë me histori, letërsi dhe muzikë me raste, por feja ka qenë puna e jetës sime, sepse e fillova karrierën time si njeri i Kishës në 1909 dhe jam akoma njeri i kishës mbas 50 vjetësh”.⁸

Noli i kishte vënë detyrë vetëvehtes që të vizitojë të gjitha vendet ku kishte koloni shqiptarësh në ngulimet e ndryshme të botës. Noli dinte se ku ka shqiptar edhe për ata të Ukrainës sepse miku i tij Milto Sotir Gurra e kishte njoftuar për këto shqiptar, por nuk dinte se sa është ai numër në frymë. Nga bisedat e ndryshme, por ajo me priftin rus Platonin si dhe ai i Ukrainës kishte marrë informata të plota se në vendet e tyre ka shqiptar të fesë ortodokse me një numër të konsiderueshëm dhe se gjatë historisë së tyre janë dëshmuar si punëtorë e trima të mirë.

Shumë shqiptar pas Paqës së Jashit kaluan dhe u ngulitën në Odesë dhe rrethinë siç quhej dikur Haxhi Beg , pushtuar nga Rusia⁹.

Shqiptarët në Ukrainës kanë emigruar aty kah vitet '60 të shekullit XIX dhe kanë krijuar një koloni shqiptarësh¹⁰. Kjo koloni shqiptarësh së pari ishin vendosur në Dnjjevna afër Varnës në Bullgari. Në çerkun e parë të shekullit XIX këta shqiptarë u shpërngulën dhe u vendosën në Besarabi ku themeluan fshatin Karakurt. Një pjesë e këtyre migrimeve janë si rezultat i vuajtjeve të shqiptarëve në Perandorisë Osmane gjatë luftrave ruso-turke të viteve 1806–1812 dhe 1828–1829, por edhe migrime në rrugë të ndryshme të tërthorta e sidomos ajo me shtytjen e konsujve rus që ndodheshin në shumë qytete të perandorisë sidomos me ndërtimin e e hekurudhës tansiberiane që filloi nga fundi i shekullit XIX. Kështu që

3.Cit., J. Pelushi, “Fan. S. Noli në 130-vjetorin e lindjes –1882-2012”, Konferenca shkencore ndërkombëtare, Korçë, 2012, f. 26.

⁹ Shih prof. dr. Ismaet Dermaku Nikola Naço – Korça apostulli shqiptarizmit, Prishtinë 2000, f.196

¹⁰ S.Islami, Matrial gjuhësor nga kolonitë shqiptare të Ukrainës, “Bul. Për shkencat shoqërore, 1953, 2. .F 163, 164

emigrime të shqiptareve kemi në shumë vende të Rusisë si në Odesë, në Krime, në Kaukaz e gjetiu.

P. Kërpeu, që ka bërë hulumtime në vitin 1850 te shqiptarët e Kara Kurtit shënon se aty jetojnë 109 familje me 1060 frymë. Ai gjithashtu njofton se shqiptar kishte edhe në qytetin Boograd 10 familje me 37 frymë, në Kombart 28 familje me 164 frymë në fshatrat Çishme–Qoj 1 familje me 9 frymë, Voolkanesh 3 familje me 41 frymë si dhe në Çadar Lunga,, Bash Gjor¹¹.

Sipas Qemal Haxhihasnit me ekspeditën që ka bërë në rrethin e Kolonjës jep të dhëna se shumë shqiptar shkuan në Rusi në fillim të shekullit XX që ishin me origjinë nga Shqipëria Juglindore nga Kolonja, Bezhan. Kreshovë, Korçë, Ohër, Çermenike, Gollobërdë e gjetiu. Kështu që shqiptarët në Rusi u përhapën që nga Kaukazi, Odesa e Krakovi e gjerë në Irkusk e Vladivostok¹². Po ashtu në Hush të Moldavisë kanë jetuar familje shqiptarësh të ardhur nga Shqipëria dhe Italia . Këto banorë i takonin besimit katolik, por qenë të shtypur nga rusët ishin të detyruar që të konvertohen në ortodoksë¹³.

Ukrainasit nuk dinë shumë për komunitetin shqiptar i cili është rëndësishëm. Shqiptarët janë të njohur si Arnaut, edhe atë nëpërmjet të dy rrugëve në Odesë që janë pagëzuar “Arnauska e Madhe dhe Arnauska e Vogël”.

Sot në Ukrainë sipas regjistrimit të vitit 2001 jetojnë rreth 4000–50000 shqiptar, shumica jetojnë regjionin e Odesës 3 fshatra : Taz sot *Devnenskoje*, Tyshki sot *Gjeorgjevka*, Xhandran sot *Gamovra* . Tokën ku u ngulitën këto shqiptar ia dhuroi Katerina II e Rusisë.

¹¹ S. Islami citura sipas L. Miletit

¹² Mark Tirta, Migrime të shqiptarëve, Etnografia shqiptare ne. 18, Tiranë 1999,f.133.

¹³ Letra e Iv.Ena Qesku i Moldavisë me 8 maj 1903 derguar Nikolla Naços në Bukuresht

Këto shqiptar edhe pse shumë shekujë janë shpërngul nga vendi amë , edhe kraha shumë faktorëve të ndryshëm mbijetuan dhe e ruajtën shenjëën e kombit gjuhën. Gjuha që flitet sot në këto katër fshatra, Karakurt (Zhovtnjovoje), Taz (Devneskoje), Tyshki (Gje-orgjevka) dhe Xhandran (Gamovra), është një përzierje e shqipes toske me rusishten. Por megjithatë zakonet, veshjet dhe tiparet dalluese mbeten të njëjtë. Banorët e këtyre fshatrave e identifikojnë veten si shqiptarë. I ruajtën me xhelozinë ma të madhe: gjuhën, zakonet, doket, dhe veshjen kombëtare.

Shqiptareve të mërguar në Ukraine nuk u lejohej asgjë përveç punës fizike i sidomos me nacionalizimin e tokës nga socializmi rus iu murr edhe ajo pak tokë. Ata nuk kishte kush ti mbrojë ishin të harruar nga të gjitha anët.

Noli ishte ai i pari që kishte shprehur dëshirë që t'i vizitojë dhe kështu më 10 gusht 1911 ai u nis për në Evropë, ku ndenji katër muaj.

Me të arritur së pari në Bukuresh ku u prit nga Shoqëria e mësimt shqip “Drita” e Bukureshtit shprehu dëshirën për të vizituar shqiptarët e vendosur në Molldavi e Ukrainë. Noli s’kishte se çka tu dhuroj këtyre shqiptareve përveç t’i lutet Zotit që ti bekojë e t’i mishërojë dhe tu fusë në shpirt dritën e mesazhit hyjnor. Sepse Zoti kurrë nuk i harron ata që kanë besim në të.

Noli gjatë qëndrimit të tij kreu edhe shërbesa kishtare në gjuhën shqipe për kolonitë në Bukuresht, Kishinjov, Odesë, dhe Sofje.

Me interes është shërbesa kishtare në Ukrainë. Meshën e mbajti në një kishë lokale që kryenin shërbimet fetare unijatët¹⁴. Meshën për të cilën e mbajti, Noli u përputh me festën fetare të “Shën Mërisë së Madhe”. Atë ditë kisha ishte mbushur plotë e përplotë besimtarë ortodoksë e sidomos nga katër fshatra kishin ardhur për të dëgjuar

¹⁴ Këtë e ka pohuar oficeri shqiptar që ka jetuar në Rusi, Ramadan Çilku i lindur në Dibër

meshën. Shqiptarët e Odesës ishin ma të gëzuarit sepse për herë të parë pa 4 shekujsh do të dëgjojnë meshë nga një peshkop që do të “zallahitë” e do të “shqyptojë” si ata. Ata ishin veshur me kostume kombëtare, secili mbante në dorë një qiri dhe secili kërkonte t’i afrohet e t’i puth dorën peshkopit. Noli do të deklarojë se “I këndoj lutjet ashtu si dini në shqip, po pastaj lartë i rregullon perëndia”

Përmbajta e meshës që e mbajti në gjuhën shqipe mbante këtë tekst:

“Vëllezër dhe motra, besnikë të shumtë që merrni pjesë në këtë meshë sot. Për mua që një kënaqësi dhe njëkohësisht një lumturi e madhe që të parit m’u dha rasti që ta nxjerr këtë meshë përpara anëtarëve të kollonisë shqiptare në gjuhën shqipe, në gjuhën tonë amtare, në atë gjuhë që kanë folur baballarët, gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë, gjuhë me të cilën jemi mëkatuar, që me të na ka rënë koka në dhetë. Grekërit thonë se sa janë të krishterë janë grekë, sepse janë orthodoxë. Por orthodoxia është një gjë, kurse kombësia është diçka tjetër. Ne nuk jemi as grekë, as bullgarë, por jemi thjesht shqiptarë. Këtë vëllezër dhe motra të dashura, na e vërtetoi më së miri dhe mesha jonë sot, të cilën e dëgjuat me aq vëmendje, sepse e kuptuat se ajo u mbajt në gjuhën tuaj, që është e ëmbël për ne si qumështi i nënës! Të bekuar qofshi të gjithë!”¹⁵

Pas këtyre vizitave që u bëri Noli kolonive shqiptare kthehet përsëri në Amerikë. Por temperament i tij nuk le të qetë. Mendja i rrinë në tokën amë ku dëshiron që të themelojë kishën autoqefale në Shqipëri dhe këtë e edhe e realizon.

Krahas angazhimit kishtar, Noli merret edhe me politikë, me shkrime e me organizime të ndryshme, por të gjitha në interes të njerëzve e të Shqipërisë për emancipim dhe afirmim kombëtar e ndërkombëtar. Këtë fytyrë të ndritur e të mençur të kombit në bazë të dokumenteve e fondeve të Arkivit të Punëve të Jashtme të Fe–

¹⁵ Fjala e Lirë, June 2, 2014

deratës Ruse shohin se Noli do të behet një nga emrat më të përmendur në kohën kur Federata Ruse dëshiron që të lidh marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë gjatë viteve '20 dhe '30 të shekullit XX. Qeveria Ruse duke u nisur nga dëshira për lidhjen e marrëdhënieve normale, duke u thirrë pikërisht në shqiptarët e Odesës të Ukrainës për riatdhësimin e shtetasve shqiptar, të cilët jetojnë në Rusi si pretek për të filluar bisedimet.¹⁶

Përfaqësuesi i autorizuar shqiptar për riatdhësimin e shqiptareve Z. Kolombi i drejtohet komesaritit për punë të jashtme M. M. Litvinov me 2 qershor 1923 “se ekziston dëshira thuhet në një dokument për lirimin e vartësisë religjioze prej Patrikut grek të Konstantinopojës për tu themeluar kisha e pavarur dhe se për këtë është autorizuar ish ministri i punëve të jashtme kleriku Fan Noli për zbatimin e kësaj reforme dhe dëshiron të vijë në Rusi”¹⁷. Sipas dokumentit edhe pse ia është lejuar shkuarja e Nolit në BRSS ende nuk ka shkuar. Nga Nënraporti për shtetet ballkanike të KPPJ informohet Ministria e punëve të jashtme se: “Fan Noli planifikon të vijë në Rusi për negociata me kishën e gjallë në lidhje me formimin e kishës autoqefale shqiptare”¹⁸.

Mirëpo më 21 korrik 1924 G.V. Çiçerin e njoftojnë se Fan Noli ka formuar qeverin dhe është kryeministër dhe ministër i arsimit popullor. Në dokumentin nr. 29 nga Jurinev njofton Çiçerini se edhe pse Fan Nolit iu dha viza për tu njohur me lëvizjen e përtrirë të kishës ortodokse për arsye të panjohura nuk erdhi ta marrë, por sipas asaj si ka dëgjuar thuhet “se ai (Noli) ka shkuar në vende të ndryshme përtej kufirit ka tentuar të lidh njerëzit tanë, diku si duket

¹⁶ Lenina Zhila dhe Vlladi Poposki, Marrëdhëniet Sovjetike-Shqiptare në vitet '20 dhe '30 të shekullit XX, Notë e dorëzuar përmes përfaqësuesit të autorizuar të BRSS në Gjermani, për kryeministrin e Shqipërisë. A Zogu, 3 janar 1924 9 doku. (Dokumenty vnesej politiki SSSR.M, 1962. T.6 dok. 61), Tetovë 2012

¹⁷ Ibid, f. 40

¹⁸ APJ FR F.)144. Psh 6 Fashikul 101. Nj a 8 F.30 (dokumenti i plotë-F 27-31 (kopje shkrim makine)

në Zvicër apo në Vjenë, priste ndonjë përfaqësues prej tre muajsh, por nga këto tentativa të tij nuk doli gjë”¹⁹. Edhe shpesh Nolin e quajmë si të njeri të kuq dhe simpatizues i socializmit, diplomacia Ruse dyshonte ndaj Nolit duke thënë se Fan Noli është krijesë e diplomacisë Italiane. Ajo e shfrytëzon atë qysh nga viti 1917 kur “ai me ndihën e ambasadorit italian në Vashington, Konti Maki di Çalere, fillojë të bejë propagandë në mesin e kolonisë shqiptare në SHBA, duke botuar me këtë rast revistën “Vatra” dhe gazetën e përditëshme “Dielli”. Mjetet për këto botime qenë dhënë nga ambasadori italian në Amerikë”²⁰.

Rusët edhe pse ende po shpresonin Noli ishte një njeri ditur e diplomat dhe nuk ngutej sepse lidhja e marrëdhënieve me BRSS nuk mund të lidhej sepse Rusia nuk i përtërinte marrëdhëniet e saja me Antatën .

Nolit nuk iu realizua kjo dëshirë për të shkuar edhe për së dyti tek shqiptarët e Ukrainës për të realizuar misionin e tij historik dhe për tu ndihmuar atyre shqiptarëve të varfër që punonin në heshtje , me djersë e me durim në një kënd të botës në vatrën e tyre të thjeshtë e të vetmuar, duke ushqyer një dëshirë e zjarrtë me vite e shekuj me radhë për gjuhën shqipe e për kishë të pavarur.

¹⁹ Lenina Zhila dhe Vlladi Poposki, Marrëdhënietë Sovjetike-Shqiptare në vitet '20 dhe '30 të shekullit XX, Letër udhëheqësit të Nënseksionit për shtetet ballkanike të KPPJ G. B. Sandomirski për komisarin e popullit për punë të jashtme G.V. Çiçerin .22 korrik 1924), Tetovë 2012

²⁰ Lenina Zhila dhe Vlladi Poposki, Marrëdhënietë Sovjetike-Shqiptare në vitet '20 dhe '30 të shekullit XX, Raporti i përfaqësuesit të autorizuar në Itali K.K. Jurenev, 4 gusht 1924 nr. 430 të dt 4/8), Tetovë 2012

ZEQIRJA NEZIRI, SHKUP

NOLI DHE EPIKA GOJORE SHQIPTARE

Hyrje

Në këtë studim kemi shtruar në diskutim analizën përmbajtjesore nga Fan Noli të një kënge trimërore, me çka dëshmohet interesimi i tij për interpretimin dhe afirmimin e këndimit epik shqiptar, kontekstualisht të disa llojeve të letërsisë gojore shqiptare të gjysmës së shekullit të nëntëmbëdhjetë. Kjo fushë e krijimtarisë së tij nuk është vërejtur nga studiuesit e tij, aq më pak i është kushtuar vëmendje studimit të saj. Kjo analizë është përdorur në kontekst të një fjalimi që Noli e ka mbajtur në shkurt të vitit 1959 para mërgimtarëve në 50-vjetorin e themelimit të gazetës “*Dielli*” (Ligjërime 346–359).

Kontekstualizimi

Fan Stilian Noli, nëpër ligjërata e fjalime, ashtu si senatorët e lashtësisë romake të antikitetit shpesh ka përdorur lloje të ndryshme të letërsisë gojore shqiptare, si dhe të letërsive të popujve të tjerë. Varësisht nga tematika e tubimit kontekstualizoheshin anekdotat, por nuk qëndrojnë prapa edhe përrallëzat e këngët epike, si në rastin tonë, si dhe pjesë të përjetimeve personale të tij e të bashkëluf-tëtarëve. “Janë të panumërta anekdotat e goditura, nënvizon Nasho Jorgaqi, që ai do t’i quante ‘mesele’, mbi bazën e të cilave do të ndërtonte fjalimet apo do të realizonte synimet e veta iedoemocio-nale mbi auditorin” (Ligjërime 16).

Këto pjesëza kur i shkëpusim nga konteksti na japin të kuptojmë se ai ka treguar një interes të veçantë dhe ka dhënë një ndihmesë të madhe e shumë të çmueshme jo vetëm në analizën e disa llojeve të letërsisë gojore shqiptare, por edhe në interpretimin, njohjen dhe afirmimin e saj. Nasho Jorgaqi, më tej shton: “Noli orator do të

shfrytëzonte me sukses vargje nga poezia popullore, sidomos nga epika historike, si ato të Rrapo Hekalit” (Ligjërime 16).

Midis interesimeve të tij shohim se një vëmendje jo të parëndësishme i ka kushtuar edhe këngës trimërore, në rastin konkret këngës, e cila përshkruan trimërinë e guximin e Rrapo Hekalit dhe aktualizimin e saj në kontekst të veprimtarisë së “Vatrës”.

Me këto shkrime, ai ka përmbushur dy kërkesa: (a) ka bërë një interpretim e diskutim të thelluar të teksteve; dhe (b) vlerën e tyre letrare e shoqërore, moralizuese e edukative e ka aktualizuar dhe përgjasuar me situata konkrete të jetës së mjedisit shqiptar, shprehet Ibrahim Rugova (Rugova 186).

Ndaj patriotizmi është temë e përshtatshme që luan rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin, vetëdijësimin e sendrën e mërgimtarëve. Teksti është shkruar në vetën e parë dhe të dytë, ashtu si zakonisht ndërtohen fjalimet e ligjëratat.

Çka ka veçuar Fan S. Noli te kënga e Rrapo Hekalit?

Fjalimin e tij e nisë me një fjali mohore: “*Thonë se shqiptarët s’kanë pasur patriotizëm*”. Me këtë fjali të përgjithësuar Noli ka vënë në sprovë ndërgjegjen kombëtare të mërgimtarëve shqiptarë.

Ai sprovon dëgjuesit, por dhe arrin dëgjueshmërinë absolute, sepse prek në nderin, sedrën e dinjitetin e tyre. Në vijim për ta argumentuar trimërinë e patriotizmin e shqiptarëve të treguar ndër shekuj përgjigjet: “*Gjë më e gabuar se kjo s’ka*”. Rrapo Hekalin Noli e ka përmendur në shumë fjalime dhe në kontekste të ndryshme (Lirgjërime 87; Publicistika 362).

Ky interlud, kjo mënyrë e veçantë e hyrjes në analizën e këngës përdoret si mjet ndërlidhës midis të veçantës dhe të përgjithshmes. Stili retorik dhe përdorimi i vetës së dytë, si dhe mënyra e drejtpërdrejtë i krijon mundësi ta përtheksojë të veçantën dhe të

vendosë marrëdhënie të afërta komunikimi me dëgjuesin dhe të fitojë dëgjueshmëri maksimale. Në vijim sjell të dhënat tekstuale të këngës.

Në interpretimin e kësaj kënge Noli është përqendruar në veçimin e kategorive morale, si guximi e trimëria e pashoqe, sakrifica e patriotizmi. Dëshmi më të saktë, vijon ai, ofron libri i Thini Mitkos, i cili përligj patriotizmin e shqiptarëve në të kaluarën. Këngën, që ai e quan vjershë e sjell të krijuar tri vjet pas Kryengritjes së Labërisë.

Vendosja në kohë dhe në hapësirë

Është periudha e zbatimit të reformave të Tanzimatit, të cilat, siç dihet në të gjitha anët, si dhe në Labëri u pritën me pushkë. Në këtë mënyrë, ai përmbajtjen e këngës e vendos në kohë dhe në hapësirë: në vitin 1850 dhe në Labëri. Duke folur për atmosferën kohore të kësaj ngjarjeje, para dëgjuesve mërgimtarë Noli sjell vetëmohimin e sakrificën e labëve në mbrotje të lirisë e të mbijetësës. Kënga e analizuar nga Noli, në botimin e Mitkos (Mitko, kënga 422, f. 39) ka tetë vargje të cilët përputhen me tetë vargjet e fundit të këngës 54 (f. 100) të *Epikës historike 2*. Ndërkaq 6 vargjet e tjera në vijim të këngës së janë të një kënge tjetër.

Katër nivele të interpretimit

Analiza përmbajtjesore e kësaj kënge prej Nolit ndahet në katër skena, ku veçohen katër nivele të interpretimit të këngës, nëpër të cilët fuqizohet guximi e trimëria e pashoqe e këtij heroit të Lëvizjes së Labërisë dhe bashkëpunimin e ngushtë të Rrapo Hekalit me forcat e kësaj lëvizjeje të përgjithshme. Janë në pyetje vetëm katërmbëdhjetë rreshta /vargje/, thekson Noli. Kënga analizohet pjesë-pjesë duke e ndarë në njësi të vogla dhe duke u ndalur veç e veç në secilën prej tyre. Gjithë analiza ndahet në katër skena përshkrimore. Në secilën prej tyre ka marrë për analizë nga tri vargje.

Trimëria e Rrapo Hekalit

Analiza e këngës hapet me përshkrimin e trimërisë së Rrapo Hekalit, e cila dëshimohet me anë të vargut që flet mbi prenjë e Rrapos: ai ka zënë rob “*Një pasha me shtatë tuje*”. Në dy vargjet paraprase të hyrjes në këtë këngë përmes eksklamacionit me anë të përdorimit të thirrtores përtheksohet vepra e Rrapos, që mbyllet në vargun e tretë.

Figura e kundërshtarit duhet të përshkruhet e denjë, e hipebolizuar dhe jo e një qyqari, sepse ndryshe nuk do të mund të lartësohej figura e heroit kombëtar. Për ta theksuar trimërinë e jashtëzakonshme dhe me elemente mitike e legjendare të Rrapo Hekalit rapsoni para tij ka vendosur gjeneralin me shtatë tuje.

Ja si përshkruhet kundërshtari i Rrapo Hekalit:

*Hajde, more Rrapo, o lule,
Lumthi ti, bilbil që zure,
Një pasha me shtatë tuje.*

Pashai që zuri Rrapoja, kishte shtatë tuje, nënvizon Fan Noli.

Këtë procedë hiperbolike e ka vërejtur Noli me një sy të kujdesshëm e të vëmendshëm, kur jep komentin: “Tujet ishin tamam si ato yjet që mbajnë gjeneralët e Amerikës. Kemi gjeneralë me një yll, gjeneralë me dy yje, me tre yje dhe me katër yje. Përmby katër yje, s’ka gjeneralë! /.../. Po vjershtëtori, vazhdon Noli do të thotë se çfarë pashai zuri Rrapo Hekali. Ay pasha që dy herë sa pashallarët e tjerë, domethënë gjenerali më i mirë i Turqisë. Edhe këtë, e shtypi Rrapo Hekali!” përfundon Noli.

Morali dhe strategjia luftarake e Rrapos

Skena e dytë përqendrohet në përshkrimin e trimërisë dhe të moralit të lartë luftarak të Rrapo Hekalit. Më tej Noli shtron pyetjen

retorike: “Çfarë strategji, çfarë taktike mbajti Rrapo Hekali që e shtypi këtë gjeneral të dorës së parë të Turqisë?”:

*Topi bam e ti po tutje,
Plumbat të binin mbi supe,
As u trëmbë, as u tute.*

“Domethenë me një trimëri të thjeshtë dhe asnjë zanat, asnjë mjeshtëri tjetër” konstaton Noli.

Bashkërenditja e forcave luftarake

Skena e tretë merret me interpretimin dhe përktheksimin e atmosferës kohore dhe me përfshirjen e veprimtarisë së Rrapo Hekalit, si diçka të veçantë, individualizuese në rrjedhat e përgjithshme kombëtare, në kuadrin e tërësisë së kryengritjes së Labërisë. Kështu, trimëria e tij bëhet pjesë përbërëse dhe shenjon një segment e një pjesë të së tërës, të Lëvizjes së përgjithshme të Labërisë. Rëndësia e qëndresës, guximit e trimërisë së Rrapos është në përvijim të drejtpërdrejtë të kësaj lëvizjeje dhe kjo atij i jep zemër e shpirt, e trimëron. Aty janë bashkëluftëtarët e tij Hodo Nivica e Zenel Gjo-leka, të cilët kishin ngritur flamurin e kryengritjes.

Noli, përsëri shtron pyetjen retorike dhe atypëraty përgjigjet: “ç’gjë e ndizte, ç’gjë e shkaktoi këtë hov të pathyer të shqiptarëve? Vjershëtori na i thotë përsëri me tri rradhë”:

*Se Hodo Nivica shkoi,
Kofshën derrit ja dërmoi,
Ngriti flamurin te kroi.*

Interpretimi i Nolit: “Ai derri të cilit Hodo Nivica ja theu kofshën ishte turku. Flamuri te kroi, ishte flamuri i kryengritjes, flamuri i lirisë”.

“Ustai i madh nuk humbet shumë fjalë”

Skena e katërt merret me interpretimin e mënyrës së ndërtimit të vargjeve, si dhe me aftësinë e jashtëzakonshme të rapsodit, i cili është i kursyer në përdorimin e fjalëve.

Noli vazhdon: “Edhe më në fund, qëllimi për të cilin bëhej e tërë kjo luftë? Prapë, përsëri në tri rradhë t’a thotë vjershëtori. Ustai i madh nuku humbet shumë fjalë.

Dy-tri, mjaftojnë për të:

Pse lëfton, o derëzi?

As për mua as për ti,

Po për gjithë Shqipëri!

Përfundimi i këngës mbyllet “me dy-tri” fjali thotë Noli. Sepse, rapsodi i madh tregohet i kursyer.

Aktualizimi

Me këtë mënyrë interpretimi të përmbajtjes së këngës Noli krijon mundësinë atmosferën kohore të kësaj ngjarjeje që përshkruhet në këtë këngë ta aktualizojë në kontekst të përjetimeve të tij të themelimit të “Diellit”.

Shembulli tjetër i interpretimit të Nolit është kontekstualizimi, gjegjësisht aktualizimi i përballjes së historisë – faksionit me letërsinë – fiksionin: “Tashi, arsyeja për të cilën na vajti puna mbarë, ishte se kishim një popull me të vërtetë i cili e deshte Shqipërinë”.

Përfundim

Me studimin e kësaj pjese të veprimtarisë shumëdimensionalëshe të Fan Nolit, në planin e interesimeve të tij krijuese e shkencore

njihemi me një veprimtari të papërmendur e të paeksploruar në studimet noline. Lënda rrihet në kontekst të studimeve teorike të kohës, si në rrafshin e veçantë diakronik kombëtar të pikëpamjeve të atëhershme teorike të studimeve shqiptare të këngës epike, ashtu edhe në planin e përgjithshëm ndërkombëtar të studimeve teorike të historisë e të teorisë së letërsisë në përgjithësi, si dhe të arritjeve në fushën e letërsisë gojore e të këndimit epik shqiptar. Në këtë aspekt ndriçimi i kësaj fushe të krijimtarisë së Nolit sjell ndihmesë në fushën e tekstologjisë e të bibliografisë së tij, mandej të albanologjisë e të historisë, sidomos të çuarjes përpara të çështjeve të vlerësimit të mendimit të personaliteteve të letrave shqipe kushtuar epikës gojore shqiptare.

Bibliografia:

- HAXHIHASANI, Qemal & DULE, Miranda (përgatitur)(1981), *Epika historike*. Vëllimi i dytë, Tiranë.
- KALO (SHËNGJERGJI), Valbona (2012), Kritika funksionale e Nolit: “FAN S. NOLI NË 130 – VJETORIN E LINDJES” 1882–2012, Konferencë shkencore, Korçë: (http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/fakulteti_edukimit/materiali_fnoli_130vjetor.pdf)
- MITKO, Thimi (1981), *Vepra*, Tiranë.
- NOLI, Fan S. (2002), *Ligjërime (1906–1964)*, zgjedhur e përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Dudaj, Tiranë.
- NOLI, Fan S. (2007), *Vepra 4. Publicistika*, Dudaj, Tiranë.
- RUGOVA, Ibrahim, & HAMITI, Sabri (1979), *Kritika letrare*, Rilindja, Prishtinë.
- SHALA, Kujtim (2012), Studimet letrare shqipe: *Seminari 31/2*, Prishtinë: <http://www.kosova.com/artikulli/70836>

MIRLINDA KRIFCA BEQIRI, SHKUP

NOLI MES MITIT DHE REALITETIT

Noli qe veprimtar që zgjodhi rrugën e sakrificës ashtu si Marat—honomaku i poezisë së tij të jashtëzakonshme, qe poet që në mënyrë profetike krahasoi fundin e jetës së tij me atë të profetit Moisi, qe politikan që vdiq me ndjenjën e zhgënjimit politik, por edhe me bindjen se rruga politike që kishte zgjedhur ishte e drejtë, pavarësisht se s'përkonte me aspiratat e mjedisit për të cilin ai e zgjodhi këtë rrugë. Arti i tij i angazhuar qe ngushtë i lidhur me aktualitetin shqiptar të kohës para dhe pas revolucionit të vitit 1924, në krye të të cilit ai ishte vënë. Poezia e Nolit me raportin që vendos me ngjarjet politike të kohës, kërkon një lexues më aktiv, një lexues për të cilin, sidomos pas teorisë së Hans R. Hausit,²¹ flitet gjithnjë e më shumë.

Për dallim nga pararendësit e tij të mëdhenj që himnizonin të kaluarën, veprën letrare të Nolit e intereson aktualiteti, duke u bërë kështu letërnjoftim i autori dhe kohës në të cilën ai jetoi e veproi. Lidhja e ngushtë e artit nolian me aktualitetin shqiptar të kohës bën që studimet formaliste të mbeten të pamjaftueshme për ta zbërthyer atë. Natyra e kësaj vepre na përkujton përparësitë që ofron teoria e Mihail Bahtinit²² dhe pasardhësve të tij, që ndalen në lidhjet e letërsisë me realitetin. Poezitë e Nolit, me së cilave ekziston një lidhje e çuditshme, meqë secila prej tyre, në një mënyrë është e ndërftuar edhe në veprat tjera, na përkujton edhe teorinë e Zhak Derrida-së.

Letërsia shqipe e periudhës mes dy luftave që, për shumëçka, mbetet e veçantë dhe e papërsëritshme, vazhdon të mbetet e hapur ndaj

²¹ Hans R. Jaus, *Estetika recepcije*, Nolit, Beograd, 1978.

²² Mihail Bahtin, *O romanu*, Nolit, Beograd, 1989.

mitologjisë, sado që raporti që vendos me të karakterizohet me një qëndrim të ri dhe rezulton me një funksion të ri. Autorë të njohur të kësaj periudhe, në mesin e të cilëve edhe Fan Noli, arrijnë që të aktualizojnë dhe transformojnë figura të caktuara mitologjike, të cilat duke u resemantizuar fitojnë vlerë të re dhe i përgjigjen sensibilitetit të kohës së re.

Lidhja mes artit dhe mitit është vërtetë bukur herët. Sipas R. Jakobson-it: *“Poezia dhe miti janë dy forca të lidhura afër, të cilat janë në të njëjtën kohë edhe kontradiktore”*.²³ Fakt është se si miti ashtu edhe arti karakterizohen me një shkallë të lartë të emocionalitetit, fantazisë, imagjinatës. Por, derisa miti është prodhim i fantazisë kolektive, arti është prodhim i fantazisë individuale.” *Historitë më të mëdha mitologjike dretjepërdrejtë i referohen të pavetëdijshmes. Mbështeten në intuitën, kurse fuqia e tyre qëndron në ndriçimin e shqyrtimit që e shpjegon mungesën e shpjegimeve të arsyeshme, duke e detyruar arsyen ta kuptojë nevojën për një njohje më të plotë”*.²⁴ Edhe për Frojdin dhe Jungun miti dhe arti janë produkte të pavetëdijshme që manifestohen në arketipe.

Studimet letrare të personaliteteve të caktuara dëshmojnë se në veprat e tyre miti gjen hapësirë të duhur dhe se kultura mitologjike është e domosdoshme për të kuptuar veprat e tyre, gjegjësisht fillesën e tyre mitologjike. Me vetë faktin se, edhe përkundër shkallës së lartë të zhvillimit të mendimit shkencor, mitet akoma jetojnë, domethënë se njeriu ka nevojë për ta, meqë: *“... mitet shprehin shpirtin, i cili krijon me anë të botës ku bën pjesë edhe ai vetë...”*²⁵

Miti, jo rrallë, është konsideruar si shembull i arketipit, përkatësisht si strukturë arkizhanrovike letrare, prandaj shpesh edhe letërsia është

²³ Roman Jakobson, Kristyna Pomorska, *Dialogues*, The MIT PRESS, Cambridge, Massachusetts, 1988, f. 150.

²⁴ Artur Koterel, *Rečnik svetske mitologije*, Nolit, Beograd, 1998, f. 9.

²⁵ Umberto Eco, *Struktura e papranishme*, Dukagjini, Pejë, 1996, f. 252.

konsideruar si mitologji e transformuar, përkatësisht është besuar se miti, në të vërtetë, është hipotekest universal letrar.

Për një njeri si Noli, autobiografia e të cilit na njofton se ia kishte ënda të krahasohet dhe identifikohet me njerëz të mëdhenj, është e qartë se miti zë një vend të rëndësishëm. Poezia e Nolit merr simbole nga mitologjia shqiptare, nga bota e pasur e përrallave tona, p.sh gjejmë në të figurën e kuçedrës, lubisë, divit, dragoit, lugatit, zanës etj. Te ai gjejmë edhe elementin e hajmalisë, si një lloj magjie të bardhë, apo shenjë mbrojtëse (“*Tallja përpara kryqit*”).

Te poezia “*Thomsoni dhe Kuçedra*”,²⁶ Noli shërbehet me figurën mitologjike të kuçedrës, e cila simbolizon forcat esatiste. Në fund të poezisë, autori shprehet se pas vrasjes së Thomsonit mbetet *Hija* e tij, që gjithashtu është element mitologjik. Gjithsesi, nuk është e rastit që në poezi i kushtohet shumë kujdes *Urës*, vendit ku zhvillohet lufta, meqë *Ura*, sipas besimeve shqiptare, është objekt i respektuar, të cilën nuk e prish as dragoi, ashtu siç nuk është rastësi edhe përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të këtij emri.

Edhe poezia elegjiake “*Shpell` e Dragobisë*”,²⁷ pos elementeve historike e legjendare ngërthen edhe elemente mitologjike. Këtu, sikurse në folklorin shqiptar, Bajram Curri krahasohet me figurën e dragoit, si antipod i kuçedrës. Noli gjen pika takimi mes figurës së B. Currit dhe figurës mitologjike të Anteut, që forcën e vet e ka të lidhur me tokën amë. Fundja, krahasim më të bukur s`mund të gjente.

Në poezinë e Nolit, lidhja e simbolikës mitologjike me realitetin shqiptar, si situata jashtëtekstore që i shërbejnë autorit si hipotekest, përkatësisht si material i krijimit të tij, bëhet në mënyrë origjinale dhe me mjeshtëri të rrallë. “*Ai kurrë nuk mbetet në caqet e para*—

²⁶ Fan Noli, *Albumi*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f.31-33.

²⁷ *Ibid*, f. 59-61.

qitjes së thjeshtë të një rrëfimi mitologjik. Me materialin e vjetër ai krijon një godinë të re".²⁸

Në poezinë "*Rent, or Marathonomak*",²⁹ në të cilën riaktualizohet dhe resemantizohet legjenda mbi lajmëtarin e fitores greke nga lufta e Maratonës, Noli shërbehet me figurat mitologjike të *Najadave*, *Magjistricave*, *Driadave*.

Mallkimet dhe urimet, si elemente mitologjike, në veprën e Nolit janë shumë të shpeshta, sidomos të parat. Kështu, poezia e tij e njohur "*Marshi i Barabbajt*",³⁰ në të vërtetë, e tëra është mallkim drejtuar figurës së Barabait, përkatësisht Zogut, ndërsa poezia "*Marshi i Krishtit*",³¹ që paraqitet si antitezë e së parës, është e mbushur me urime drejtuar Krishtit, përkatësisht Nolit.

Njohësit e veprës së Nolit, në përgjithësi, nuk e kanë pasur të vështirë të hetojnë se Noli, varësisht nga tipi i tekstit me të cilin punon, heronjtë e tij diku i mvesh me tipare mitologjike e legjendare, e diku i zhvesh, gjithmonë duke pasur parasysh kërkesat që i imponon teksti përkatës. Sido që të jetë, fakt është se miti dhe antimit janë preokupim i përhershëm i Nolit, i cili kishte sens për masën dhe vendin e përdorimit të tyre. Me këtë qëndrim ndaj mitit dhe antimit, Noli është konsideruar edhe si mitologu i parë shqiptar.³²

Studimet shkencore dhe historike të Nolit, si "*Bethoveni dhe Revolucioni Francez*"³³ dhe "*Historia e Skënderbeut*"³⁴ dëshmojnë përpjekjen e tij që heronjtë në fjalë t'i zhveshë nga miti dhe leg-

²⁸ Alfred Uçi, "Simbolika mitologjike dhe realizmi në poezinë e F. S. Nolit", Drita, Tiranë, 1982, 31 janar, f. 11-12.

²⁹ Noli, *op.cit.*, f. 62-64.

³⁰ *Ibid*, f. 46-47.

³¹ *Ibid*, f. 39-40.

³² Mensur Raifi, *Fan S. Noli dhe Migjeni*, (botimi i dytë), Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 86.

³³ Fan Noli, *Vepra II*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2003.

³⁴ Fan Noli, *Vepra III*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2003.

jenda, i bindur se karakteri i lëndës në fjalë, përkatësisht kërkesat e një teksti shkencor apo historik, nuk durojnë praninë e elementeve mitologjike dhe legjendare, sado që ato, në lexim të parë, mund të na duken interesante dhe freskuese.

Por, nga ana tjetër, në elegjinë e tij të njohur mbi Bajram Currin ai, gjithashtu, portetizon një figurë historike shqiptare të cilën, kësaj radhe, e mvesh me tipare legjendare, sikurse edhe figurën e kolonelit Thomson, për shkak se, sado që këto figura janë historike, tekstet ku ata paraqiten si heronj ndryshojnë për nga karakteri i tyre, pra janë tekste letrare. Derisa tekstet e para, gjegjësisht teksti mbi Bethovenin dhe ai mbi Skënderbeun janë tekste shkencore, teksti i tretë dhe i katërt janë tekste letrare, përkatësisht poetike dhe si të tilla tolerojnë, madje edhe preferojnë prezencën e elementeve mitologjike e legjendare.

Në veprën noline, si në dramën ashtu edhe në poezinë e tij, materialet dhe simbolet biblike nuk përcjellin kuptimin e tyre parësor, por janë në shërbim të veprës së re, ku ky material fiton kuptim të ri. Noli çmistifikon Moisiun, Krishtin, Shën Pjetrin, Barabajn dhe Kirenarin për të paraqitur figura ekuivalente të mjedisit shqiptar të kohës, që ai e njilhte mirë.

Një njeri me kulturë shumë të pasur fetare, letrare e kulturore si Noli dëshmon, jo vetëm njohje të mirë të materialit biblik, pra të situatave dhe simboleve biblike, por edhe afinitet për ta asimiluar këtë brum dhe për ta përshtatur me rrethanat konkrete të kohës që, gjithashtu i njilhte mirë, meqë roli i tij në jetën politike të kohës ishte shumë i rëndësishëm.

Pra, Bibla si një hipotekst universal ose si një gramatikë e domosdoshme e arketipeve letrare, siç e ka cilësuar Northrop Fraj,³⁵ paraqet një hipotekst të rëndësishëm për veprën letrare të Nolit. Ai

³⁵ Northrop Fraj, *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, 1990.

kthehet në tekstin e kanonizuar biblik vetëm atëherë kur ka nevojë që prej tij të marrë situata dhe simbole, që janë analoge me ngjarje dhe situata të caktuara nga konteksti politik shqiptar i kohës. Pra, në ciklin e tij të njohur poetik me motiv biblik, Noli bën afrimin e dy realiteteve që, si në aspektin kohor ashtu edhe në atë hapësinor, janë shumë larg njëri – tjetrit. Poezitë e këtij cikli mbështeten në dy situata jashtëtekstore, në tekstin paralettrar biblik dhe në kontekstin politik shqiptar.

Mbështetja në brumin biblik i mundëson Nolit që poezia e tij të receptohet më lehtë nga lexuesi shqiptar, por njëkohësisht edhe të krijojë poezi, e cila do të ketë se çfarë t'ju ofrojë, jo vetëm lexuesve të kohës së tij, pra atyre që i njihnin ngjarjet dhe personalitetet politike të kohës, por edhe lexuesve të kohës së re. Pra, mvëshja e kësaj poezie me një tis biblik i jep asaj karakter universal dhe përgjithësues, duke mundësuar kështu që t'i rezistojë kohës.

Poezitë e ciklit me motiv biblik mbështeten në një situatë të caktuar biblike ose në më tepër situata të tilla, sado që nuk mungojnë edhe rastet kur autori nuk ndalet në një situatë konkrete biblike, por në analogji me një situatë të caktuar, paramendon një situatë analoge ose të kundërt me të parën (si te poezia “*Marshit të Barabbajt*”).

Pavarësisht se poezitë e këtij cikli karakterizohen me mbështetje të dukshme në materiallin biblik, megjithatë kohë pas kohe ato plotësohen me momente nga realiteti që, pavarësisht se janë të pakta përnga sasia, megjithatë janë shumë domethënëse dhe të njaf-tueshme për të na kthyer në realitetin shqiptar të kohës.

Noli, pos që shërbehet me toponiminë shqiptare (sidomos në poezinë patriotike), në ciklin poetik me motiv biblik, ai dendur përdor toponiminë biblike, që përdoret paralelisht me antroponiminë biblike, sado që me të aludon në hapësirën gjeografike shqiptare, e cila lexohet mes rreshtave. Edhe toponimia biblike, ashtu si antroponimia ngrejnë shkallën përgjithësuese të poezisë noliane, në përgjithësi.

Poezia e Nolit dëshmon një shkallë të lartë të lidhjes me realitetin, gjegjësisht me kontekstin politik shqiptar të kohës, pavarësisht se simbolet me të cilat ajo shërbehet, në të shumtën e rasteve, janë biblike, legjendare, përkatësisht universale. Fundja, për një poet si Noli, që ishte përcaktuar për një poezi militante e politike, është e natyrshme të pritet që dialogu letrar me realitetin shqiptar të jetë intensiv.

Noli që njohës i mirë i historisë dhe aktualitetit shqiptar, në ngjarjet e të cilit luajti një rol shumë të rëndësishëm. Në poezinë e tij patriotike “*Hymni i flamurit*”,³⁶ historia dhe ngjarjet aktuale shfrytëzohen si brumë, si hipotekst.

Nevoja për ta ndihmuar materialisht Shqipërinë e katandisur si mos më keq, e motivoi Nolin që të ndërmarrë një aksion për mbledhjen e mjeteve materiale në mesin e shqiptarëve të Amerikës dhe për të shkruar poezinë “*Jepni për nënën*”.³⁷ Ai paraqet këtu Shqipërinë si “*një nënë të gjorë*”, bijtë e të cilës, pavarësisht se jetojnë shumë larg saj, nuk do të harronin obligimin që kishin ndaj vendit të tyre.

Edhe poezia “*Përshpirti i abeëve*”³⁸ (që mendohet se është poezi e Nolit), gjithashtu është e motivuar nga një ngjarje konkrete, gjegjësisht nga ngjarjet rreth zgjidhjes përfundimtare të çështjes së alfabetit shqiptar. Poezia mbështetet në një situatë jashtëtekstore, gjegjësisht në kontekstin kulturor dhe politik shqiptar të kohës dhe në të autori ruan një qëndrim kritik, gjegjësisht parodik ndaj anëtarëve të Kongresit të Manastirit, që nuk merreshin vesh në lidhje me alfabetin e përbashkët. Poezia është e mbushur me kritika e mallkime.

Poezia “*Kënga e Dervish Begut*”³⁹ dëshmon një relacion të tipit tekst – kontekst. Në të denoncohet figura e një feudali shqiptar, për paraqitjen sa më reale dhe konkrete të të cilit autori shërbehet

³⁶ Fan Noli, *Albumi*, op. cit., f. 29-30.

³⁷ Noli, op.cit, f.34-36.

³⁸ “Përshpirti i abeëve”, Kombi, Boston, 1 janar 1909.

³⁹ Fan Noli, *Vepra I*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2003, f. 164-165.

me dialektin geg, meqë beu, që është objekt i kritikës noliane, është folës i këtij dialekti. Figurën e feudalit shqiptar të kohës, Noli do ta paraqesë edhe në poezinë “*Thomsoni dhe Kuçedra*”, ku ai fshikullon forcat anadolake të Esad Pashë Toptanit. Këtu, jo vetëm figura e Esad Pashait, por edhe figura e Thomsonit, sado që e mveshur me mjaft elemente legjendare, megjithatë është figurë reale e aktualitetit shqiptar të kohës.

Pos figurës së Zogut, rivalit të tij politik, që mbetet figura më e nxirë e poezisë noliane dhe poezisë shqiptare të kësaj periudhe në përgjithësi, pavarësisht se emri i tij nuk përmendet drejtpërdrejtë, Noli përmend edhe figura tjera të kontekstit politik shqiptar të kohës si: Pandeli Jano Vangjelin, Kristo Floqin, Abdurrahman Krosin, Xhafer Ypin, Koço Kottën, Faik Konicën, Iljaz Vrionin (“*Sulltani dhe kabineti*”).⁴⁰

Poezia e fundit e Nolit (*Vdekja e Sulltanit*), e shkruar në nëntor të vitit 1964, një ditë para operimit të tij dhe pesë muaj para vdekjes, është poezi ku Noli edhe njëherë shpreh mllëfin e tij ndaj rivalit të tij politik, i cili kishte kohë që nuk ishte në krye të shtetit shqiptar, madje i cili edhe kishte vdekur vite më parë. Poezia përshkruan figurën etike të Zogut si një grykës. Nëpërmjet të tij autori: “*satirizon mentalitetin dhe psikologjinë e gjithë ambientit bejlero – anadolak, shijet, zakonet dhe shprehitë që sundonin në këtë ambient të degjeneruar dhe të dekompozuar deri në palcë*”.⁴¹

Kjo poezi dëshmon edhe njëherë se Noli nuk mundi kurrë t’ia fal Zogut kthimin e sistemit monarkik. Zogu vërtet e dënoi Nolin me vdekje në mungesë por, në të vërtetë, Noli që ai që e dënoi atë, përkatësisht profilin e tij moral me poezinë e tij, e dënimi i poetit është i përjetshëm.

⁴⁰ *Ibid*, f. 124-131.

⁴¹ Koço Bihiku, “Periudha e fundit e krijimtarisë poetike të Fan S. Nolit” në *Letërsia dhe koha*, Naim Frashëri, Tiranë, 1982, f. 336.

Poezia e Nolit dëshmon një shkallë të lartë të lidhjes me realitetin, gjegjësisht me kontekstin politik shqiptar të kohës, pavarësisht se simbolet me të cilat ai shërbehet, në të shumtën e rasteve janë biblike, legjendare, përkatësisht universale. Fundja, për një poet si Noli, që ishte përcaktuar për një poezi militante e politike, është e natyrshme të pritet që dialogu letrar me realitetin shqiptar të jetë intensiv.

Gjykuar nga ajo që u tha më lartë, mund të përfundojmë se Noli me veprën e tij letrare qëndron mes mitit dhe realitetit. Miti, si një hipotekst i rëndësishëm letrar, me imagjinatën dhe simbolikën e vet ka provokuar poezinë noline, e cila dëshmon njohje të mirë të mitit dhe simbolikës së tij, ashtu siç dëshmon edhe njohje të mirë dhe mjeshtri në asimilimin e realitetit politik shqiptar të kohës, kur jetoi dhe veproi misionari që u mundua ta ndryshojë këtë realitet dhe të sjell një demokraci të tipit amerikan në një mjedis ballkanin, në një vend që vetëm pak vite më parë kishte dalë nga zgjedha e gjatë otomane dhe që e kishte të vështirë të çlirohet nga fryma e përgjithshme që mbretëronte në Ballkan.

LITERATURA

- Bahtin, Mihail. *O romanu*, Nolit, Beograd, 1989.
- Bihiku, Koço. “Periudha e fundit e krijimtarisë poetike të Fan S. Nolit”, në *Letërsia dhe koha*, Naim Frashëri, Tiranë, 1982.
- Eco, Umberto. *Struktura e papranishme (Kërkimi semiotik dhe metoda strukturale)*, Dukagjini, Pejë, 1996.
- Fraj, Northrop. *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- Jakobson, Roman, Kristyna Pomorska. *Dialogues*, The MIT PRESS, Cambridge, Massachusetts, 1988.
- Jaus, R. Hans. *Estetika recepcije*, Nolit, Beograd, 1978.

-
- Koterel, Artur. *Rečnik svetske mitologije*, Nolit, Beograd, 1998.
 - Noli, Fan. *Albumi*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
 - Noli, Fan. *Vepra I, II, II*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2003.
 - Raifi, Mensur. *Fan Noli dhe Migjeni* (botimi i dytë), Rilindja, Prishtinë, 1979.
 - Uçi, Alfred. “Simbolika mitologjike dhe realizmi në poezinë e F. S. Nolit”, Drita, Tiranë, 1982, 31.I.1982.

OLGER BRAME, KORÇË

PËRDORIMI I SIMBOLEVE NË VEPRËN E NOLIT NË KËNDVËSHTRIMIN SEMIOTIK

Nëse e përfytyrojmë mendjen si një lloj substance të ndërgjegjshme, në të cilën ekzistojnë mbresa dhe gjendje të caktuara, duke mbështetur faktin se njëra prej këtyre gjendjeve është një univers më vete, atëherë fjala bëhet thellësisht arbitrare, fjala është veçse një simbol; ajo kthehet në një shenjë, e cila mbart një domethënie të caktuar.⁴²

Gjuha simbolike është një gjuhë në të cilën përvojat, ndjenjat dhe mendimet intime shprehen sikur të ishin përvoja apo ngjarje të të tjerëve. Simbolika është përdorimi i simboleve për të treguar idetë dhe cilësitë, duke u dhënë atyre kuptime simbolike që janë të ndryshme nga kuptimi i tyre tekstual. Kjo gjuhë mbështetet në një logjikë, ku kategoria themelore nuk janë hapësira dhe koha, por intensiteti dhe asociacioni.

Në kumtimin tonë kemi si qëllim të sjellim në vëmendje dhe të hedhim dritë mbi disa aspekte që lidhen me përdorimin e simboleve në tekstin e një vepre artistike. Për këtë, jemi mbështetur në veprën e një prej figurave më të shquara të kulturës shqiptare siç është ajo e Fan Nolit. Këndvështrimi simbolik i veprës së Nolit, kryesisht i poezisë së tij, nuk do të bëhet domosdoshmërisht në rrafshin e simbolit si figurë letrare, por në një rrafsh tjetër, simbolikës si kategori semiotike.

Gjuha e Nolit është asht e jo tul – thoshte Kuteli, ndërsa Çabej, në deklaraten e dhënë me rastin e vdekjes së tij, nënvizonte se në poezinë e Nolit, sikurse edhe në tërë veprën e tij, origjinale e të

⁴² George Herbert Mead, Mendja, Qenia dhe Shoqëria, Dija, Prishtinë, 2001, fq. 97

përkthyer, “*shihet se sa mund të jetë gjuha shqipe e ashpër e e vrazhdë dhe e fortë në ashpërsinë e saj*”.

Simbolet e zhvendosin domethënien tyre në varësi të kontekstit ku ato janë përdorur. Në aspektin letrar, një simbol kthehet në një mjet letrar që përmban disa shtresa kuptimore, shpesh të fshehura në shikim të parë, duke u bërë përfaqësues i disa aspekteve të tjera, koncepteve apo tipareve, sesa i atyre që janë të dukshme vetëm në përkthimin apo leximin e fjalëpërfjalshëm. Kështu simboli shfrytëzon një objekt apo veprim, për të nënkuptuar diçka më shumë se kuptimi i tij tekstual.

Në poezitë e Nolit, gjejmë pikërisht njaft shtresa të tilla, ku për të dalë te domethënia e strukturës së vargjeve, duhet të zbërthesh simbolikën e tyre, duhet të gjesh denotacionin përkatës, pra kuptimin e saktë. Denotacioni është akti i përdorimit të një simboli ose një fjalë të posaçme për të treguar një domethënie të qartë ose grup domethëniesh. Kuptimi i veçantë i një simboli në një fjalë është kuptim i saktë i saj.⁴³ Nëse i referohemi strukturalizmit mund të përcaktonim se: *Mbi cohën e fjalëve që ai ka thurur, poeti thur një tjetër shumë më të rafinuar, ku forcon e thekson në mënyrë organike ngarkesën e konotacioneve që përmbajnë fjalë të veçanta. Ajo bën kështu funksionale fjalë që do të kaloheshin pa u vënë re.*⁴⁴

Ajo që të bie në sy në poezitë e Nolit është fakti se simbolet e përdorura prej tij më së shumti janë simbole biblike ose mitike, por denotacioni i tyre përfaqëson një zonë me kufij të pacaktuar qartë, ku mund të përfshihen praktikat interpretuese – përshkruese. Shpeshherë është përcaktuar se një pjesë e poezive të Nolit janë të natyrës autobiografike, të rrethanave apo edhe të rastit. Në poezitë e tij gjejmë figura mitike e simbolike si: Marathonomaku, Moisiu, Krishti, Shën Pjetri, Kirenari, Barabbaj, Kaini, Davidi, Thomsoni,

⁴³ <http://literary-devices.com/content/symbol>

⁴⁴ Stefan Çapaliku, Letërsia e interpretuar, “Arbri”, Tiranë, 1998, fq. 65

Salep Sulltani, Sofokliu, Lubia, etj., por ç'përfaqëson secila prej këyre figurave? A simbolizohet vetë Noli në ndonjërin prej tyre? A është Krishti në të vërtetë heroi moral i Nolit? A kthehen këto personazhe simbole në figura konceptuale? A është Shën Pjetri simboli i mohuesit të mikut? A mund të ndahen bardhë e zi figurat vlerësuese në pozitive dhe negative?

Po *kamçiku*, *kryqi*, *kërbaçi*, *rrezili*, *katili*, çfarë simbolizmi fshihin? Po përballëvënja *Krisht–kryq*, *Krisht– kamçik*, *Krisht –Moisi*, *Krisht – Shën Pjetër* përfaqëson simbolikën e drejtpërdrejtë?

Semiotika interpretuese në këtë rast mban parasysh edhe autonominë, edhe imanencën e tekstit, pavarësisht nga synimet e autorit dhe efektin që mund të ketë te lexuesi.

Umberto Ekoja problemin e interpretimit dhe të të kuptuarit të tekstit e ndan: *Intentio auctoris* (Qëllimi i autorit), *Intentio lectoris* (Qëllimi i lexuesit) dhe *Intentio operis* (Qëllimi i veprës). Shpesh teksti nuk përputhet me qëllimet e atyre që e prodhojnë (*intentio auctoris*). Për një interpretim të duhur të tekstit, nuk duhet mbështetur në deklarime ose biografi empirike të autorit. Shpesh lexuesi projektton diçka që nuk ekziston, pasi ai mund ta bazojë atë në dëshirat, impulset dhe arbitraritetin krejtësisht personal (*intentio lectoris*). Është i njëjti tekst që duhet të mbahet parasysh, në referimet e koherencës kontekstuale dhe sistemeve të kuptimit të cilit i referohet (*intentio operis*).⁴⁵

Teksti, në këtë rast është një zinxhir i artificeve shprehëse që duhen zbritur nga marrësi. Teksti kërkon lëvizje bashkëpunuese si pjesë aktive dhe e ndërgjegjshme për përdoruesit. Ai është një mekanizëm, i cili jeton në tepricën e kuptimeve të futur nga marrësi. Nga ana tjetër, një tekst nuk është i plotë, sepse ai është i thurur

⁴⁵ Umberto Eco, *Semiotica e filosofia del linguaggio*, Biblioteca Einaudi, 12, Torino, 1997

gjithmonë me një *"jofjalë"*, diçka që nuk manifestohet në nivelin e shprehjes e që kërkon lëvizje bashkëpunuese aktive dhe ndërgjegje nga ana e lexuesit, për të përditësuar aspektin e përmbajtjes. Që lexuesi të mundet të përzgjedhë kuptimin, duhet të zotërojë një sërë aftësish apo kompetencash, siç i quan Ekoja: kompetencën gramatikore, kompetencën semantike–enciklopedike, aftësinë për të qartësuar domethëniet, aftësinë për të nxjerrë përfundime. *"Një tekst është i paplotë pa ndërrhyrjen e një lexuesi, i cili, me veprimtarinë e tij interpretuese, mbush ndjenjën e "hapësirës së bardhë", në të cilën teksti është thurur domosdoshmërisht"*.⁴⁶

Për Bartin” Semiologjia nuk është shkencë, disiplinë, shkollë apo lëvizje me të cilën ai indifitikon veten, por është aventurë, ajo që i ndodh, ose ajo që i vjen nga shenjuesi . Teksti, për Bartin, në kuptimin modern, dallon thellësisht nga vepra letrare, sepse nuk është prodhim estetik, por është praktikë shenjuese.⁴⁷

Mbështetur në këtë përcaktim, nëse duam të zbulojmë domethënien e simbolikës në poezinë e Nolit, kemi dy këndvështrime me kahje të ndryshme. I pari ka të bëjë me leximin e drejtpërdrejtë, prej nga ku zbulohen dhe motivet biografike e autobiografike në poezitë e Nolit, këndvështrim që nga shumëkush është parë si interpretimi i vetëm i poezive të tij. Kështu sipas këtij zbërthimi të simbolikës, Krishti është heroi moral i Nolit që në vogëli apo çlirimtari, Shën Pjetri portreti–zon mohuesin e mikut, Moisiu – heroin që vetëflijohet, Marat–honomaku lajmëtarin misionar, kryqi simbolizon martirizimin, Barabaj – tradhtari i idealit kombëtar apo në interpretime të tjera dhe Ahmet Zogun si kundërshtarin politik të Nolit, etj.

Nga një këndvështrim tjetër, më tepër se me domethënien e figurës simbol të drejtpërdrejtë, kemi të bëjmë me denotacionin, apo më

⁴⁶ Po aty

⁴⁷ Roland Barthes, *Aventura semiologjike*, Përkth. R.Ismajli, Rilindja, Prishtinë. 1987

mirë me një lloj konotacioni të tekstit, duke i zbërthyer gjithë shenjat e tij, duke e kthyer tekstin në një domethënie subjektive për çdo lexues. Në këtë rast simbolika zbërthehet nëpërmjet nëntekstit si zbërthim nëpërmjet denotimit të kuptimeve subjektive dhe kalon në një interpretim më të koduar dhe më të thellë.

Po t'i referohemi Ekos, interpretimi i tekstit, leximi, varen nga natyra e tekstit, ndërsa për Sosyrin, shenjuesit i ngjajnë një xhami jo tërësisht transparent, që ka mbetje shenjuesish të tjerë.

Në këtë këndvështrim simbolika është e kuptueshme në perspektivën e leximit tekstual, pra ne përpiqemi të zbërthejmë shenjat brenda tekstit në bazë të efekteve që ato prodhojnë këtu dhe tani. Në këtë rast simboli nuk priret të zbulojë dhe të fshehtë absoluten e besimeve nga të cilat është nisur shenja, por absoluten e poezisë.⁴⁸

Rene Wellek e Austin Warren nënvizojnë se sa herë gjykojmë për simbolizmin në poezi, duhet bërë dallimi i simbolizmit “të fshehtë” të poetit që nënkupton një sistem dhe, studiuesi i kujdesshëm, mund të analizojë “simbolizmin e fshehtë” ashtu si deshifranti deshifron një tekst të huaj”⁴⁹.

Si përfundim mund të themi se vepra poetike e Nolit përbën një korpus të fuqishëm, që mund të shërbejë si burim për analiza dhe interpretime semiotike. Siç shprehet Hajdeger, vlera e një mendimi qëndron jo në atë që shpreh, por në atë që le pa shprehur, e megjithatë e përfton duke e paraqitur në një mënyrë të atillë që nuk është karakteristike për deklaratën.⁵⁰ E tillë është dhe poezia e Nolit, është një semiotikë simbolike, është bota e shenjave që përmban në vetvete kodet, të cilët vërehen me anë të procesit denotativ dhe nënkodet që nxirren me anë të një procesi konotativ.

⁴⁸ Umberto Eko, *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2007, fq. 147

⁴⁹ Rene Wellek; Austin Warren. *Teoria e letërsisë*, Tiranë, 2007, f. 195.

⁵⁰ Cituar në Umberto Eko, *Struktura e papranishme*, Dukagjini, Pejë, 1996, fq.284

Bibliografi e shfrytëzuar

- G. Herbert Mead, *Mendja, Qenia dhe Shoqëria*, Dijs, Prishtinë, 2001, fq. 97
- R. Barthes, *Aventura semiologjike*, Përkth. R. Ismajli, Rilindja, Prishtinë. 1987
- R. Wellek; A. Warren, *Teoria e letërsisë*, Tiranë, 2007, f. 195.
- S. Çapaliku, *Letërsia e interpretuar*, “Arbri”, Tiranë, 1998, fq. 65
- U. Eco, *Semiotica e filosofia del linguaggio*, Biblioteca Einaudi, 12, Torino, 1997
- U. Eko, *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2007, fq. 147
- U. Eko, *Struktura e papranishme*, Dukagjini, Pejë, 1996, fq. 284
- <http://literary-devices.com/content/symbol>

PROF. ASOC. DR. MYRVETE DRESHAJ – BALIU, PRISHTINË
PROF. DR. BEGZAD BALIU, PRISHTINË

STUDIMI I JETËS DHE VEPRËS SË FAN NOLIT NË KOSOVË

Hyrtje

Objekt i studimit tonë janë bërë arritjet e gjertanishme në studimet Noliane në Kosovë dhe për aq sa është e mundur edhe më tej. Shënimi i 50 vjetorit të lindjes së tij, na obligon që gjerësisht të merrem me vazhdimin e kërkimeve të jetës dhe bëmave të tij të shumta dhe me ndikim në jetën e popullit shqiptar; studimit të veprës së tij duke nisur me kërkimin e teksteve origjinale, variante e versioneve të teksteve të tij; studimit sistematik të veprës së tij mbështetur në metodat e reja; reflektimit të ri në disa nga vlerësimet e gjertanishme të shkencës shqiptare etj.

Arsyet e kësaj qasjeje në këtë përvjetor të vdekjes së tij nxiten prej informatave a indiceve për ekzistimin e varianteve të veprës së tij kryesisht letrare; prej daljes në dritë të disa dokumenteve të reja nga arkivat shqiptare, europiane, amerikane dhe madje ruse; prej njohësimeve të tërthorta të ekzistimit të një letërkëmbimi të tij me disa personalitete jo shumë të rëndësishme në pamje të parë, por sigurisht me shumë rëndësi për biografinë e tij; prej botimit jo të plotë, jo sistematike dhe jo filologjike e tekstologjike të veprës së tij të njohura më parë dhe asaj të mbetur në dorëshkrim etj.

Me qëllim që ajo të shihet në gjithë përbërësit e saj, hapësinorë dhe kronologjik, të gjitha gjetjet e gjertanishme, të gjitha botimet, studimet dhe tekstet e tjera do të shihen në kontekstin kohor dhe tipologjizues.

Vlerësimi i harruar i Profesor Ajetit: Fan Noli – idealist i madh, atdhetar i vërtetë

“Emni i Fan Nolit qëndron thellë në zemrat e Shqiptarëve përparimtarë dhe të gjithë njerëzve tjerë që kanë pasë rasën ta njohin nëpërmjet veprave të tija ose nëpërmjet kritikës letrare e aftësisë oratorike⁵¹.”

Po t’a studiojmë me një sy kritik jetëshkrimin dhe veprimtarinë e tij letrare, menjëherë dallojmë se simbas rrethanave dhe gjendjes kritike t’atherëshme të Shqipërisë, Fan Noli asht një ndër pionierët me të vlefshëm shqiptarë, jo vetëm si patriot i mirë, por edhe si letrar në za për botën shqiptare. Ai u përpoq pa prap për shkrimin e Shqipërisë⁵² nga zgjedha e huej, u përpoq gjithashtu, edhe për përfundimin e vetqeverimit të saj patriotësh të mirë dhe të ndërgjegjshëm për popullin e mbrapambetun shqiptar, në kurriz të të cilit ishin mësue të ldrojshin çok ata që ia kanë pi gjakun dhe rjepë lëkurën⁵³.”

(...)

Fan Noli radhitet në radhën e parë të listës shqiptare, por të pesëhojmë punën e tij si patriot, si shkrimtar e si përkthyes. Idealist i madh, atdhetar i vërtetë, e si i tillë tanë veprimet e veta i ka lidhë me shkrimin e Shqipërisë nga zgjedha e huej ose nga sundimi i mbrendshëm dhe me përparimin e saj si shtet i qytetnuem⁵⁴.”

Po e hapim këtë tekst tonin vlerësues e sintetizues për jetën dhe veprën e Fan S. Nolit në Kosovë, e kjo do të thotë edhe në Shkup dhe Podgoricë, me një vlerësim të parë të Profesor Idriz Ajetit, të vitit 1952, të cilin pa të drejtë studimet shqiptare, e madje edhe

⁵¹ *Nga letërsia shqipe* (me Hasan Vokshin), “Mustafa Bakija”, Prishtinë, 1951, f. 176.

⁵² Shih dedikimin e Albumit (Boston, Massachusetts, 1948): Kryetrimave që e çliuan Shqipërinë nga fashistët, nga nazistët, nga bejlerët, u dedikohet ky album prej Federatës Vatra”. (Cit, sipas Botimit të “Rilindjes”, Prishtinë, 1968, f. 5).

⁵³ *Nga letërsia shqipe* (me Hasan Vokshin), “Mustafa Bakija”, Prishtinë, 1951, f. 176

⁵⁴ Po aty., f. 179.

bibliografite shqipe për Fan Nolin nuk e ka përfshirë në radhorin e saj⁵⁵. Fjalë hyrëse e Profesor Idriz Ajetit për Nolin, e përcjellë edhe me poezi origjinale dhe përkthime të Nolit në këtë vëllim⁵⁶, përfaqëson disa nga primesat themelore që e kanë përcjellë studimin e mëtejme të Nolit gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XX.

Diskursi i fjalësit dhe togfjalëshit, simbolika e mendimit dhe mesazhi i përcjellë nga njëri paragraf në tjetrin përfaqësojnë që në fillim atë komunikim shkencor, kritik dhe publicistik, i cili do ta përcjell gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XX, pavarësisht nga njohja e pjesshme apo e plotë e veprës së tij. Në një mënyrë a në tjetër Noli dhe vepra e tij përfaqësonin njëkohësisht kultin e personalitetit dhe të veprës së tij njëkohësisht. Për autorin e kësaj fjale Profesor Idriz Ajetin “Emni i Fan Nolit qëndron thellë në zemrat e Shqiptarëve përparimtarë”, ndërsa kjo paradigmë ndërtohet mbi tri paradigma: “veprat e tija” (sado prej veprës së tij lexuesi në Kosovë njihte ndonjërin prej poezive të tij, si “Himni i Flamurit” dhe “Shpell’ e Dragobisë” të njohura kryesisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, si dhe ndonjë fragmenti të përkthyer nga Shekspiri; “kritikës letrare”, sado pothuajse nuk ishte i njohur asnjë nga tekstet e tij; dhe “aftësisë oratorike”, sado fjalimet e tij në konferenca ndërkombëtare dhe

⁵⁵ Më duket i paqëndrueshëm vlerësimi i studiuesve dhe bibliografëve të Nolit, që këtë vepër të Idriz Ajetit, ta përfshijnë në radhorin e librit shkollor, krahas veprave të tij të kohës për shkollat tetëvjeçare: “Libër leximi për klasën IV të shkollave fillore” (me Stathi Kostarin e Jani Gjinson), Prishtinë, 1948, f. 268; “Libër leximi për klasën V të shkollës tetëvjeçare” (me Anton Çettën), Mustafa Bakija, Prishtinë 1954, f. 162; (botim II), Prishtinë 1955, f. 147. Veprat e kësaj kohe: “Letërsia jugosllave” (dispensë), Prishtinë 1947, f. 60; “Nga letërsia shqipe” (me Hasan Vokshin), Mustafa Bakija, Prishtinë 1951, f. 235; dhe “Nga proza jugosllave” (me Tajar Hatipin, Nebil Dinon e Vehap Shitën), Mustafa Bakija, Prishtinë 1952, f. 418, krahas studimeve historiko-letrare dhe gjuhësore, e recensionale, përfaqësojnë një natyrë tjetër origjinale të tyre, pavarësisht vlerave shkencore që kanë.

⁵⁶ Shih më tej, Myrvete Dreshaj – Baliu, Editimet historiko-letrare të Profesor Idriz Ajetit - një fushë e panjohur, në vëllimin e Konferencës shkencore në fushë të filologjisë për nder të Akademik Idriz Ajetit, *Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Fakulteti i Edukimit, Prizren, 15.05.2014* f. 55-61.

institucionet politike vendore, as atëherë as sot pothuajse ende nuk janë të njohura plotësisht.

Po kështu mund të diskutohen edhe shprehjet dhe togfjalëshat që identifikojnë dhe ju referohen përbërësve jetësorë e letrarë të tij: “nji ndër pionierët me të vlefshëm shqiptarë”, “patriot i mirë”, “letrar në za”; dhe “çlirimtar nga zgjedha e huej”, “përforcues i vetëqeverimit” etj. Për të përfunduar në mënyrë emblematike: Fan Noli: “idealist i madh, atdhetar i vërtetë”.

Konferenca shkencore e Institutit Albanologjik të Prishtinës

Krahasuar me numrin e madh të veprave të botuara dhe me ndikimin intelektual dhe letrar që ka pasur Fan Nolin në gjysmën e dytë të shekullit XX, në Kosovë nuk janë organizuar shumë konferenca shkencore për të dhe për veprën e tij, në ato përmasa që janë organizuar për disa nga personalitetet më me ndikim të kohës.

Prej të dhënave të shtypit ditor dhe shkencor, prej projekteve e konferencave shkencore të organizuar gjatë kësaj kohe mund të thuhet se për Nolin është organizuar njëra prej konferencave më të mira dhe më të plota. Siç thuhet në parathënien e këtij vëllimi dhe nga fjala e hyrëse e Profesor Idriz Ajetit, konferenca u organizua dhe madje vëllimi u botua menjëherë (siç nuk ishte praktikë e kohës), me rastin e 100 vjetorit të lindjes (1982–1982), prandaj për pjesëmarrje u ftuan disa nga personalitet dhe disa nga studiuesit më të mirë të kohës. Në këtë mënyrë, në këtë konferencë u ftuan të marrin pjesë njohësi të shquar të veprës së tij si Profesor Idriz Ajeti dhe Rexhep Qosja, si dhe një brez i ri i studiuesve, të cilët me metodat bashkëkohore që përdornin në qasjen e tyre ndaj letërsisë së traditës dhe asaj bashkëkohore, sillnin gjithashtu edhe rezultate të reja.

Vëllimi për “Fan S. Noli, në 100 – vjetorin e lindjes 1882–1982”, ashtu si edhe konferenca u konceptua në shtatë tërësi, duke përfshirë

këtu edhe fjalën hyrëse emblematike të Profesor Idriz Ajetit, me titull “Fan Noli – një burrë i rrallë i botës mendore shqiptare”.

Në sythin për kontributin e Fan Nolit për letërsinë janë botuar shtatë kumtesa, të shkruara nga studiuesit Sabri Hamiti, Sefedin Fetiu, Agim Vinca, Bajram Krasniqi, Ramadan Musliu, Zeqirja Neziri dhe Emin Kabashi. Në studimet dhe në trajtesat e tyre ky brez i ri studiuesish të kohës trajtojnë elemente të reja të autobio- grafisë së Nolit (Sabri Hamiti), erudicionin dhe elokuencën e tij (Agim Vinca), strukturën poetike të simboleve noliiane (Emin Kabashi) si dhe botëkuptimin dhe stilin e Nolit (Bajram Krasniqi). Një përmasë të veçantë të kërkimeve në veprën e Nolit paraqesin studimet përimtuese për disa nga poezitë më të mira të tij: “Shën Pjetri në mangall (Sefedin Fetiu); “Anës lumenjve” (Ramadan Musliu) dhe “Rent or Marthonomak” (Zeqirja Neziri). Mbase karakteristikat e të gjithë pjesëmarrësve i ka projektuar më së mirë studiuesi Bajram Krasniqi me dy konstatime mjaft përgjithësuese: së pari me konstatimin se “studiuesit dhe kritikët e shumtë, duke shkruar për Nolin si poet dhe demokrat nga kënde të ndryshme, e në raste jo të rralla, duke e shkoqur nga rrjedhat e përgjithshme historiko-letrare dhe shoqërore-politike, kanë krijuar mitin për Nolin–njeri dhe shkrimtar”⁵⁷; dhe së dytë me vlerësimin emblematik, se “duke qenë se Noli demokrat doli nga lëvizja dhe Revolucioni Demokratik i Qershorit, si të papërsëritshëm në historinë e popullit tonë, edhe Noli si poet është i papërsëritshëm, qoftë me vizionin, qoftë me shumanshmërinë e interesimeve, qoftë me stilin e tij origjinal”⁵⁸.

Nëse kërkimet për autobiografinë e tij janë të karakterit semiologjik, ato për aspektet semantike të veprës së tij janë të karakterit përgjithësues, ndërsa studimet për poezinë e tij janë vazhdimësi e shkollës së Profesor Qosjes në shkollën strukturaliste të dijës së Prishtinës.

⁵⁷ Bajram Krasniqi, *Letërsia dhe vetëdija historike*, “Rilindja”, Prishtinë, 1984, f. 109.

⁵⁸ Po aty f. 124.

Le të theksojmë që në fillim, se ndryshe nga tekstet studimore për letërsinë e Fan Nolit, të shkruar për rreth një gjysmë shekulli, në Tiranë dhe në Prishtinë, studimet e kësaj konference, përkatësisht të botuara në këtë vëllim, i tejkalojnë disa përmasa të njohjes dhe paraqitjes gjertanishme. Dhe i tejkalojnë, qoftë me mënyrën se si janë marrë krijimet poetike të Nolit, qoftë me mënyrën se si janë trajtuar ato. Në qoftë se disa prej rimarrjeve të tyre (Mitrush Kuteli), kanë karakter vlerësues; ndikimet në studimet e brezit të sotëm janë kryesisht të asaj shkolle që dekadat e fundit dolën nga studimet e Profesor Rexhep Qosjes.

Tipologjia e shkrimeve për Nolin

Sikur i tha më lartë, jeta dhe vepra e Fan S. Nolit është vlerësuar në Kosovë, para se të botohej e plotë qoftë edhe një vëllim të vetëm, por ajo më parë se sa të botohej e plotë, në botime të veçanta, libra shkollorë apo antologji letrare është botuar në përmasa njafat gjithëpërfshirëse dhe madje është botuar si krijimtari origjinale dhe si krijimtari e përkthyer. Në të vërtetë, pjesë të krijimtarisë së tij origjinale dhe të përkthyer, janë botuar duke e vlerësuar përmbajtjen patriotike të tyre dhe përkthimin brilant të letërsisë botërore. Kjo është edhe arsyeja pse që në vëllimin e parë të letërsisë shqipe, Noli, më parë se sa me poezinë e popullarizuar, “Shpell” e Drago-bisë”, përfaqësohet me përkthimet e tij të letërsisë botërore “Korbi” (Edgar Allan Poe); me “Makbethin” e Shekspirit, me një fragment nga “Skënderbeun – Jetën dhe veprën”, me poemthin “Skënderbeu” (Henry W. Longfellow), dhe me “Jul Qesarin” e Shekspirit, e vetëm në fund me elegjinë për Bajram Currin.

Veprat monografike

Pas dy studimeve me karakter monografik të Hilmi Aganit dhe të Rexhep Qosjes, në fund të viteve '60, si dhe një monografie të Agim Vincës (temë magistrature), në të cilën vepra e Nolit kishte

përmasa gjithëpërfshirëse, në fillim të viteve '70, studiuesi Mensur Raifi botoi dy herë monografinë e tij *Noli dhe Migjeni*, si dhe ribotoi një monografi të zgjeruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbokroate *Lasgushi, Noli dhe Migjeni*. Në fund të dekadës së shtatë, tri tema magjistrature i kishin paraqitur edhe Jusf Gërvalla, Naxhie Deva dhe Avni Spahiu, ndërsa profesori Yll Zajmi mbrojti disertacionin e doktoratës *Fan Noli – Jeta dhe vepra*, të cilin e botoi në një vëllim më vete në vitin 1986 dhe së fundi Mensur Raifi boton një monografi të llojit të saj *Fan Noli dhe çështja e Kosovës*, Shoqata e Përkthyesve Letrarë të Kosovës, Prishtinë, 1995, 112 f, në të cilën bën përpjekje për të zbardhur disa anë të reja të qëndrimit të Fan Nolit ndaj kosovarëve, lidhur ngushtë me Revolucionin e Qershor të vitit 1924.

Avni Spahiu, Noli: Jeta në Amerikë (monografi)

Tiranë, 2007, f. 294. Avni Spahiu është njëri prej studiuesve të veçantë që i ka treguar përkushtim të rrallë në studimet noline. Siç e ka theksuar në disa nga bisedat e tij, përkushtimin e tij ndaj Nolit e ka udhëhequr edhe një fat i përhershëm, të cilin nuk e kishin edhe studiuesit e tjerë të brezit të tij. Në të vërtetë, përkushtimin e tij ndaj Nolit, të cilin fillimisht e tregoi duke përkthyer disa nga veprat e tij, ai pati fatin ta zgjeronte edhe me caktimin e tij gazetar për shumë vite në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prandaj, ndryshe nga bashkëkohësit e tij, të cilët jetëshkrimin e tij dhe veprën e tij për poezinë, publicistikën, oratorinë dhe historinë etj., e studionin nga veprat pak a shumë të njohura deri atëherë, Avni Spahiu iu përkushtua temës së tij me biografinë kryesisht të panjohur dhe të pasur të jetës së tij prej krijuesi, bariu, e intelektualit të tërhequr nga jeta politike. Veprën e përshkoi një numër i madh i dokumenteve origjinale, duke përfshirë këtu edhe diskutime të incizuara e të panjohura edhe në kohën tonë.

Magjistratura e pambaruar e Jusuf Gërvallës

Përveç doktoratës së botuar të Yll Zajmit, magjistraturës së mbrojtur dhe të botuar pjesërisht të Naxhie Devës, një projekt në fushë të arteve do të mbetet i pa përfunduar. Këtë njoftimin, të cilin si indicie e kanë theksuar disa biografe të Jusuf Gërvallës⁵⁹, fillimisht më të plotë na e jep Kadri Rexha, të cilit i referohet edhe autorja e monografisë më të mirë për te deri më tash studiuësja Myrvete Dreshaj – Baliu⁶⁰, por tash së voni titullin e temës së magjistraturës së tij e saktëson plotësisht Profesor Rexhep Qosja në ditarin e tij:

“Gërvalla ishte poet – i talentuar; ishte prozator i talentuar; ishte krijues letrar shumë premtues. (...)”

Jusufi ishte regjistruar në studimet e shkallës së tretë. Për temë të magjistraturës kishte poezinë e Fan Nolit, kurse titulli i temës ishte *Muzika në poezinë e Fan Nolit*⁶¹.

Për fat të keq kjo temë mbeti vetëm në fillimet e saj. Aktiviteti politik i tij në Lëvizjen ilegale e pengoi që të thellohej në studimet letrare, e aq më tej në tema ndërfaqshore dhe ndërgjinore në studimet historiko–letrare.

Tekstet publicistike

Po të shikohet me kujdes bibliografia e teksteve për Fan Nolin, nuk është vështirë të shihet se tekstet më të shumta të shkruara për jetën dhe veprën e tij i takojnë publicistikës. Megjithatë tekstet e shkruara prej autorë të shumtë dhe me përgatitje profesionale të ndryshme, prej të cilëve shquhet dhuntia e Fan Nolit për letërsinë, orato–

⁵⁹ Shih, Kadri Rexha, *Fati i luleve-Rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla*, “Buzuku”, Prishtinë, 1993, 134

⁶⁰ Myrvete Dreshaj – Baliu, *Jusuf Gërvalla – jeta dhe vepra*, Prishtinë, 2010, f. 67.

⁶¹ Rexhep Qosja, *Dëshmitarë në kohë historike – Qëllimi i madh dhe përndjekja e madhe (1982-1983)*, IV, Tiranë, 2014, f. 31-32.

rinë, poezinë, përkthimin, teologjinë, kompozimin, publicistikën, historinë, kritikën, politikën, muzikologjinë, dramaturginë etj., në të vërtetë të gjitha tekstet e tyre nuk e kalojnë përmasën publicistike të gjuhës, diskursit dhe terminologjinë, për të mos thënë gjuhën panagjerike me të cilën janë shkruar. Ato janë shkruar në të gjitha periudhat kur janë shkruar tekstet për Nolin dhe vazhdojnë të shkruhen edhe sot.

Fan Noli më në fund është bërë edhe objekt ditari dhe është bërë objekt ditari në atë përmasë që nuk janë bërë edhe disa nga personalitetet e gjalla. Objekt vlerësimi Nolin e ka bërë akademiku Rexhep Qosja: “Fan Noli, poeti, kritiku, historiane, publicisti, gojëtar i jashtëzakonshëm dhe politikani e shtetari i pafat në historinë kulturore dhe politike shqiptare do të mbetet shembull i flijuesit, i cili e ka shkruar shqipen më ngjeshur, më qartë dhe më kuptimshëm se asnjë shkrimtar tjetër shqiptar deri sot kur po e shkruaj këtë fjalë. Po të mos ishte numri i madh i fjalëve të huaja, që ka përdorur në shkrimet e tij, do të mbetej stilisti më i madh shqiptar i të gjitha kohërave. Por, Fan Noli do të mbetej edhe politikani e shtetari më i madh shqiptar sikur të mos ishte ngritur i gjithë primitivizmi politik, feudal e fshatar i vendit kundër tij. Fan Noli ishte paraqitur para kohës në historinë shqiptare: populli shqiptar, as në pikëpamje politike, as në pikëpamje kulturore, as në pikëpamje qytetare, nuk ishte i përgatitur që të pranonte një mendje të tillë, me një pamje kombëtare, politike e shtetërore, modernizuese të tillë, që i kishte paralajmëruar ai”⁶².

Prej përvojës së Fan Nolit dhe sidomos prej biografisë së tij me kohe me sa duket ka mësuar shumë edhe autori i këtij vlerësimi Rexhep Qosja, dhe me kohë me gjasë ka mësuar dhe është ngushëlluar prej racionalizimit të botës shqiptare, prandaj i ka kaluar jo pa suksese me përvojën e tij jetësore.

⁶² Rexhep Qosja, *Dëshmitarë në kohë historike* - Koha e idealistëve dhe e kameleonëve (1979-1981), III, Tiranë, 2014, f. 103-104.

Rezultatet e reja: Sevdai Kastrati

Ndër interesimet e reja të studiuesve nga Kosova për jetën dhe veprën e Fan Nolit, studiuesi i brezit të mesëm Sevdai Kastrati pritet të sjell arritjet të reja në studimet noline, për dy arsye: e para, ai jeton në Amerikë ka saj vjet dhe ka treguar pasion të veçantë për kërkimet e tij në lidhje me Nolin dhe Konicën; dhe e dyta, ai tashmë ka sjellë rezultate të reja jo vetëm në kërkimet e tij për jetën politike dhe shoqërore të tij, për çka pritej edhe më parë, por në mënyrë të veçantë për tekste të veçanta në fushë të letërsisë, të cilat tashmë i ka arritur duke i zbuluar më shumë se tridhjetë versione dhe variante të poezisë së tij origjinale apo të përkthyer. Në këtë rrjedhë ai tashmë ka hulumtuar dhe gjetur një numër të madh tekstesh letrare, politike dhe historike të Fan Nolit, jo vetëm në shtypin shqiptar po edhe në shtypin amerikan, austriak e gjerman.

Studiuesi Sevdai Kastrati tash sa vite punon në përgatitjen e veprave complete të Fan S. Nolit, të cilat (me të gjitha tekstet në versione dhe variante) pritet të kapin rreth pesëmbëdhjetë vëllime nga 500 faqe.

Indiciet për një letërkëmbim të panjohur: ndërmjet Ali Rexhës dhe Fan Nolit apo Ali Rexhes dhe Qerim Panritit

Studiuesit e jetës dhe veprës së Nolit në Kosovë dhe lexuesit e pasionuar të jetëshkrimit, dhe veprës fanoliste, më ka rënë t'i dëgjoj tek flasin për një letërkëmbim të mundshëm ndërmjet Fan Nolit dhe Ali Rexhës, i njohuri redaktor i botimeve në redaksinë e botimeve të Rilindjes në Prishtinë. Këto indicie i kam marrë seriozisht, për dy arsye: e para, ai ishte redaktor i veprës complete të Fan S. Nolit, botuar në Prishtinë, më 1968 dhe e dyta, se te ai kishte gjetur ndër dosje të panjohura deri vonë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, një letërkëmbim të rrallë me personalitete të studiuesve shqiptarë jashtë atdheut. Megjithëse e kisha hulumtuar një dosje të tillë të Arkivit të Kosovës dhe disa nga këto letra e dokumente i kisha publi-

kuar në dy vepra të miat⁶³, interesimi i mëtejshëm nuk më ka munguar dhe për këtë kisha arsye që e kundërshtonin njëra tjetrën.

E para është kundërshtuese: Komplet i veprave të Nolit është botuar në vitin 1968, ndërsa Fan S. Noli, ka vdekur në vitin 1965, një vit para rënies së sistemit represiv rankoviqist në Jugosllavi, ndërsa vepra do të jetë planifikuar jo më parë se viti 1966. Kjo do të qonte te dyshimi se Ali Rexha nuk ka komunikuar me Fan Nolin po me Qerim Panaritin.

E dyta është bindëse: Ali Rexha kishte një komunikim me shqiptarët në emigracion madje, dëshmitë dalin që nga fillimi i viteve '50, kur ai (Ali Junuz Rexha, v.j.) ishte bashkëpunëtor i Institutit Albanologjik, por edhe “kapetan reserve i klasit të parë”⁶⁴ (1954), dhe një komunikim të tillë e mundësonte edhe të qenit pjesë e sigurimit të lartë shtetëror.

Si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, pyetje do të shtrohej, pse Ali Rexha nuk i publikoi ato jo vetëm në botimin e parë, më 1968, po as në botimin e dytë, 1988. Përgjigjja për idenë e parë është e thjeshtë: ai nuk ka komunikuar me Fan Nolin, sepse, gjatë përgatitjes së kompletit, 1966–1968, Noli nuk ishte gjallë, prandaj ai kishte mundësi të komunikonte vetëm me Qerim Panaritin, ndërsa për pyetjen e dytë, përgjigjja do të ishte dyshuese: letërkëmbimin e tij nuk e botoi sepse e bëri nën mbikëqyrjen e sigurimit shtetëror jugosllav, prandaj ai do kërkuar më tej.

Mbetet për të dyshuar vetëm duke u nisur nga një paradigmë e mundshme: Fan Noli është i vetmi shkrimtarë i gjallë në mërgim, i botuar para vitit 1966⁶⁵, prandaj komunikimi i tyre, qoftë edhe vetëm në kontekst të këtij botimi nuk do përjashtuar, por vazhduar.

⁶³ Shih, *Vareni kryengritësin e shenjtëruar*, Prishtinë, 2009, f. ??? dhe *Struktura e vlerave përfaqësuese*, Prishtinë, 2014, f. ???

⁶⁴ *Struktura e vlerave përfaqësuese*, Prishtinë, 2014, f. ???

⁶⁵ Fan S. Noli, *Sulm e lot*, Enti për botimin e teksteve të RS të Serbisë – Prishtinë, 1963.

Përfundime

Në traditën gjysmëshekullore të studimeve historiko–letrare në Kosovë, për krijuesit e gjysmës së parë të shekullit XX, dallon tre autorë: Fan S. Nolin, Lasgush Poradecin dhe Millosh Gjergj Nikollën – Migjenin. Janë të rrallë studiuesit në Kosovë të cilët nuk kanë shkruar një tekst historiko–letrar, publicistik, historik, biografik, përkujtimor dhe madje letrar, ku njëri prej këtyre krijuesve të mos jetë bërë objekt frymëzimi. Ndryshe nga Migjeni dhe Lasgush Poradeci, të cilët kishin adhuresit e tyre kryesisht nga radha e krijuesve, Fan S. Noli adhuresit e tij i kishte nga radhët e akademikëve, publicistëve, studiuesve dhe madje krijuesve. Prej bibliografisë së tij dhe prej teksteve të shkruara për jetën dhe veprën e Fan S. Nolit nuk është vështirë të shuhet se gjatë gjithë kësaj kohe studiuesi që gjatë, për të mos thënë gjatë gjithë jetës së tij u përqop t'i përngjante me jetën dhe me veprën ishte Profesor Rexhep Qosja.

Interesimi për jetën dhe për veprën e Fan S. Nolit lidhet me krijimtarinë e tij origjinale dhe përkthimet në mënyrë paralele, me jetën e tij të pasur historike dhe me studimet historike skenderbegiane, me tekste e tij polemizuese dhe me oratorinë e tij gjithashtu. Por, në mënyrë të veçantë jeta dhe vepra e tij do të lidhen me vet botimin sa më të plotë të veprës së tij në Prishtinë. Vlerësimet karakteristike dhe të veçanta në radhë të parë do t'i bëhen nga Profesor Idriz Ajeti në vitet '50, për të marrë dimensione të veçanta në studimet historiko–letrare, trajtesat politike, polemikat dhe vlerësimet intelektuale të Profesor Rexhep Qosjes në fund të viteve '60 dhe '70, për të vazhduar me studimet e Hilmi Aganit, Rexhep Ismajlit dhe kurorëzuar me dy monografi të Mensur Raifit dhe monografinë e Yll Zajmit në fillim të viteve '80.

Fan S. Noli ishte krijues me dhunti të madhe intelektuale dhe me biografi të pasur, prej të cilës studiuesit kishin çka të reflektonin në horizontet e historisë dhe në situatat e reja bashkëkohore; ai ishte krijues me pasuri të madhe gjuhësore prej të cilës studiuesit kishin

çka të kërkonin; ai ishte orator me dhunti të madhe modelet e të cilit shumë publicistë dhe studiues të kohës sonë përpiqeshin t'i imitonin; intelektual me dhunti të veçantë prej të cilit krijuesit kishin çka të merrnin për krijimet e tyre letrare. Interesimet e tyre për pasurinë jetësore dhe krijimtarinë e tij, në vitet '80, në trajta dhe forma letrare e krijuese do të trajtohen nga shumë studiues dhe madje do të provohet të bëhet edhe me metoda të reja kërkimore nga: Abdullah Karjagdiu, Agim Vinca, Sefedin Fetiu, Bajram Krasniqi, Sabri Hamiti, Shkëlzen Raça dhe në mënyrë të veçantë nga studiuesi Mensur Raifi.

Për të gjitha këto dhe aspektet e tjera të jetës dhe veprës së tij, mund të themi se bibliografia e Fan S. Nolit është e pasur po aq sa janë të pasura edhe bibliografitë e etërve të letërsisë dhe kulturës shqiptare: Jeronim De Radës, Naim Frashërit, Gjergj Fishtës, Faik Konicës, Lasgush Poradecit, Migjenit, Esad Mekulit, Ismail Kadarese, Rexhep Qosjes, Dritëro Agollit etj.

LITERATURA

- Ajeti: 1951 = Ajeti, Idriz. *Nga letërsia shqipe*. Prishtinë.
- Baliu: 2014 = Baliu, Begzad. *Kujtesa letrare*, Prishtinë.
- Raifi = 1975 = Raifi, Mensur. *Noli dhe Migjeni. Studim monografik*. Prishtinë.
- Raifi = 1986 = Raifi, Mensur. *Lasgushi, Noli dhe Migjeni. Studim monografik*. Prishtinë.
- Baliu: 2015 = Baliu, Begzad. *Struktura e vlerave përfaqësuese*, Prishtinë.
- Clayer: 2012 = Clayer, Nathalie. *Në fillimet e nacionalizimit shqiptar (Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë)*, Tiranë.
- Zajmi, 1986 = Zajmi, Yll. *Fan Noli – Jeta dhe vepra*. Prishtinë
- Fuko: 1971 = Fuko, Mishel. *Rijeci i stvari*, Beograd.

- Geary: 2009 = Geary, Patrik, *Miti i kombeve*, Tiranë
- Petrota: 2008 = Petrota, Gaetano. *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, Tiranë
- Pirraku: 1989 = Pirraku, Muhamet. *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, Prishtinë.
- Qosja: 1984 = Qosja, Rexhep. *Histori e letërsisë shqipe (Romantizimi, I, II)*. Prishtinë.
- Qosja: 1998 = Qosja, Rexhep. *Strategjia e bashkimit shqiptar*. Prishtinë.
- Qosja: 1967 = Qosja, Rexhep. *Epizode letrare*. Prishtinë.
- Qosja: 2004 = Qosja, Rexhep. *Tri mënyrat e shkrimit shqip*. Prishtinë.
- Qosja: 1979 = Qosja, Rexhep. *Antologji e lirikës shqipe*. Prishtinë.
- Qosja: 2005 = Qosja, Rexhep. *Shkrimtarë dhe periudha*. Prishtinë.
- Qosja: 1980 = Qosja, Rexhep. *Morfologjia e një fushate*. Prishtinë.
- Gëzhilli: 2003 = Gëzhilli, Mehmet. *Fan S. Noli (6 janar 1882 – 13 mars 2003), 120 vjet jetë dhe veprimtari*. Tiranë.
- Fan S. Noli: 1984 = Instituti Albanologjik i Prishtinës. *Fan S. Noli, në 100 vjetorin e lindjes 1882–1982*. Prishtinë.
- Rugova & Hamiti: 1979 = Rugova, Ibrahim dhe Sabri Hamiti, *Kritika letrare, tekste, shënime, komente*. Prishtinë.
- Krasniqi: 1984 = Krasniqi, Bajram, *Letërsia dhe vetëdija historike*. Prishtinë
- Smith: 2010 = Smith, Anthony, D. *Nacionalni identitet*, Beograd.
- Thiesse: 2004 = Thiesse, Anne Marie, *Krijimi i identiteteve kombëtare*, Prishtinë

ZEQIRIJA IBRAHIMI, SHKUP

PRIFTI KRYEMINISTËR FAN S. NOLI

Për Fan S. Nolin është shkruar dhe ai është studiuar nga studiues të ndryshëm të letërsisë, gjuhës, por edhe të historisë e të teologjisë, por ajo që kam përshtypjen se është e njohur, por jo shumë e theksuar, është fakti që ai është kleriku i parë dhe i fundit në historinë e kombit shqiptar që ka arritur ta drejtojë shtetin shqiptar. Për albanologët, që më shumë janë marrë me veprën e tij, por edhe për historianët dhe politologët, që janë marrë me veprimtarinë e tij politike, kjo mund të mos jetë ndonjë gjë që duhet vështruar me kaq kujdes, por ky fakt flet shumë për ta njohur më saktë kodin e shqiptarisë.

Në letrat shqipe gjithandej lexohet e citohet kushtrimi i Pashko Vasos se “feja e shqiptarit është shqiptaria” dhe kjo rëndom vihet në kontekst të asaj që atë e interpretoi komunizmi shqiptar – se shqiptaria është fe pa Zot dhe se ateizmi ishte njëfarë shqiptarie. Për këtë arsye, ata e shpallën Zot Partinë, që kështu ky slogan t’i shkojë për shtat ideologjisë së tyre. Megjithatë, kushtrimi i Vaso Pashë Shkodranit nuk ishte antifetar, por thellësisht fetar dhe shumë religjioz. Ndërkaq, shembulli më i mirë i kësaj është fakti që një prift ortodoks, madje themelues i Kishës Ortodokse Shqiptare, do të bëhej kryeministër i Shqipërisë. Sado që mandati i tij zgjati shkurt dhe ai në dhjetor të 1924–tës u desh të largohej përgjithmonë nga Shqipëria, mesazhi i zgjedhjes së tij në krye të shtetit flet shumë.

Nuk ishin bërë as 12 vjet të plota qëkur Perandoria Osmane ishte larguar nga Ballkani dhe kishte vetëm dhjetë vjet qëkur disa shqiptarë ishin ngritur ta kërkojnë kthimin e “babës”, kur në krye të Shqipërisë pranohej për kryeministër një prift ortodoks. Kur kësaj ia shtojmë edhe faktin se Shqipëria e asaj kohe ishte sigurisht më

shumë se 70% myslimane dhe shumë konservatore në këtë drejtim, zgjedhja e Nolit në këtë detyrë përbënte shembull sfidues për të gjithë Europën dhe më gjerë. Shprehur në terma aktualë i bie që sot në Francë ose në Gjermani të mund të zgjidhet në kreun e shtetit një mysliman, sepse edhe atje myslimanët e gjeneratës së tretë, që e konsiderojnë veten më autoktonë, përbëjnë diçka më pak seç ishin ortodoksët e Shqipërisë në atë kohë.

Për këtë arsye mendoj se shqiptarët provën e parë se janë tolerantë, madje më shumë se kaq, në aspektin religjioz, e dhanë qysh në qershor të vitit 1924. Ndërkaq, nëse gjurmojmë për arsyet e kësaj, kujtoj se shpjegimet e kësaj janë dy: njëra është “feja e shqiptarit është shqiptaria”, që shqiptari i rëndomtë e lexonte se, kur duhej të ndërtohej shqiptaria, besimi kalonte në plan të privates dhe mbrohej interesi nacional, por gjithnjë duke e ushqyer dashurinë për tjetrin – se ndryshe nuk kishte mundësi që prifti ortodoks të pranohej për kryeministër, ndërsa arsyeja e dytë – sipas nesh – ishte se – duke qenë shumica shqiptare myslimane traditës osmane, ku siç dihet gjatë shekujve të tërë ishte respektuar tjetri (kujtojmë pranimin e hebrenjve në Perandorinë Osmane ose selinë e Patrikanës që gjithnjë qëndroi në Stamboll), shqiptarët kishin trashëguar një frymë të sinqertë respekti për fenë e tjetrit dhe praninë e tij pa asnjë rezervë. Kujtojmë këtu se çfarë bënë grekët me myslimanët e Greqisë ose serbët me boshnjakët dhe me shqiptarët jashtë Shqipërisë, për ta pasur të qartë se versionin e Islamit shqiptar, që ishte fryma dominuese shqiptare, ishte aq i hapur për tjetrin, sa nuk e kishte problem ta pranonte për udhëheqës të vetin edhe një klerik të një feje tjetër.

Dhe, pas kësaj, askush nuk ka të drejtë t’u mbajë shqiptarëve leksione për tolerancën dhe dashurinë ndërfaqetare, e aq më pak shekullarët e ateistët shqiptarë, që në jo pak raste janë aq agresivë ndaj fenomeneve religjioze të shqiptarët. Hiç më larg se këto ditë një i tillë në Shqipëri propozoi sulme mbi Mekën dhe Medinën vetëm sepse disa të marrë kishin bërë një sulm terrorist në Paris, duke

harruar kështu se kështu i shpallte luftë hiç më pak se gjysmës së kombit shqiptar.

Një dimension tjetër i kësaj analize është se sot edhe sikur të kemi një prift a një hoxhë aq patriot e aq të formuar intelektualisht, siç ishte Noli ose, në kampin mysliman, Hfz. Ali Korça, shoqëria shqiptare do ta përmbyste botën po të shfaqte ai ambicie që ta udhëheqë shtetin. Aq shumë urrejtje ka prodhuar shekulli komunist te shqiptarët, sa ka arritur edhe në shkallët që i përmendim me shembullin e mësipërm. Ndërkaq shqiptaria e Rilindjes Kombëtare Shqiptare ishte projektuar që, pa marrë parasysh se a bëhej fjalë për Haxhi Vehbi Dibrën, Dom Nikollë Kaçorrin apo Fan Stilian Nolin, derisa ata e mbronin shqiptarinë, nuk ishte fare problem që ata të ishin kryetarë të Senatit Shqiptar, të ishin ministra dhe, bile kryeministër të shtetit shqiptar. Kundruar kështu, sikur Shqipërisë të mos i kishte ndodhur fatkeqësia komuniste, nuk do të ishte ky animizitet ndaj fesë dhe klerit fetar atje, nuk do të ishte kjo betejë që klerikët të mbyllen në faltore dhe nuk do ta udhëhiqnin shtetin njerëz që janë kaq të dobët në formimin e tyre shpirtëror. Sa për krahasim, gjasat që Noli – një prift që frymëzohej nga jeta e Jezuit – të korruptohej, ishin aq të pakta, sa ai do të ishte shembulli historik se me çfarë devotshmërie mund t'i shërbeje atdheut pa përfutur gjë prej tij. Kujtojmë këtu se cili ishte luksi që krijoi pastaj Zogu, por edhe më vonë udhëheqësit e Shqipërisë deri në ditët tona. Shembuj të kështillë sot mund të gjenden vetëm te republikanët e SHBA-së dhe ndoshta askund tjetër. Në këtë mënyrë shqiptarët – me humbjen e Nolit – humbën edhe mundësinë që Shqipërinë ta udhëhiqnin njerëz me virtyte të larta shpirtërore, të cilët nuk i kanë frikë vetëm ligjit që mos ta keqpërdorin pronën dhe paratë publike, por më shumë i kanë drojë Zotit.

Një aspekt tjetër që duam ta vëmë në spikamë është se shqiptarët atëbotë e pranuan një prift ortodoks për kryeministër, ndërsa sot një prift ortodoks shqiptar, me shqiptarinë e Nolit, nuk pranohet të jetë as kryepeshkop i Kishës Ortodokse Shqiptare. Se sa shumë ka de-

graduar shqiptaria dhe ortodoksia shqiptare, flet fakti se ortodoksët shqiptarë, në vend që të rriten dhe të frymojnë me ortodoksinë e Imzot Nolit, e kanë pranuar si normale dhe, madje, të patjetër—sueshëm, faktin se kryepeshkop i Kishës Autoqefale Shqiptare duhet të jetë një grek i dërguar nga Greqia. Kur kësaj i shtohet edhe ajo se kjo është mirëpranuar edhe nga pushtetarët shqiptarë, vërtet është për të ardhur keq.

Në këtë mënyrë, përveç që është shkelur mbi mundin e Nolit, është lejuar greqizmi i drejtpërdrejtë i ortodoksëve shqiptarë dhe, rrjedhimisht, asimilimi i tyre në grekë. Në këtë mënyrë përpjekja dhe djersa e Nolit është nëpërkëmbur dhe ka shkuar huq.

SKENDER ASANI, ITSHKSH – SHKUP

LUFTA PËR IDENTITET KOMBËTAR TË SHQIPTARËVE ORTODOKSË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

*(Dokumente për Kishën Autoqefale Shqiptare në vitet
1941 – 1945)*

Ngjarjet e rënda historike dhe, shpeshherë, tragjike, kanë detyruar grupe të mëdha të popullatës shqiptare, që i përkiste fesë ortodoksë në trevat lindore shqiptare (Maqedonia e sotme, S.A), të tjetërsosheshin. Ata ishin të detyruar ose të asimiloheshin etnikisht ose t'i braktisnin vatrat e tyre shekullore dhe të kërkonin strehë në vende të huaja. Armiqtë tanë e kishin përparësi tjetërsimin e shqiptarëve: dikush duke na e shlyer dhe humbur historinë e dikush duke na tjetërsuar në kombe të tjera, që më në fund ta harrojmë vetveten tonë dhe një ditë të na vije turp për atë se çka dhe si ishim dikur!

Gjatë shekullit XIX dhe në dekadën e parë të shekullit XX shqiptarët ortodoksë të trevave lindore shqiptare ishin nën presionin e vazhdueshëm nga Ekzarkia Bullgare për t'u asimiluar. Faktikisht, aty ku e kishte jurisdiksionin kjo kishë, të gjithë besimtarët ortodoksë ishin të detyruar të deklaroheshin si bullgarë. Këtu qëndron edhe kurthi i manipulimeve statistikore të historianëve bullgarë, të cilët në raportet e tyre i paraqesin si bullgarë shqiptarët ortodoksë nga rajonet kompakte të shqiptarëve ortodoksë.

Nga ana tjetër, prej tetorit të vitit 1912, konkretisht pas Betejës së Kumanovës, trevat lindore shqiptare bien nën pushtimin serb. Në këtë kohë fillon edhe faza e dytë e asimilimit, përkatësisht presioni i Kishës Serbe ndaj shqiptarëve ortodoksë të këtyre trevave, për ta ndryshuar kombësinë. Pra, të njëjtën metodë që e kishte përdorur Ekzarkia Bull-

gare, filloi ta përdorë edhe Kisha Ortodokse Serbe, duke e shfrytëzuar fenë si mjet presioni për ndryshimin e strukturës kombëtare në trevat lindore shqiptare. Me këtë rast, edhe historianët serbë botuan shumë të dhëna statistikore dhe sajuan histori të rrejshme për rajonet e ndryshme të banuara me shqiptarë ortodoksë në trevat lindore shqiptare dhe duke i paraqitur ata para opinionit si popullatë serbe.

Kjo golgotë e shqiptarëve ortodoksë në trevat lindore vazhdoi edhe pas krijimit të federates jugosllave, përkatësisht me themelimin e Republikës së Maqedonisë dhe themelimin e Kishës Autoqefale Maqedonase, e cila duke e përdorur fenë, arriti që me mjete të ndryshme të pushtetit dhe dhunës institucionale ta asimilojë gati se në tërësi popullatën ortodokse shqiptare.

Dokumentet që po i paraqesim në këtë botim janë hulumtuar në Arkivin Qendror të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht në Fondin “Албанска православна црква”, që flet për vitet 1941–1945. Nga këto dokumente arkivore kuptojmë se, gjatë kësaj kohe, në territorin ku kishte shtrirje Kisha Autoqefale Shqiptare (Struga, Kërçova, Dibra, Reka, Gostivari dhe Tetova), për herë të parë gjatë historisë u mundësua që vetë popullata lokale të përcaktohet për përkatësinë kombëtare shqiptare të ortodoksëve të këtij rajoni. Po ashtu në këto dokumente shpaloset komunikimi i drejtpërdrejtë i priftrinjtve dhe i besimtarëve ortodoksë me qendrën e Kishës Autoqefale Shqiptare në Tiranë. Në disa nga këto relacione shpaloset edhe dëshira e hapur e popullatës vendore që mesha të zhvillohet në gjuhën e besimtarëve, në gjuhën shqipe. Po ashtu kërkohet që priftërinjtë të ndjekin kurse në gjuhën shqipe, kjo si parakusht për të pasur një komunikim të drejtpërdrejtë me qendrën në Tiranë.

Këto dokumente janë të rëndësisë së veçantë, sepse për së pari herë shihet se si në mënyrë institucionale popullatës shqiptare të fesë ortodokse i mundësohet të përcaktohet lirshëm elementi kombëtar që ajo i takonte. Me interes të veçantë janë dokumentet ku shihet qartë se si është shënuar në ato vite festa e 28 Nëntorit, me ç’rast nëpër kishat e këtyre qyteteve ka vluar flamuri kombëtar shqiptar.

Lista e priftërvorve "orthodoks" të Qarkut të Dibrës

Emri i Mbretërisë	Nivënia	Qarkut, emërimi		Libëra e pagaca		Orimi, studiu ashtë pague	Vendi të - (prema)
		Mumuri	Buta	Buta	Mumuri		
1. Spiro T. Dolevski	krupçifti	799	23.8.50	Episkopi Dolevski	691	31.10.1941	Shkollë
2. Risto T. Dolevski	prift	240	9.11.1918	Episkopi Dolevski	692	30.10.1941	"
3. Stefan Dolevski	krupçifti	147	20.12.1918	Episkopi Dolevski	693	31.10.1941	Raspiza
4. Risto T. Dolevski	prift	315	14.12.1918	Episkopi Dolevski	694	30.10.1941	Stani, Mërkur
5. Stefan T. Dolevski	"	1951	30.10.1918	Episkopi Mërkur	695	30.10.1941	Gori
6. Stefan T. Dolevski	"	"	"	Episkopi Mërkur	696	31.10.1941	Stani
7. Antonia D. Dolevski	"	"	"	"	697	31.10.1941	Mërkur
8. Gjergj Manavci	krupçift	254	28.12.1918	Episkopi Mërkur	1434	31.10.1941	Butashtë
9. Manavci Nikola	"	25/6-08	25.12.1918	"	"	31.10.1941	"
10. Gjergj T. Manavci	"	"	"	"	"	31.10.1941	Shkollë
11. Stefan T. Manavci	"	5452	19.12.1918	Episkopi Mërkur	1435	31.10.1941	Stani, Mërkur
12. Radozina Peki	"	6746	19.12.1918	"	"	31.10.1941	Gjergj
13. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
14. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
15. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
16. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
17. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
18. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
19. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
20. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
21. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
22. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
23. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
24. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
25. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
26. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
27. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
28. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
29. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
30. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
31. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
32. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
33. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
34. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
35. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
36. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
37. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
38. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
39. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
40. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
41. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
42. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
43. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
44. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
45. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
46. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
47. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
48. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
49. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
50. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
51. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
52. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
53. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
54. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
55. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
56. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
57. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
58. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
59. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
60. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
61. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
62. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
63. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
64. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
65. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
66. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
67. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
68. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
69. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
70. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
71. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
72. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
73. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
74. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
75. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
76. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
77. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
78. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
79. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
80. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
81. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
82. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
83. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
84. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
85. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
86. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
87. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
88. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
89. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
90. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
91. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
92. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
93. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
94. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
95. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
96. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
97. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
98. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
99. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"
100. Radozina Peki	"	"	"	"	"	"	"

STAMPED AND
RECORDED
1941

STAMPED AND
RECORDED
1941

MBRETNIIJA SHQIPTARE
KISHA ORTHODOKSE AUTOKEFALE E SHQIPNIS
ZAVENDSIJA E DIBRES.

N^o 25

30. V. 1942. Xx

Ne baze te urdimit Te Miresis te Arkiepiskopit te Kishes Shqiptare Autokefale Z. Kristofor N^o 7 29 date 13/2/1942 XX^e mbas informatare dhe hetimove te banuna per formimin e te Tretes Parohi ne Kergoves porvoj te Paros dhe te Dytes, dhe mbas diskutimvet te gjata qe u bane me personat Kompetente si edhe me persona civile te tjere, qytetare dhe Autoritetet Respektive, tue u basue e kujdesue per intercesen e Kishavet Parohijavet dhe Administratavet per dallimin e tyre si edhe me keryjen e rrejonit te kotynove:

V E N D O S T H I.

Ndajen e rrejoncvet te Kishavet te Kergoves dhe te rrethit si vijon: S para Parohi tue bane ne rrethin e vot nji pjese te qytetit te Kergoves me lagjen "Carshija" dhe me katundet: Starovec, Bigor-Dolenc dhe Masareoci dhe katundin Lirija, ne te cilen Parohi prifti Antoni Vugeti do kryej te gjithë punet Fetare.

Parahija e dyte qe do te perfahij ne rrethin e vot: nji pjese te qytetit me lagjen "Carshi" dhe me katundet: Starovec, Bigor-Dolenc dhe Masareoci dhe Premka, ne te cilen Parohi prifti Antoni Vugeti do te kryej te gjithë punet Fetare.

Parahija e trete qe do te perfahij ne rrethin e vot: nji pjese te qytetit te Kergoves me lagjen "Ciflik" si dhe me katundet: Dobrenovoc drugove dhe katundin Lirija ne te cilen Parohi do te kryej te gjithë punet Fetare prifti Dimitor Sfetku.

Kës vendim asht fuqi-plote dhe sejeili prift asht i detyruem me e pranue dhe me sherbye sejeili ne rrejonin e vot me sell dhe me kujdesi te madhe ne menyre qe te ndorej perfaqesuesit e nalte dhe te punoje vllazniasht me te gjith famulltaret e tjere si edhe me te gjith banoret e rrejonit te tij. Nga nji lëpje prej kotij vendimi tju dergohet Prift-nivet te pomekundua dhe nji N/Prefektures se Kergoves si dhe nji tjetor Krye Episkopit ne Tirane.

ДРЖАВЕН АРХИВ НА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
С К О П Ј Е

Zavends'i Mitropolitit
Protopapa (Spire T. Ligenovski)

[Signature]



KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
E SHQIPNIS

MITROPOLIA E SHENJTË

Tiranës - Durrësit - Elbasanit - Shkodrës - Pogradecit,
Kavajës - Dibrës - Gërës dhe Shpëtit

N-ri 546

10
Tiranë, me 24. XII. 1941. XX

Te Perndershmit

Protopapa Spiro Licenovski
Zavendes Mitropolit

LANDA:

D i b e r

Mbi nje prift per fam.Bitush.-

Mbassi banoret e katundevet Bitush, Voloborde, Trebisht e Jonge te Nenprefektures se Rokes i kane drejtue kesaj Kryesije nje lutje per t'emnuar n'ate famulli edhe nje prift te dyte, tue transferue te Per Manoilio Nikolla nga katundi Lazaropole t'atij rrethi presim te na komunikoni mendimin t'uaj mbi kete qesh-tje.

Hiri i Zotit dhe Shpetimtarit t'one Jisu Krisht qofte kurdohere ndihmes mbi ju.

L u t e s

KRYETAR I KISHES ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
KRYEPISKOP I GJITHES SHQIPNIS
KRISTOFOR



ДРЖАВЕН АРХИВ НА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
СКОПЈЕ

PROGRAMI FESTES

të Përvjetorit 29 të të Përvjetorit të Pavarësisë Kombëtare

- 28/XI/1941 - 29/XI/1941. -

PARA - DITE

- 1). Qytet n'orët e para të ditës 28 Nëntor 1941, i gjithë tregu, syrat qeveritare dhe shtetë private të qytetit do të jenë të stolisura me flamurë.-
- 2). Dyqanet do të jenë mbyllur gjithë ditën përpos, dorëkorrës; kafeve, ambulatorëve dhe farmave.
- 3). N'orën 9.30, populli dhe autoritetet civile e ushtarake në bashku me të gjithë nëpunësit dhe në nxënësit e shkollave do të mbledhen në Bashki prej ku do të shkojnë në shaminë e re dhe në Kishën e Shen Frontes, për marrë pjesë në TE- DEUMET që do të bëhen ndër atë falstare.-
- 4). Në orën 10.30, në të gjithë nga falstaret do të shkohet për urimet - e rastit në Bashki ku do të mbahet edhe fjalimi i ditës. Nga Bashkia mendoj do të shkohet për në Prefekturë për urime.

MBAS - DITE

- 5). Në orën 15 deri në orën 16.30 do të jepet nga ana e nxënëseve të shkollave fillore një çfaqje shkollore në sallën e Federatës Fashiste.

Nga PREFEKTURA :

ДРЖАВЕН АРХИВ НА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
СКОПЈЕ

46

KRYEBIRLISISË SI TIJ
EPISKOPIT TË KISHËS AUTOQEFALISË ORTH.SHQIPTARE

T I R A Z I

I nënshkruemi, Ruse Tase, prift famulltar i qytet
i Kishës së Shën Premtes në qytet të Dibrës së Madhe
kam nderin të Ju parashtroj lutjen që poshtë vijon:

Me që dij me folë gjuhën shqipe edhe kam dëshirë
të nxehtë për me e mësue ndër fëmijët e qytetit t'onë
fëmë e Krishtit të predikueme në gjuhë amtare shqipe,
lutemi të kini mirësinë me m'lemus si mësues besimi
të fesë orthodokse në Dibrë të Madhe.

Mbetem përvuejtënisht i prekur prej fesë së
Krishtit, tue ushqye nderimet ma të thella kundrejt
Hirësisë së Juej.

Dibrë, me 13/4/1942-XX

Ruse Tase
Ruse Tase



PREFEKTURA MBRETNORE E DIBRES
Nr 746/III.

Diber, me 27/XI/1941.XX.

Gjithë Zyrvet

Famullis Kith/one C. H. S. K.

Për njoftim e veprim, bashkangjitur ju dergo
nji kopje e programit rreth festimit të përvjetorit 29 t
t'Independencës Kombëtare, 28/XI/1912-28/XI/1941

P. P R E F E K T I
(Llambi George)

ДРЖАВЕН АРХИВ НА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
С К О П Ј Е



KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFAL
E SHQIPNIS

Tiranë, me 11. XI. 1941. - XX

KRYESIA
E
SINODHIT TË SHENJTE

Nr. 447

Të Përndershmit
Protopapa Spiro Lipenovski
Zavendes i ynë në

D i b e r

LANDA:

Mbi kujtimet në meshe. - Porositeni që të urchëroni famulltarët e juridiksio-
nit t'Asaj Zavendesije Kryepiskopale të Hirëshme që, në
pastet e zakonëshme të Meshe dhe të shërblimevet të tjera
fetare, të kujtojnë M. e Tij Mbretin t'onë Perandor Viktor
Emanuelin e III-të, Mbretëshën Elena dhe Trashëgimtarin
Umberto di Savoia, si dhe Qeverinat Italiane dhe Shqip-
tare.

Gjith'ashtu, të porositen për me kujtue në pastet e
zakonëshme të meshe Kryetarin e Kishës Orthodhokse Au-
toqefale dhe Kryepiskopin e Gjithë Shqipnis Kristofor.

Hiri i Zotit dhe shpëtimtarit t'onë Jisu Krisht qoftë
kurdhërë ndihmës mbi ju.

L u t e s

KRYETAR I KISHES ORTHODHOKSE AUTOQEFAL
KRYEPISKOP I GJITHË SHQIPNIS
K R I S T O F O R



Секретариат
Кр. Православ.
Церкви в Албании
г. Тир. Архиепископ

ДРЖАВЕН АРХИВ НА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
С К О П Ј Е

Hyrysis Se. t. i. Kryepiskopit
e kishës Ortodhoxe Autokefale
Shqiptare "Pirani"

Lanolin e bashkëngjitur mbi "Kunorëzim
të bashkëshorteve Jovan Sofroni dhe i shogës
Ljubica, të dy lindur e banës në katundin
Bresance Rëmina e Lozargoljes, Mpresen-
tura e 'Rexis, Prefektura e Shores, ~~ka~~
për shkollë se grueja Ljubica na shkollë
Kunorën, kom noderin me ju a. pade-
gjit ~~me~~ t' me u lute për veprim
kompetence.

Në bazë të nenit 85 të regullorës
mbi kunorëzimet në aplimin në vset
të anekstuenie martesë kunorëzohet
në ~~qofta~~ ^{rast} se shkollë provohet para au-
toritetet kompetente (gjyqi kishtar).

Në rast se për rehat e sh. b. rës
nuk ekziston gjyqë kishtar, lutemi
që të kemi mirësin e të formoni
kët gjyqë kishtar, ose në Tiranë, se nuk
kemi dëshirë as punë dëshirë me kom-
noder kompetencën e gjyqit kishtar në
Prizrend ku ~~at~~ kur një here nuk kemi
geni të mbarun.

Due puthë dorën e shenjtë mbetën
menderin në të

Xav. i Episkopit
Paraprist
(Spiro Liconovski)

4

Градот во Буче
 Свои и мажот Буче
 за утв. во. Лазаровиќ
 7 м. франска.
 Оваа сам утв. ова
 во саканото.
 Мојот итн. итн.
 во Буче 300 лека
 и. јиданг за Овотар.
 Итн. итн. франска
 франска.

26. X. 1947
 Л. 102

Грозница
 Л. 102
 Л. 102

XIII° BATTAGLIONE CARABINIERI REALI
COMANDO

L A S C I A P A S S A R E N° 1391



Che si rilascia a R U S E Tese fu
Spase e di Jelisaveta, nato a Dibra il
2°-agosto 1914, parroco di Dibra.

Il presente lasciapassare a valevole per
giorni 10 (dieci) e serve per recarsi a
Ocirida per urgenza di famiglia.

A Dibra li 21 novembre 1941 XX°



IL MAGGIORE
COMANDANTE DEL BATTAGLIONE
(*Roberto Lazzari*)

[Signature]

ДРЖАВЕН АРХИВ НА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
С К О П Ј Е

6 1. 25-5- 2
 Въ срѣда по. 28 в. м. ще отидаме, аз, Вашия
 Пачево председател на селскостопанския
 съветъ, Вело Богсво и Стефанъ Туневъ
 въ Монастира. Въ Монастира вторично на
 заседание и по стенограмите на този
 втора. Много работата има да се вър-
 шимъ, но велико ще свършимъ ~~на~~
 въ местето.

Вашия Пачево-есть отъ стено-
 грамъ и азъ зр. него искаме възгра-
 ждението пожелане тъй да много не
 знаемъ и пожеланието му е много
 важно. Съ Д-р Киринъ Стефановъ вод-
 ела разговора и много ми казано
 писаното кити отъ него писано.

За това Вело. Туневъ пакъ
 ще въ колпача, да е тъй много го-
 радъ и никакъ не се тукърва на
 каренданцията кити трѣбва да
 ги исполнит. Азъ по какво да не
 на заседание и тъй не дайде, ~~така~~

Pop Shpiro

MBRETNJIA SHQIPTARE

BASHKIIJA E DIBRËS

Nr. 986 / 1

Dibër, me 18/X/1941-XIX.-

IMANJET DHE PRIFTAVET E DIBRËS

K E T U

Tue zbatues urdhërit të Prefekturës së Dibrës Nr.474 datë
16/X/1941-XIX.- u dërgohet një kopje e modelit statistikës të
kërkime, dhe u lutemi me e plotësu me informatat dhe shifrat
e nevojshme për të gjuhë kolonat e kopjes bashkangjitur.-
Kopja e plotësueme me na e ktheja pa vonesë deri më 26/X/
1941-XIX.-

KRYETARI I BASHKISË:

(Shenoi Natibi)



Shenoi Natibi



MBRETNITJA SHQIPTARE
BASHKIIJA E DIERES

Diber me 1. VII. 1942-XX.

Nr. 556/4

Mitropol's Orlovskoe

V E N D.

Per diçeni ngjitur kesaj shkrese kemi ndërrin t'ju pa-
ruesim një kopje të programit mbi manifestimin e kuvendit të
parë kombëtar të kulturës që do të zhvillohet me datën 4 Ko-
rrrik 1942-XX, ditën e Shtunë.

Kryetar i Bashkis.

(Shemsi Hatibi)



Shemsi Hatibi

ДРЖАВЕН АРХИВ НА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
СКОПЈЕ

Diber, më 11.XI.1941.

Shkëlqesë,

I nënshkruemi, Protopapa Spiro Liçenovski, zavendës i Kryetarit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipnis në Dibrë, kam nderin me i parashtrur Shk. s'Uaj, nga ana edhe të klerit Bullgar të qarkjevet të Dibrës dhe të Strugës, lutjen për sa ma posht vijon:

Me gjithë që kanë kaluar ma se 6 muaj qysh prej ditës fatlume kur viset t'ona kanë patur fatin e zgjedhun të ribashkohen me dheun shqiptar, neve klerikëvet t'atyne qarkjevet nuk na janë paguar ende rrogat t'ona të këtyne muajvet, perveç një pjese të vogël të tyne. Prandaj, kemi nderin t'i lutemi Shk. s'Uaj me pasë mirësinë me disponue instruksionet rrelative ku duhet për pagimin e tyne.

Me këtë rast, kemi nderin t'i njoftojmë Shk. s'Uaj se jemi e do të jemi kurdoherë besnikë të Madhnis së Tij Mbretit t'onë Perandor Viktor Emanuelit III-të e të Regjimit Fashist t'installuem lumnisht n'Atdheun t'onë, të bindun n'urdhnat e qeveris dhe të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipnis, tue kujtue në meshimet t'onat dhe në shërbimet e tjera fetare Madhnin e Tij Mbretin t'onë Perandor VIKTOR EMANUELIN e III-të dhe Kryehirësin'e tij Kryetarin e Kishës Orthodhokse Autoqefale dhe Kryepiskopin egjithë Shqipnis Zotot Kristoforin,

Tue shpresue, Shkëlqesë, se kjo lutje jonë ka me u-marrë parasysh, përfundojmë me nderime të malta

Zavendësi i Kryetarit të Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipnis në Dibrë
(Protopapa Spiro Liçenovski)



PROGRAM

I manifestimeve të kuvendit të parë kombëtar i kultures qe do të zhvillohet me datën 4 Korrik 1942-XI.

I) Qytet n' orët e para të mëngjezit të dites 4 (E shtunë) i gjithë tregu dhe qyteti do të jetë i stolisur me flamuret dhe i zbukurues me dafina e harqe.

II) Ora 8 gjithë tregu pa asnjë përjashtim do të mbyllet dhe populli do të grumbullohet para Bashkis ku do të gjinden të radhitur edhe nxansat e shkollave të qytetit me autoritetet civile dhe ushtarake.

III) Nji grup prej 17 paraqitës çiklista do të dalin t'i presin myfirit e shquar në krye të sheshit Udoe.

IV) Me mbritjen e mysafireve para Bashkis tre nxanse të shkollave të veshur me kostum kombëtar do t'i u ofrojnë nga nji buqete me lule.

V) Me t'arrijtur në vendin e caktues dhe pikerisht mbas dorëzimit të luleve fillon çelja ceremonis me këndimin e hymneve dhe mbas këtyne Kryetari i Bashkis në emen të qytetit ju uron mirëseardhjen.

VI) Vajon pritja në Bashki ku do të prezantohen nji perfaqsi e po pullit dhe autoritetet.

VII) Migt e kuvendit të shquar shoqeruar nga autoritetet do të vizitojnë:

- A) Monumentin e Skenderbeut ku do të vihet edhe nji kurorë.
- B) Xhamin e ré të tregut.
- C) Kishen e Shenpremtës.
- Q) Ekspoziten e shkollave në Shkollën Skenderbeu.
- D) Në Banjishtë për të pa banjat e nxehta.

VIII) Përon 13 do të shpërchet draka në sallën e hotelit të ri.

IX) Në 15 mbledhje populllore në sallën cinema Tomori ku do të zhvillohet programi i kuvendit kombëtar të kultures.

X Ora 16 përcjellja e miqve. Tregu i hapur në ora 10 mbyllet sërisht në orën 16.

Diber më 1.VII.1942-XI.

B A S H K I J A.



MBRETNIA SHQIPTARE
Kisha Orthodhokse Shqiptare

Niçipur

Nr.....

45
Tërnice më 26.Mars 1942.XX.

P. T.

Kryetarit të Kishës (Shenjt Jovan Bigorski)

Dibër

Me Akt-dorëzimin e Kryesis së Kishës Orthodhokse Autoqefale Shqiptare në Tiranë Nr.652.datë 16.Janar 1942.XX.jam emëruar si prift për të gjith katundet e Rekës së epërme,ku edhe sot ndodhem në detyr e sipër.

Para ca ditë është ftuar Z.Jovan Spaseni nga ~~katundi~~ katundi Vërben të rekës së epërme nga ana e asaj P.T.Kryesie për me u paraqit në Tiranë për me u emëru si prisft po për këto katunde.

Prandaj lutem asaj P.t. Kryesije që të ndërmetë sohet ku duhet ashtu që mbasi jam emëruar si prift po për këto katunde, të i njoftoni Kryesisë së Kishës në Tiranë që gabimisht më emërohet edhe tjetër mbasi këto katunde janë të vegjël dhe nuk mban as një prift e jo edhe tjetër.

Kryetar i kishës Orthodhokse
Shqiptare për rekës e epërme

(Peco Novaku)



KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
E SHQIPNISKRYESIA
E
SINODHIT TË SHENJTË

N-ri 80f

Tiranë, më 7. III. 1942 - XX

19

Te Perndershmit
Protopapa Spiro Liçenovski
Zavendes ne Diber
~~XXXXXXXXXX~~Mbi nje dorezim.-

Tue marre parasysh lutjen e Z.Jovan Zhëra, nga e banues
ne katundin Verben te Komunes se Ternices te rrethit te
Galiçnikut, per t'u-dorezuar prift per t'i sherbyer famu-
llis s'atij katundi, ne vend te te Perndershmit Pop Jor-
gjit, i cili ka deklaruar se nuk mund te sherbeje ma,
porositeni t'a lajmeroni te permendunin qe te paraqitet
ketu me date 7 Prill qe te dorezohet. Pas kesaj date, tue
gene famullinat e atij rrethi te plotesueme dhe mbassi
nuk duhet aspak qe te krijohen famullina te reja, vec aty-
neve qe kane eksistuar edhe ne te kaluaren, nuk do te pran-
het asnje kandidate per dorezim.

Hiri i Zotit dhe Shpetimtarit t'one Jisu Krisht qofte
kurdohere ndihmes mbi Ju.

L u t e s

KRYETAR I KISHES ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
KRYEPISKOP I GJITHE SHQIPNIS
KRISTOFOR



KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
E SHQIPNIS

Tiranë, më 15. IV. 1942 - XX

20

KRYESIA
SINODHIT TË SHENJTË

Nr. 903

Te Perndershmit

Proto At Spiro Ligonovski
Zavendes i yne ne

LANDA:

bi kalogreshen Olivera.-

D i b e r

Gjegje shkreses Nr.12 dt.14.IV.1942-XX:

Ne lidhje me sa ban fjale shkresa e juaj e nalt-
permendun, autorizoheni me e rregullue qeshtjen ne fjale
ne menyren qe do te konsiderohet me e pershtateshme.

Hiri i Zotit dhe Shpetimtarit t'one Jisu Krisht
qofte kurdohere ndihmes mbi Ju.

L u t e s

KRYETAR I KISHES ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
KRYEPISKOP I GJITHË SHQIPNIS
KRISTOFOR



KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE

SHQIPTARIS

KRYESIA

SINODIT TË SHENJTE

Tirane, me 21.IV.1942-XX

Q A R K O R E Te Hireshmvet

LANDA:

Mbo korresp.shqipe.-

Pendesivet Episkopale


Diber, Struge, Kercove, Tetove, Gostivar

Tue marre parasysh se kjo Kryesi nuk ka nje perkthyes te posaqem per perkthimin prej gjuhes Slavishte, porositeni qe korrespondencen t'uaj me kete Kryesi t'a mbani ne gjuhen Shqipe. Po keshtu te porositen edhe personat, klerike ose llaikë, qe me anen t'uaj i drejtohen kesaj Kryesje me shkrese.

Hiri i Zotit dhe Shpetimtarit t'one Jisu Krisht qofte kurdo here ndihmes mbi Ju.

L u t e s

KRYETAR I KISHES ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
KRYEPIKOP I GJITHË SHQIPTARIS
KRISTOFOR



*Orta 4 Spiro Lopenik
Srbes*



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

FAN S. NOLI – figurë emblemатike për shqipen dhe shqiptarët

SCUPI – 13

Shtypi: Fokus Print – Shkup

CIP – Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.1(=18)(062)

FAN S. Noli – figurë emblemатike për shqipen dhe Shqiptarët:
(tribunë shkencore – 20.11.2015). Vël. 13 / [kryeredaktor Zeqirija
Ibrahimi]. – Shkup: Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore
të Shqiptarëve, 2016. – 128 стр. ; 21 см. – (Biblioteka Scupi)

Фусноти кон текстот. – Библиографија кон трудовите

Содржи и: Dokumente

ISBN 978–608–4653–33–2

а) Албанското прашање – Собири

COBISS.MK-ID 100333834